



**KOHËZGJATJA GJYQËSORE NË APEL
dhe
AFATET E GJYKIMIT TË ARSYESHËM
2016-2023**

KOHËZGJATJA GJYQËSORE NË APEL dhe AFATET E GJYKIMIT TË ARSYESHËM 2016-2023

Tiranë, 2023



Botim nga Qendra për Çështje të Informimit Publik, INFOCIP

© copyright 2023: Qendra për Çështje të Informimit Publik,
INFOCIP,

Të gjitha të drejtat të rezervuara. Materiali që përmban ky publikim mundet të citohet me kusht që të njihet autorësia e tij përmes referimit të plotë të attributeve (INFOCIP, data e botimit, autorët, ISBN dhe me reference në fund të faqes).

Një kopje e publikimit që përmban materialin e rishtypur/referuar duhet t'i dërgohet INFOCIP. Çdo përdorim i metodës, i të dhënave teorike apo gjetjeve sasiore dhe cilësore në këtë studim, për qëllime komerciale ose jo-komerciale nga të tretë është i ndaluar dhe përbën shkak për ndjekje/penalizim ligjor.

Drejtore i research-it & autor i metodës:

Dr. Gerti Shella

Analizë / Përpunim të dhënash:

Tea Pasholli

Eneida Fatkoja

Adela Luzi

Design & Layout

AG Studio

ICT Database Management:

Kildon Veseli

Dritjon Selmani

Marsel Tufa

Donald Qamili

Kontributorë në research:

Emi Hanaj

Megi Saliaj

Keti Gërbi

Programi Kombëtar GJYKATA E HAPUR / OPEN COURT



Ky Vlerësim Tematik është realizuar me mbështetjen financiare të Ambasadës së Mbretërisë Holandeze në Tiranë, në kuadër të projektit "Open Courts through Press Judges".



Kingdom of the Netherlands

Disclaimer:

Opinionet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura në këtë botim janë të Qendrës për Çështje të Informimit Publik, INFOCIP dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të partnerëve/donorëve që kanë mbështetur realizimin e këtij studimi/botimi

Përmbajtja

Hyrje.....	5
Përmbledhje ekzekutive dhe gjetjet kryesore.....	9
Sinteza & Rekomandime.....	19
Gjetjet e vleresimit tematik viti 2020-2023 Gjykata e Apelit Tiranë.....	23
Gjetjet e vleresimit tematik viti 2020-2023 Gjykata e Apelit Durrës.....	35
Gjetjet e vleresimit tematik viti 2020-2023 Gjykata e Apelit Shkoder.....	47
Gjetjet e vleresimit tematik viti 2020-2023 Gjykata e Apelit Vlore.....	59
Gjetjet e vleresimit tematik viti 2020-2023 Gjykata e Apelit Korçë.....	69
Metodologjia.....	81
Jurisprudence nga Gjykata Europiane e te Drejtave Te Njeriut, Strasbourg dhe Gjykata e Larte e RSH.....	84

Drejtësia e vonuar është drejtësi e munguar!

HYRJE

Më 22 Korrik 2016, Kuvendi i Shqipërisë miratoi amendamentet kushtetuese të Reformës në Drejtësi¹. Ato u pasuan nga miratimi i ligjeve të Reformës, proces i cili përfundoi në vitin 2017². Misioni i Reformës në Drejtësi, i shpallur si në dokumentacion parlamentar ashtu dhe në atë qeveritar (të paktën në dy SND) ka qenë sigurimi i një sistemi gjyqësor **efektiv, efikas, të pavarur dhe transparent**, në përputhje me praktikat më të mira europiane.

Efektiviteti dhe **Efikasiteti** gjyqësor implikojnë qartësisht një shërbim gjyqësor të shpejtë dhe cilësor ndaj publikut, i aftë të rregullojë brenda një afati sa më të shpejtë marrdhëniet juridike të cënuara mes subjekteve përmes aksesit të shtuar në drejtësi. Eliminimi i zvarritjeve gjyqësore është sinonim i efikasitetit. Vlerësimi i vonësive gjyqësore është rrjedhimisht një tregues i realizimit të vetë misionit të Reformës, në të paktën dy nga këto komponentët përbërës të këtij misioni.

Kushtetuta e Shqipërisë përcakton shprehimisht se “*Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj*”³. Detyra e pushtetit gjyqësor është të mbrojë këtë garanci kushtetuese dhe jo ta çënojë atë.

Edhe Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut⁴, në nenin 6 të saj “E drejta për një proces të rregullt”, përcakton shprehimisht se: “*Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat / detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij*”.

Në rezonim të plotë Kushtetutën, KEDNJ dhe me misionin e Reformës në Drejtësi, afatet e gjykimit të arsyeshëm u ri-përcaktuan në mënyrë shteruese në neni 399/2 të Kodit të Procedurës Civile⁵ në vitin 2017. Tejkalimi i afatit të arsyeshëm është shkak ligjor i mjaftueshëm për të ngritur padi për dëmshpërblim në gjykatat vendase (në gjykatën e shkallës më të lartë⁶).

¹ Amendamentet kushtetuese hynë në fuqi më 11 gusht 2016

² Paketa e ligjeve të Reformës ën drejtësi përbëhet nga 7 ligje të reja organike, ndryshime në ligjin nr.7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i RSH”, të ndryshuar, ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995 “Kodi i Procedurës Penale i RSH”, të ndryshuar, ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i RSH”, të ndryshuar, ligjin nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar; Miratimin e ligjit nr. 37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”; si dhe 30 ligje të tjera, ndër to edhe ligje që kanë të bëjnë me veprimtarinë e profesioneve të lira ligjore, si dhe paketa e ligjeve të sistemit penitenciar.

³ neni 42, paragrafi 2, Kushtetuta e Shqipërisë

⁴ Republika e Shqipërisë e rendit në nivelin e normës kushtetuese Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut

⁵ Shtuar neni 399/2 me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017

⁶ neni 399/3 dhe 399/4, Kodi i Procedurës Civile

Përveç ankimit në gjykatat vendase, qytetarët shqiptarë mund të ankimojnë vonesat gjyqësore edhe në GJEDNJ në Strasbourg. Në 12 tetor 2021, GJEDNJ dënoi shtetin shqiptar me 3500 Euro, plus shpenzimet gjyqësore për vonesat e shkaktuara në shqyrtimin gjyqësor ndaj dy shtetasve të saj (*Barra dhe Kola Vs. Albania*⁷). Fenomeni i ankimeve në GJEDNJ për vonesa gjyqësore tej afatit të arsyeshëm po gjen zgjerim, bazuar në vëzhgimet empirike që INFOÇIP ka realizuar së fundmi.

INFOÇIP ka advokuar gjithmonë interesin e qytetarëve për reduktimin e zvarritjeve në dyert e gjykatave. Qëndrimet e organizatës edhe ndaj Reformës në Drejtësi janë përcaktuar pikërisht nga treguesit e matur të shtimit ose pakësimit të kohëzgjatjes gjyqësore. Respektimi i afateve ligjore në procedurën e gjykimit nga organet gjyqësore dhe mos-tejkalimi i afateve të arsyeshme janë përparësi absolute për INFOÇIP në advokimin e interesit publik për një drejtësi efektive dhe pa vonesa.

INFOÇIP ka vlerësuar sistematikisht treguesit e gjykatave të apelit të juridiksionit të përgjithshëm duke siguruar një databazë koherente të dhënash të pandërprera që nga vitit 2016. Kjo databazë diferencon kohëzgjatjen e shqyrtimit gjyqësor dhe kohën e arsyetimit/dorëzimit të vendimit, duke ofruar të dhëna të sakta për të dy treguesit.

Nisur nga rëndësia specifike, afatet e shqyrtimit gjyqësor në apel kanë patur vëmendje të shtuar në vlerësimet tematike që ka ndërmarrë INFOÇIP. Me mbështetjen e Ambasadës Holandeze, në kuadër të Programit MATRA, INFOÇIP aktivizoi serish në vitin 2022 monitorimin dhe vlerësimin e kohëzgjatjes gjyqësore në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm. Ky program u ndërpre në vitin 2020, për shkak të situatës së pandemisë. Ky aktivizim është i rëndësishëm pasi:

- *Treguesit e periudhës 2020-2023⁸ ndërlidhen me treguesit e vlerësuar për periudhën 2016-2019 për të gjitha gjykatat e apelit në RSH (juridiksioni i përgjithshëm), duke mundësuar krahasimin objektiv të treguesve të kohëzgjatjes gjyqësore që nga fillimi i Reformës në Drejtësi 8 vjet më parë e deri më sot. Treguesit përfshijnë si kohën e shqyrtimit gjyqësor ashtu edhe kohën e arsyetimit/dorëzimit të vendimeve, posaçërisht për çështjet e themelit.*
- *Për herë të parë analizohen dhe identifikohen çështjet gjyqësore (civile dhe penale themeli në mënyrë të veçantë) që dolën jashtë afateve të gjykimit të arsyeshëm në apel gjatë periudhës 2020-2023.*
- *Për herë të parë krahasohen treguesit e kohëzgjatjes gjyqësore para dhe pas Reformës së Rretheve Gjyqësore⁹, duke afuar edhe një vlerësim të parë (të fillesës) nga këndvështrimi i eliminimit apo shtimit të vonesave gjyqësore.*
- *Për herë të parë vlerësohet respektimi i afateve ligjore për masat e sigurimit dhe urdhrat e mbrojtjes gjatë gjykimit në apel për periudhën 2020-2022, si dhe krahasohen treguesit e 3-vjeçarit me ato të 6-mujorit të parë të punës së GJAJP Tiranë (1 Shkurt-31 Korrik 2023).*

⁷ z. Petrit Bara ("kërkuesi i parë") dhe z. Eduard Kola ("kërkuesi i dytë"). Me gjithë shpenzimet gjyqësore, penaliteti që duhet të paguaje Shqipëria ndaj dy qytetareve të saj për vonesa në shqyrtimin gjyqësor tej afatit të arsyeshëm shkon gjithsej në 5900 Euro.

⁸ Monitoruesit e INFOÇIP mbodhën të dhëna gjyqësore për periudhën 2020-2023, në të gjitha gjykatat e apelit, me përjashtim të Gj. Aplelit Gjrokastër, për shkak të rrethanave specifike.

⁹ Në kuadër të Reformës së re të Rretheve Gjyqësore, Gjykatat e Apelit (6 gjithsej) u shkrinë në datë 1 Shkurt 2023 në një gjykatë të vetme apeli të juridiksionit të përgjithshëm, e vendosur në Tiranë.

Për të mundësuar analizën e mësipërme, INFOÇIP mblodhi dhe dixhitalizoi një volum të konsiderueshëm të dhënash gjyqësore, të cilat janë informatizuar në Platformën www.gjykataehapur.al. Platforma është e hapur për të gjithë të interesuarit dhe lejon verifikimin e pavarur të gjetjeve. Tabelat në Platformë mundësojnë renditje dhe filtrime të shumëllojshme për një larmi analizash profesionale sa i takon kohëzgjatjes së çështjeve gjyqësore.

Platforma www.gjykataehapur.al përfaqëson të vetmin sistem të automatizuar sot për sot që mundëson vlerësimin sistematik të kohëzgjatjes gjyqësore, duke identifikuar vonesat në shqyrtimin e çështjes dhe në dorëzimin e vendimit, sipas tipologjisë vendimarrëse. Ky është një avantazh metodologjik pasi afatet procedurale të shqyrtimit në apel janë të ndryshme në varësi të llojit të çështjes gjyqësore.

Platforma www.gjykataehapur.al është gjithashtu një “teren testimi” për transparencën e gjykatave sa i takon disponimit të të dhënave për qëllime të statistikës gjyqësore; në këtë kuptim ajo vlerëson avancimin e qëllimit të Reformës në drejtësi **për një sistem gjyqësor transparent**. INFOÇIP ka ndërvepruar me KLGJ dhe stafet e gjykatave në kuadër të këtij programi për të promovuar transparencën e gjykatave ndaj publikut dhe medias. Vetë studimi së bashku me Platformën online janë indikatorë të hapjes së gjykatave në këtë proces.

Gjetjet e monitorimit tematik synojnë të sensibilizojë KLGJ, ILD, Kuvendin dhe Qeverinë lidhur me rrezikun potencial që përfaqësojnë vonesat e shtuara gjyqësore ndaj besueshmërisë së reformave, financave publike dhe mbi të gjitha ndaj interesit legjitim të qytetarëve për të marrë në kohë dhe me cilësi shërbimin nga gjykatat.

Ky vlerësim i pavarur tematik gjithashtu synon të stimulojë vëmendjen e Medias për të raportuar problematikën e vonesave gjyqësore, duke i dhënë më shumë zë qytetarëve që ankohen për zvarritje në dyert e gjykatave. INFOÇIP po punon paralelisht për të rritur aksesin e medias në gjykatë, duke koordinuar përpjekjet me KLGJ për rritjen e standarteve të ndërveprimit mes gjyqtarëve të medias dhe gazetarëve që mbulojnë gjyqësorin, përmes programit “Open Courts through Press Judges”.

Sektorit të shoqërisë civile i është besuar një rol aktiv në administrimin e drejtpërdrejtë të organeve të reja gjyqësore. Ky vlerësim i pavarur tematik synon të theksojë këtë rol si dhe të avancojë axhendën, duke adresuar mungesën e statistikës gjyqësore, një problem që për fat të keq ka ardhur duke u thelluar nga viti në vit.

INFOÇIP është një Qendër e specializuar që realizon vlerësime tematike të pavaruara për kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore në Republikën e Shqipërisë që prej viti 2013. Studimet dhe botimet e INFOÇIP për gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm, gjykatat administrative, përfshirë Gjykatën e Lartë kanë caktuar një gur themeli në drejtim të vlerësimit të dhënave gjyqësore nga shoqëria civile.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE DHE GJETJET KRYESORE

I. Kohëzgjatja gjyqësore në Apel për gjykimet e themelit

Për periudhën 2020-2023, INFOÇIP mblodhi dhe analizoi 37854 vendime gjyqësore të dhëna nga gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm (99 % të totalit të vendimeve gjyqësore). Prej tyre, 32499 i takojnë tre-vjeçarit 2020-2022, ndërsa 5355 vendime janë dhënë në 6-mujorin e parë të vitit 2023 (1 Shkurt-31 Korrik) në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në Tiranë.

Vendimet për çështjet e themelit përfaqësojnë pjesën më të madhe të ngarkesës të gjykimeve në apel¹⁰. Kjo kategori vendimesh, përveçse më e rëndësishmja, rezulton edhe më e vonuara krahasuar me të tjerat (*masa sigurimi, urdhra mbrojtje, etj*). Për periudhën 2020-2022 INFOÇIP mblodhi dhe analizoi 15593 vendime themeli (9915 civile dhe 5678 penale). Për 6-mujorin e parë të punës të GJAJP Tiranë, 1 Shkurt- 31 Korrik 2023, INFOÇIP analizoi 1987 vendime themeli (1367 penale dhe 641 civile).

Vlerësimi tematik i kohëzgjatjes gjyqësore për çështjet e themelit realizohet sistematikisht nga INFOÇIP që prej vitin 2016, duke siguruar një bazë krahasimi të plotë të treguesve që nga fillimi i Reformës në Drejtësi. Ky studim realizon për herë të parë një analizë të krahasuar të kohëzgjatjes së çështjeve të themelit duke nisur nga vitit 2016 e deri në 6-mujorin e parë të vitit 2023.

Kohëzgjatja e shqyrtimit gjyqësor për çështjet e themelit erdhi duke u përkeqësuar vit pas viti në gjykatat e apelit, duke u dyfishuar e madje duke u trefishuar në vitin 2022 krahasuar me vitin 2016. Përfundim bën vetëm Gjykata e Apelit Durrës e cila ka mundur të përmirësojë treguesit e krahasuar për kohën mesatare të shqyrtimit të çështjeve penale të themelit.

Tebela 1

Kohëzgjatja mesatare shqyrtim (ditë), CIVILE THEMELI						
viti	GJA Tirane	GJA Durres	GJA Vlore	GJA Shkoder	GJA Korce	GJA Gjirokaster
2016	377	361	346	325	147	96
2017	376	285	478	422	151	98
2018	437	267	546	392	135	110
2019	587	342	614	350	145	101
2020	714	420	692	448	222	-
2021	908	603	967	564	362	-
2022	1118	677	1084	603	533	-
Kohëzgjatja mesatare shqyrtim (ditë), PENALE THEMELI						
viti	GJA Tirane	GJA Durres	GJA Vlore	GJA Shkoder	GJA Korce	GJA Gjirokaster
2016	325	310	262	264	135	60
2017	393	300	321	363	141	62
2018	406	253	391	426	125	78
2019	411	270	433	353	131	98
2020	358	319	352	413	149	-
2021	621	376	505	428	184	-
2022	635	301	372	343	322	-

¹⁰ Vendimet e dhena për çështjet e themelit ishin 47% e totalit të vendimarrjes në Apelin e Tiranës për vitin 2022, në GJA Shkodër 44%, në GJ. Apelit Durrës dhe GJ. Apelit Gjirokaster 39%, në GJA Korce 36%.

II. Afatet e gjykimit të arsyeshëm në Apel, krahasimi 2016-2023

Parimi i gjykimit brenda një afati të arsyeshëm ka rëndësi themelore për gjykimin civil, administrativ dhe penal. Ai përbën një nga elementët e procesit të rregullt ligjor, parashikuar në nenin 6 të KEDNJ. Ky parim bazohet në postulatin “*drejtësia e vonuar është drejtësi e mohuar*”. Respektimi i parimit të gjykimit të shpejtë dhe pa vonesa është kriter përcaktues për efektivitetin e gjykimit¹¹.

Qendra për Çështje të Informimit Publik, INFOÇIP në kuadër të këtij monitorimi ka vlerësuar për herë të parë situatën e vendimeve gjyqësore që dalin jashtë afateve të arsyeshme. Legjitimiteti i këtij vlerësimi tematik caktohet nga parashikimet e nenit 399/2 të K.Pr.C, i ndryshuar ky në vitin 2017 në kuadër të Reformës në Drejtësi. Sipas përcaktimeve të këtij neni, *në gjykimin civil në shkallë të parë, të dytë dhe të tretë afat i arsyeshëm konsiderohet përfundimi i procesit brenda dy viteve. Në gjykimin penal në shkallë të parë, afati i gjykimit të krimeve është 2 vjet dhe i kundërvajtjeve 1 vit; përfundimi i gjykimit në apel për krimet [duhet të mbyllet] në një afat kohor prej 1 viti dhe për kundërvajtjet penale në 6 muaj; në Gjykatën e Lartë, përfundimi i gjykimit për krimet [duhet të mbyllet] në një afat kohor prej 1 viti dhe për kundërvajtjet në 6 muaj.*

Objekt vlerësimi sa i takon tejkalimit të afatit të arsyeshmë janë vetëm çështjet e themelit (civile dhe penale), të cilat janë kategoria më voluminoze e vendimarrjeve në apel. Këto çështje janë gjithashtu më të prekura prej fenomenit të vonesave, krahasuar me tipologjitë e tjera të vendimeve. Masat e sigurimit, urdhrat e mbrojtjes, njehsimet apo rivendosjet në afat, preken pak ose aspak nga rreziku i daljes jashtë afateve të arsyeshme, për shkak të afatit ligjor prekluziv, i cili nëse shkelet, mund të pasojë me penaltete për gjyqtarin apo me humbjen e fuqisë juridike të vendimit¹².

❖ Afati i arsyeshëm për çështje CIVILE themeli në apel

Nga vlerësimet e ndërmarra për periudhën 2020-2022, rezulton një përkeqësim i ndjeshëm i treguesve sa i takon tejkalimit të afateve të gjykimit të arsyeshëm, sidomos në gjykimin civil të çështjeve të themelit. Për këto të fundit, përkeqësimi vijoi të thellohet edhe në 6-mujorin e parë¹³ të funksionimit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, e cila filloi nga puna në 1 Shkurt 2023 si rezultat i Reformës së Rretheve Gjyqësore.

Në vitin 2016, në të gjitha gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm të marra së bashku, jashtë afatit të arsyeshëm të gjykimit dilnin rreth 1% e totalit të çështjeve civile të themelit. Ndërkohë, në vitin 2022, jashtë këtij afati sensitiv për të drejtat e njeriut dolën 54% e totalit.

¹¹ Shih vendimin H. kundër Francës, datë 24.10.1989 të GJEDNJ

¹² Ankimi kundër masave të sigurimit është një e drejtë që garantohet nga neni 249 i Kodit të Procedurës Penale. Ankimi shqyrtohet brenda 10 ditëve nga marrja në dorëzim e akteve (paragrafi 6, neni 249, KPrP)...Gjykata depoziton vendimin e arsyetuar brenda 10 ditëve (paragrafi 7, neni 249, KPrP). Kur vendimi nuk shpallet ose nuk zbatohet brenda afatit të caktuar, akti në bazë të të cilit është marrë masa shtrënguese e humbet fuqinë (paragrafi 8, neni 249, KPrP).

¹³ Periudha e matur: 1 Shkurt 2023 deri në 31 Korrik 2023

Tab. 2


VITI	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023 ¹⁴
CIVILE THEMELI TOTAL VENDIME	6470	6510	4983	3671^{*15}	1493	1937	1729	641
TEJ AFATIT TE ARSYESHEM	57	90	367	783	478	926	940	502
Në %	0.9%	1.4%	7.4%	21%	32%	47.8%	54.3%	78.3%

Tabela 2 sugjeron se kapaciteti gjykses i dhomave civile në apel ka ardhur në rënie vit pas vitit. Në vitin 2016 këto dhoma arrinin të evadonin 6470 dosje civile themeli, kurse në vitin 2022 ky volum ra në vetëm 1729 dosje civile themeli (mbi 2/3 më pak).

Në vitin 2023, në 6-mujorin e parë të punës së GJAJP Tiranë, 78% e dosjeve civile të themelit që morën vendim, dolën jashtë afatit të arsyeshëm të gjykimit (2 vjet, sipas parashikimeve të nenit 399/2 të K.Pr.C.). Ky është një përkeqësim me 24 pikë përqindje krahasuar me vitin paraardhës, çka përbën edhe treguesin përkeqësues me intensitetin më të lartë të matur për periudhën 8-vjeçare 2016-2023.

Grafiku 1 më poshtë sugjeron edhe se trendi përkeqësues sa i takon tejkalimit të afatit të arsyeshëm në gjykimet civile të themelit ka qenë në përkeqësim konstant që nga vitit 2016.

Grafik 1



¹⁴ Numratori i ri i GJAJP Tiranë për vendime themeli civile hapet me vendim nr.1, dt 6 Shkurt 23 dhe në kohen e marrjes së të dhënave nga INFOCIP mbyllet me vendimin nr. 641, dt 20 Korrik 2023.

¹⁵ **Shënim:** Tek Civile Themeli, viti 2019, jashtë përllogaritjes janë vendimet e dhëna në 6-mujorin e dytë nga GJA Shkodër dhe GJA Korçë. Bashkëlidhur kësaj përmbledhje ekzekutive janë linket e tabelave për cdo gjykatë Apeli për vlerësimin e afatit të arsyeshëm të vendimeve për çështje themeli në periudhën 2016-2022. Mungesa ndikon më pak se 3% ose aspak në rezultatin e përllogaritur në përqindje.

❖ Afati i arsyeshëm për çështje PENALE themeli në apel


Lidhur me gjykimet për çështje PENALE themeli, nga analiza rezultojnë se në vitin 2016 jashtë afatit të arsyeshëm dëlnin rreth 27% e totalit të dosjeve të shqyrtuara. Viti më treguesit më të përkeqësuar rezultojnë 2018-ta, me 51% të totalit të vendimeve të dhëna tej afateve të arsyeshme. Ky rezultojnë gjithashtu edhe vitet me numrin më të madh të vendimeve të dhëna në apel për çështje penale themeli. Ndërkohë, në vitet 2021-2022, jashtë afatit 1-vjeçar dolën 44% e totalit të dosjeve penale të themelit.

Në periudhën 1 Shkurt-31 Korrik 2023, (6-mujori i parë i punës së GJAJP Tiranë), jashtë afatit të arsyeshëm dolën 44% e totalit të çështjeve penale të themelit. Tabela 3 sugjeron gjithashtu se kapaciteti gjykoës i dhomave penale në apel ka ardhur në rënie vit pas viti. Në vitin 2016 këto dhoma arrinin të evadonin 4569 dosje penale themeli, kurse në vitin 2022 ky volum thuajse u pëgjysmua me vetëm 2307 vendime.

Tab. 3

VITI	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023 ¹⁶
PENALE THEMELI	4569	4622	5048	2643	1193	1762	2307	1346
TOTAL VENDIME								
JASHTË AFATIT	1241	2240	2567	1118	409	787	1022	599
TE ARSYESHËM								
Ne %	27%	48%	51%	42.3%	34.2%	44.6%	44.3%	44.5%

Graf. 2



Shënim metodologjik: Afatet e gjykimit janë përllogaritur nga momenti i depozitimit të ankimit deri në datën e dhënies së vendimit në sallën e gjyqit. Koha e arsyetimit/dorëzimit të vendimit penal nuk është marrë parasysh në përllogaritje¹⁷. Kjo do të thotë që afatet e gjykimit të arsyeshëm në këtë studim e reflektojnë më pozitivisht sa sa është në realitet situatën. Në rastin e gjyimeve penale (themelet), shifra e referuar në tabelën më sipër është gjithashtu më pozitive se në realitet, pasi në analizën nuk diferencohet koha e gjykimit të arsyeshëm për kundavajtjet penale, që është sa gjysma e kohës për veprat kriminale (respektivisht 6 muaj dhe 1 vit në apel).

¹⁶ Numratori i ri i GJAJP Tiranë për vendime penale themeli hapet me vendim nr.1, dt 1 Shkurt 23 dhe në kohen e marrjes së të dhënave nga INFOCIP mbyllet me vendimin nr. 1346, dt 31 Korrik 2023.

¹⁷ shih vendimin e GJEDNJ në çështjen "Hadjianastassiou kundër Greqis", sipas të cilit mosdhënia e një vendimi të arsyetuar për të akuzuarin në kohën e duhur nuk i dha atij mundësi (kohe dhe mjete të mjaftueshme) të paraqiste argumentet e tij për t'u ankuar në Gjykatën e Kasacionit. Mosdhënia nga ana e gjykatës e vendimit të arsyetuar me shkrim brenda një kohe të arsyeshme solli si pasojë mos-lejimin e të paditurit për të ushtruar në mënyrë të efektshme të drejtën e tij për rishikimin e vendimit nga një gjykatë më e lartë.

III. Reforma e Rretheve Gjyqësore, stoku dhe trupa gjyqësore në Apel

Që prej 1 Shkurtit 2023, në kuadër të Reformës së Rretheve Gjyqësore, 6 gjykata apeli¹⁸ u shkrinë në një gjykatë të vetme me seli në Tiranë. Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë (*shkurt: GJAJP*) nisi punë me vetëm 24 gjyqtarë, nga 78 të miratuar në organikë. Në shtator 2023 trupa numëronte 22 gjyqtarë. Në Dhjetor 2023 pritet largimi i gjyqtarës E.Muçi (pavarësisht se ajo do të zëvendësohet). Deri në dhjetor 2023, numri maksimal i projektuar është 25 gjyqtarë.

Sipas KLGJ¹⁹, të 6 gjykatat e apelit para se të shkriheshin në një të vetme, trashëguan një stok prej 31370 çështjesh (fundi i vitit 2022 vlerësimi i fundit). Sipas të dhënave të mbledhura nga INFOÇIP në GJAJP Tiranë, deri në shtator 2023, stoku i çështjeve, së bashku me prurjet e reja, arriti në 36 mijë dosje. Nga informacioni i përditësuar në datë 11 Tetor 2023, stoku në GJAJP Tiranë arriti në 37 mijë dosje. Projektioni për stokun (bartje+prurje) deri në dhjetor 2023 është më e pakta 38000.

Nëse një trupë prej vetëm 25 gjyqtarësh do të punonte për të evaduar stokun aktual prej 37000 dosjesh, me një mesatare prej 300 vendimesh në vit²⁰ për secilin gjyqtar (*çdo ditë një gjyq fillim-mbarim pasuar nga vendimi*), do të nevojiteshin rreth 5 vite vetëm për të evakuuar stokun, pa marrë në shqyrtim asnjë ankim të ri që do të vinte ndërkohë. Mund të hamendësohet se një shumicë e konsiderueshme vendimesh do të duhet të merreshin tej afateve të arsyeshme. Nëse gjyqtarët aktualë, do të rrisnin treguesit e eficiencës nga 300 në 600 vendime në vit secili²¹, sërish do të nevojiteshin përafërsisht 2 vjet e gjysëm për evadimin e këtij stoku historik.

Nëse trupa e gjyqtarëve në GJAJP Tiranë do të ishte e përbërë nga 78 gjyqtarë, atëherë, ky stok do të evadohej për 1.5 vjet, nëse *Rendimenti Mesatar për gjyqtar* (treguesi ER) do të përllogaritej normën prej 300 vendimesh/vit. Për t'u përafëruar me treguesit e para-Reformës (viti 2016), numri i gjyqtarëve në GJAJP Tiranë në do duhet të ishte të paktën 100 (koha e evadimit vetëm për stokun aktual: 1.2 vjet).

Mungesa e gjyqtarëve vlerësohet nga ky studim si shkak kryesor i vonesave gjyqësore në rritje. Ndryshimi i disa rregullave procedurale në administrimin e procesit gjyqësor mund të ketë patur gjithashtu një impakt negative në disa raste. Ndërkohë, metodat e administrimit gjyqësor nuk identifikohen si një ndër shkaqet e vonesave gjyqësore. Lidhja shkak-pasojë mes numrit efektiv të gjyqtarëve dhe mesatares vendimarrëse për gjyqtar është evidente, po të analizohen veç e veç treguesit për çdo gjykatë apeli në periudhën 2020-2023. Largimi i gjyqtarëve përmes procesit të vetingut, nuk është pasuar nga një strategji efikase për zëvendësimin e tyre në apel, me qëllim eliminimin e kushteve për zvarritje gjyqësore. Reforma e Rretheve Gjyqësore rrezikon të mos prodhojë objektivat e synuar në terma të aksesit në drejtësi nëse nuk adresohet me urgjencë shtimi i trupës gjyqësore.

¹⁸ Gjykatat e Apelit në Tiranë, Durrës, Vlorë, Shkodër, Korçë, Gjirokastrë

¹⁹ faqja 76 e Reportit të KLGJ për vitin 2022

²⁰ 300 vendime në vit është 1 vendim në çdo ditë efektive pune që ka viti kalendarik. Ndërkohë, sipas treguesve zyrtarë të KLGJ, rendimenti mesatar për gjyqtar (treguesi ER) në Gjykatën e Apelit Tiranë për vitin 2022 ka qenë 302.9 ditë. Mesatarja ER për të 6 gjykata e Apelit përllogaritet në 311 ditë, për një total prej 35 gjyqtarësh në 6 gjykata e Apelit. Në vitin 2023, në të vetmen gjykatë apeli të juridiksionit të përgjithshëm ka një numër efektiv prej 22.5 gjyqtarësh (24-21).

²¹ treguesit më të lartë të matur për vitin 2021 dhe 2021 i ka patur GJA Durrës, me 455 çështje në vit për gjyqtar.

IV. Masat e sigurimit gjatë gjykimit në apel, 2020-2023

Për herë të parë INFOÇIP ka vlerësuar edhe respektimin e afateve ligjore për masat e sigurimit në apel. Në shumicë dërrmuese, vendimet për masa sigurimi në shkallë të parë ankimohen në apel. Këto lloj çështjesh përfaqësojnë thuhajse gjysmën e ngarkesës gjyqësore në apel në terma të volumit vendimarrës.

Ankimi kundër masave të sigurimit në apel duhet të shqyrtohet **brenda 10 ditëve** nga marrja në dorëzim e akteve (paragrafi 6, neni 249, KPrP), ndërkohë që vendimi i arsyetuar duhet të depozitohet **brenda 10 ditëve** (paragrafi 7, neni 249, KPrP).

Nga të dhënat e analizuar nga INFOÇIP për 3-vjecarin e fundit, rezulton se kohëzgjatja mesatare për shqyrtimin e ankimeve në apel ndaj masave të sigurimit nuk e kapërcen afatin ligjor 10-ditor.

Tebela 4

MASA SIGURIMI APEL - Kohezgjatja mesatare shqyrtim (ditë)

viti	Gj. Apelit Tirane	Gj. Apelit Dures	Gj. Apelit Vlore	Gj. Apelit Shkoder	Gj. Apelit Korce	Gj. Apelit Gjirokaster
2020	6.1	9.5	9.6	6	7.5	-
2021	5	8.3	6.9	6.9	9.2	-
2022	6.5	6	9.7	7.5	8.9	-

Por, nëse analizohen vec e veç, një pjesë jo e vogël e vendimeve për ankimim masë sigurimi në apel gjithsesi dalin jashtë afatit-10 ditor të shqyrtimit (15-30% e totalit sipas gjykatës). Nga 8009 gjykime apeli për masa sigurimi, 535 ose 6.67% kanë tejkaluar afatin ligjor 10-ditor për periudhën e analizuar 2020-2022 në 5 gjykata apeli të juridiksionit të përgjithshëm (Gj. Apelit Gjirokastër nuk është e përfshirë) . Në disa raste të konstatuara, vonesat në shqyrtim ndaj ankimit për masë sigurimi në apel kanë zgjatur mbi 100 ditë.

Tebela 5

MASA SIGURIMI APEL – Shqyrtime jashtë afatit 10-ditor

viti	Gj. Apelit Tirane	Gj. Apelit Dures	Gj. Apelit Vlore	Gj. Apelit Shkoder	Gj. Apelit Korce	Gj. Apelit Gjirokaster
2020	45 (3.9%)	63 (13.7%)	6 (1.38%)	5 (1.8%)	40 (28.5%)	-
2021	37 (3%)	45 (10.8%)	34 (6.3%)	17 (4.3%)	45 (15.6%)	-
2022	61 (5.3%)	25 (5.4%)	43 (9%)	14 (4.3%)	55 (23.1%)	-

VITI 2023 - INFOÇIP analizoi edhe 1000 vendime për masa sigurimi të dhëna në periudhën 1 Shkurt-4 Korrik 2023 nga GJAJP Tiranë. Për herë të konstatohet se mesatarja në shqyrtim e ankimeve për masë sigurimi kapërceu pragun pragun ligjor duke u ngjitur në 10.5 ditë. Nga këto 1000 raste të analizuar, në 88 prej tyre vendimet janë marrë tej afatit ligjor 10-ditor të shqyrtimit. Në këtë kuptim, treguesit kanë vijuar të përkeqësohen pas Reformës së Rretheve Gjyqësore.

Problem serioz mbeten afatet e arsyetimit /dorëzimit të vendimit për masë sigurimi. Ky tregues, i mesatarizuar për çdo gjykatë, për të treja vitet e marra në analizë 2020-2023 është tejkaluar në të gjitha rastet (shih tab. 6). Gjykata e Apelit Vlorë dhe Durres nuk i reflekton në numratorin përkatës datat e dorëzimit të këtyre vendimeve, por i administrojnë në regjistra të veçantë që mbahen nga sekretarët e gjyqtarëve. (Për Gj. Apelit Gjirokastër, të dhënat nuk janë përpunuar në këtë studim !)

Situata më problematike për periudhën 2020-2022 është konstatuar nga INFOÇIP në Gj. Apelit Korçë. Kjo ka qenë edhe gjykata e parë ndër apelet që humbi gjyqtarët për shkak të procesit të vetingut. Megjithë skemën e delegimit të aktivizuar si një zgjidhje emergjente për këtë gjykatë, treguesit vijuan të përkeqësohen sistematikisht sa i takon arsyetimit të vendimeve për masat e sigurimit.

Numri i vendimeve të arsyetuara tej afatit ligjor 10-ditor është në të gjitha rastet e analizuara ndjeshëm më i madh se numri i vendimeve të dorëzuara në afat. Kur vendimi nuk shpallet ose nuk zbatohet brenda afatit të caktuar, akti në bazë të të cilit është marrë masa shtrënguese e humbet fuqinë (paragrafi 8, neni 249, KPrP).²²

Tebela 6

MASAT E SIGURIMIT - Kohëzgjatja mesatare në dorëzim (ditë)						
viti	Gj. Apelit Tirane	Gj. Apelit Durres	Gj. Apelit Vlore	Gj. Apelit Shkoder	Gj. Apelit Korce	Gj. Apelit Gjirokastr
2020	36.7	-	-	23	52.5	-
2021	32	-	-	22.1	85.5	-
2022	35.4	-	-	24.3	89.2	-

Tebela 7

MASAT E SIGURIMIT - jashtë afatit 10-ditor DORËZIM						
viti	Gj. Apelit Tirane	Gj. Apelit Durres	Gj. Apelit Vlore	Gj. Apelit Shkoder	Gj. Apelit Korce	Gj. Apelit Gjirokastr
2020	811 (71.2%)	-	-	189 (69.4%)	191 (79.5%)	-
2021	958 (79%)	-	-	304 (78%)	264 (94.9%)	-
2022	875 (74.5%)	-	-	211 (66%)	218 (91.5%)	-

VITI 2023 - INFOCIP analizoi 1000 vendime për masa sigurimi të dhëna në periudhën 1 Shkurt-4 Korrik 2023 nga GJAJP Tiranë. Mesatarja në dorëzimin e këtyre vendimeve rezultoi 34.1 ditë. Ky është një tejkalim me gati trefish i afatit ligjor që cakton paragrafi 7 nenit 249, KPrP. **Nga këto 1000 raste të analizuara, 755 vendime (75.5% e totalit) janë arsyetuar/dorëzuar tej afatit ligjor në sekretarinë e GJAJP, Tiranë. Ky konsiderohet një tregues shumë problematik në kuadër të këtij studimi.**

²² Mbetet e paqartë se si do duhet të trajtohet kjo problematikë e hasur në gjykatat e apelit sa i takon vlefshmërinë ligjore të shumicës dërrmuese të vendimeve ndaj ankimeve për masat e sigurimit. Gjykata Kushtetuese ka theksuar domosdoshmerine e arsyetimit të vendimeve gjyqesore, penale apo civile, si nje garanci për procesin ligjor. Mungesa e pjesës së arsyetuar të vendimit cënon integritetin dhe ligjshmerine e vetë procesit/vendimit gjyqësor. Po ashtu, Kolegjet e Bashkuara te Gjykeses së Larte në vendimin nr. 5, date 12.12.2013, kane elaboruar rrethanat në të cilat vonesat në arsyetimin e vendimit gjyqësor passjellin pergjegjesi disiplinore për gjyqtarin.

V. Urdhrat e mbrojtjes gjatë gjykimit në apel

INFOÇIP ka analizuar për herë të parë kohëzgjatjen e shqyrtimit gjyqësor të urdhrave të mbrojtjes në apel për periudhën 2020-2023. Të dhënat e analizuar shërbejnë si *bazë* krahasimi me të dhënat e mbledhura në GJAJP Tiranë (6-mujori i parë 2023), për vlerësimin e trendit në kuadër të Reformës së Rretheve Gjyqësore.

Ligji nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, parashikon në nenin 21 të tij se Gjykata e Apelit shprehet me vendim brenda 15 ditëve nga dita e regjistrimit të ankimit ndaj urdhrit të mbrojtjes.

Ankimet për urdhrat e mbrojtjes në apel përfaqësojnë një volum relativisht të vogël çështjesh, krahasuar me tipologjitë e tjera. Në 3-vjecarin 2020-2022, rezultojnë 4047 vendime në apel për masa sigurimi, në 5 gjykata apeli të juridiksionit të përgjithshëm (përfshijtur Gj. Apelit Gjirokastrë). Ndërkohë, në 6-mujorin e parë të punës së GJAJP Tiranë u dhanë 113 vendime për urdhra mbrojtje, sipas numratorit përkatës. INFOÇIP mblodhi dhe analizoi 37854 vendime gjyqësore të dhëna nga gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm (2020-2022 dhe 6-mujori parë Shkurt-31 Korrik 2023), që do të thotë se apelimi i urdhrave të mbrojtjes zuri rreth 10.9% të totalit vendimarrës në shkallën e dytë të gjykimit.

Kohëzgjatja mesatare në shqyrtim e ankimit në apel të udhrave të mbrojtjes e tejkalon afatin ligjor 15-ditor në të gjitha rastet e analizuar²³, (tab. 8). Gjykata e Apelit Tiranë ka treguesit më problematikë sa ai takon tejkalimit të afateve ligjore për këto lloj shqyrtimesh gjyqësore në periudhën 2020-2022 (Tab 9.)

Tebela 8

URDHRAT E MBROJTJES - Kohëzgjatja mesatare shqyrtim (ditë),						
viti	GJA Tirane	GJA Durres	GJA Vlore	GJA Shkoder	GJA Korce	GJA Gjirokastrer
2020	72.7	-	15.8		23	-
2021	62	35	18.3	21	16.8	-
2022	57	22	26.6	27	32	-

Tebela 9

URDHRAT E MBROJTJES – vendime jashtë afatit ligjor të shqyrtimit						
viti	GJA Tirane	GJA Durres	GJA Vlore	GJA Shkoder	GJA Korce	GJA Gjirokastrer
2020	42 (64.6%)	-	6 (17%)	-	3 (33.3%)	-
2021	80 (90.9%)	9 (36%)	17 (33%)	13 (50%)	3 (42.8%)	-
2022	100 (84%)	3 (20%)	28 (59.5%)	7 (50%)	4 (80%)	-

Në 6-mujorin e parë të punës së GJAJP Tiranë, mesatarja e shqyrtimit të urdhrave të mbrojtjes në Apel rezultoi 31.7 ditë, mesatarja e dorëzimit 51 ditë, ndërsa totali i vendimeve të nxjerra jashtë afatit ligjor ishte 70, ose rreth 62% e totalit prej 113 vendimesh gjithsej të analizuar.

²³ Për gjykatat e Apelit Shkodër dhe Durrës nuk ka qenë e mundur analizimi i treguesve për vitin 2020, ndërkohë që mungojnë të dhënat për Gj. Apelit Gjirokastrë në këtë studim.

VI. Sinteza & Rekomandime

Mungesa e gjyqtarëve në apel vlerësohet nga ky studim si shkaku kryesor i vonesave gjyqësore në rritje. Largimi i gjyqtarëve përmes procesit të vetingut, nuk është pasuar nga një strategji efikase për zëvendësimin e tyre në apel, me qëllim eliminimin e kushteve për zvarritje gjyqësore. Lidhja shkak-pasojë mes numrit efektiv të gjyqtarëve dhe mesatares vendimarrëse për gjyqëtar është evidente, po të analizohen veç e veç treguesit për çdo gjykatë apeli në periudhën 2020-2022, dhe mandej edhe për 6-mujorin e parë të punës të GJAJP Tiranë (1-Shkurt – 31 Korrik 2023).

Pas Reformës së Rretheve Gjyqësore, skema e delegimit të gjyqtarëve rezultoi në jetë pezulluar, duke pamundësuar në këtë mënyrë “subvencionimin” GJAJP Tiranë me gjyqtarët e munguar. Gjykata e re nisi punën me vetëm 24 gjyqtarë nga 78 që duhet të kishte si rregull. Gjatë vitit 2023, ky numër vijoi të zvogëlohet (22), për të arritur sërish në 24 në Nëntor 2023.

Reforma e Rretheve Gjyqësore rrezikon të mos prodhojë objektivat e synuar në terma të aksesit në drejtësi nëse nuk adresohet me urgjencë shtimi i trupës gjyqësore. Kjo urgjencë duhet më së pari të adresohet në shkallën e dytë të gjykimit. Aksesit në drejtësi nuk është thjesht një çështje distancash, por mbi të gjitha një çështje e zgjidhjes efektive, brenda një afati optimal, të një mosmarrveshje që mbërrin në gjykatë.

Ndryshimi i disa rregullave procedurale në administrimin e procesit gjyqësor mund të ketë patur një impakt pozitiv në disa raste. Konkretisht, gjykimi i ankimeve për masat e sigurimit me një gjyqtar të vetëm ka siguruar efektivitet më të lartë në përballjen me këtë kategori çështjesh gjyqësore. Megjithatë, mbetet për t'u vlerësuar cilësia në gjykimet përkatëse, nisur nga rrethana që një trupë gjykuese me 3 anëtarë bën një peshim/vlerësim më gjithpërfshirës krahasuar me një gjyqtar të vetëm.

Metodat e administrimit të gjykatës nuk identifikohen si një ndër shkaqet kryesore të stokut apo vonesave gjyqësore deri në vitin 2022. Pas aktivizimit të Reformës së Rretheve Gjyqësore, sa i takon apelit të juridiksionit të përgjithshëm, administrimi gjyqësor përballet me sfidën e madhe të mungesës së sallave të gjyqit. Kjo rrethanë nuk e vendos në eficiencë as trupën e pakët gjyqësore që aktualisht gjykon në GJAJP Tiranë. Një skenar i funksionimit të kësaj gjykate me 78 gjyqtarë në godinën aktuale është krejtësisht i pamundur. Në kushtet aktuale infrastrukturore edhe vetë ri-aktivizimi i skemës së delegimit në apel përbën sfidë, pasi godina aktuale nuk ka zyra për të akomoduar më shumë se sa 35 gjyqtarë si dhe ka akoma më pak salla për të zhvilluar gjykime.

Mungesa e sistemeve adequate që shërbejnë për menaxhimin e çështjeve gjyqësore krijon një vështirësi të shtuar në funksionimin e GJAJP Tiranë. Automatizimi i procesit të mbartjeve është një domosdoshmëri në kushtet e krijuar me një *backlog* në zmadhim të vazhdueshëm. Pavarësisht shtimit të personelit në sekretarinë e gjykatës, formatet analoge të proceseve të punës ngadalësojnë menaxhimin, janë jo-efektive dhe nuk sigurojnë saktësinë e synuar në regjistrimin e të dhënave.

Bazuar në sa më sipër, rekomandimet kryesore janë:

Të shtohet numri i gjyqtarëve në apel përmes ri-aktivizimit efektiv dhe pa kushtëzime të panevojshme të skemës së delegimit në apel nga KLGJ. Të vlerësohet me përparësi mundësia e caktimit përmes instrumentit të karrierës të gjyqtarëve në Apelin e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, duke marrë masa efektive për adresimin e situatës përmes identifikimit të gjyqtarëve që përmbushin kriteret ligjore të përvojës dhe motivimin e tyre në karrierë.

Të dyfishohet ose dhe trefishohet numri i ndihmësave ligjorë të cilët ofrojnë ndihmesën e tyre në GJAJP Tiranë. Aktualisht ka më pak ndihmësa efektive se sa gjyqtarë efektive në këtë gjykatë.

Të rritet shkalla e koordinimit mes institucioneve të qeverisjes gjyqësore dhe institucioneve të përkohshme të vetingut. Magjistratët e dalë nga bankat e Shkollës së Magjistraturës nuk kualifikohen për të zëvendësuar vankancat në apel për shkak të kriterit të përvojës (8 vjet). Interesi publik për drejtësi efektive duhet të prevalojë; Interesi i shtetit shqiptar për të mos rrezikuar dënime nga GJEDNJ gjithashtu duhet të prevalojë. Interesi i vetë gjykatave për të mos u shkrirë si institucione për shkak të mungesës së gjyqtarëve gjithashtu duhet të konsiderohet me shumë kujdes.

Rritja sistematike e stokut në apel duhet konsideruar një emergjencë kombëtare për arsyen se është në përmasa historike, me trend të qartë rritës dhe sepse ka potencialin të godasë besimin tek Reforma në Drejtësi. KLGJ duhet urgjentisht të përgatisë një strategji të qartë, efektive dhe të përgjegjshme për të nxjerrë GJAJP Tiranë, por edhe atë të Apelit Administrativ nga kriza e stokut historik të akumuluar.

Të vlerësohet mundësia për të prioritarizuar në shqyrtimin gjyqësor në apel çështjet që rrezikojnë të dalin jashtë afatit të gjykimit të arsyeshëm. Një vlerësim paraprak përmes sekretarisë gjyqësore i çështjeve të mbartura duhet të realizohet pa vonesë për të shmangur rriskun e penalizimit me bekllog shtesë të gjykatave të shkallë më të larta me çështje me objekt vonesat gjyqësore. Gjithashtu, ky filtrim i shërben në tërësi shtetit shqiptar për të mos u penalizuar në të ardhmen e afërt nga GJEDNJ, në vazhden e precedentit “Bara dhe Kola kundër Shqipërisë”

Të ri-konsiderohet në kuadër të rishikimit të Reformës së Rretheve Gjyqësore zgjerimi në të paktën tre gjykata apeli për të adresuar në kohë dhe me cilësi mungesën e sallave dhe mjediseve të tjera mbështetëse që mundësojnë gjykimin në shkallë të dytë. Opsioni për të prituri deri në ndërtimin e një gjykate të re apeli në Tiranë favorizon shtimin e stokut gjyqësor dhe penalizon qytetarët duke shkelur të drejtat e tyre për një drejtësi pa vonesa dhe në çdo rast brenda një afati të arsyeshëm.

Kostot eventuale që vijnë si pasojë e adresimit me padi në gjykatën kompetente të tejkalimit të afatit të arsyeshëm të gjykimit të përlllogariten si kosto oportune të Reformave dhe mos t'i shkarkohen mbi supe qytetarëve dhe përdoruesve të tjerë të gjykatave. Një fond i posaçëm kontigjence për subjektet e dëmtuara nga zvarritjet gjyqësore duhet të konsiderohet për parashikime në buxhetin e gjykatave ose në buxhetin e shtetit. Afati 3-vjeçar i vlerësuar si shkak objektiv për vonesa gjyqësore në kuadër të Reformës Gjyqësore e ka humbur brendinë dhe kuptimin tashmë që vetë Reforma në Drejtësi përgatitet të hyjë në vitin e saj të 9-të që nga koha e miratimit të ligjeve të saj.

Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ka vijuar të shtojë stokun gjyqësor nga 32 000 në 37 000 nga 1 Shkurti 2023 kur nisi nga puna deri në Tetor 2023, kur u bë edhe rakordimi i fundit për qëllime të këtij Vlerësimi Tematik. Parimi i përkohshmërisë mbi të cilin bazohet deri më sot argumenti kryesor për dekurajimin e ankesave për vonesa gjyqësore në gjykatën e shkallës më të lartë, konkretisht *rrethanat objektive të shkaktuara nga procesi i vetingut*, rrezikon të përmbysët në një realitet të përhershëm nëse stoku në Apel tejkalon 40 mijë dosje në vitin 2024.

Gjykata kompetente duhet të jenë krah publikut të penalizuar nga vonesat gjyqësore tashmë kronike dhe jo anasjelltas kur rekursohet tejkalmi i afateve të arsyeshme gjatë gjykimit në apel. Kompromentimi i shanseve për një shpërblim të drejtë nga gjykatat vendase sa i takon fenomenit në fjalë vetëm sa do të riciklojë problemin në gjykatën Kushtetuese dhe më tej në GJEDNJ, Strasbourg.

Sipas arsyetimit të vetë GJEDNJ në çështjen Bara & Kola kundër Shqipërisë (Tetor 2021), reformat nuk mund të konsiderohen “rrethana objektive që bëjnë të pamundur” shqyrtimin e çështjeve, të paktën brenda logjikës së nenit 6 të Konventës; kjo qasje do ta zhvendoste të gjithë barrën e tyre mbi shpatullat dhe në dëm të individëve. Sidoqoftë, pasojat e reformës mund të merren parasysh në njëfarë mase në procesin e ponderimit konventor. Tendencia e përgjithshme e reduktimit (ose jo) të vonesave është një faktor i rëndësishëm në analizën e nenit 6¹. Në studimin e ndërmarrë nga INFOÇIP, tendencia e analizuar është në shumicën e rasteve përkeqësuese dhe konstante në këtë trend.

Komuniteti profesional i avokatëve duhet të inkurajohet të përdorë çdo mjet ligjor në dispozicion për të garantuar mbrojtje efektive të klientëve të tyre nga ekspozimi ndaj vonesave tej afatit të arsyeshëm. Garantimi i të drejtave të qytetarëve sa i takon një gjykim të drejtë e pa vonesa duhet të jetë një konstante në aktivitetin e tyre të përditshëm. Ata duhet të jenë mbrojtës aktiv të këtyre të drejtave si në gjykatat vendase ashtu edhe në GJEDNJ.

Avancimi i objektivave të dixhitalizimit gjyqësor është domosdoshmëri në kushtet emergjente me të cilat përballlet sot gjykimi në apel. Përmirësimi i sistemeve ekzistuese dhe adoptimi i sistemeve të reja më të avancuara janë një domosdoshmëri, që mund të sjellë përmirësim thelbësor në menaxhimin gjyqësor në apel. Këto sisteme janë relativisht shumë të lira krahasuar me kostot që prodhohen nga mos-përdorimi i tyre. Asistenca e partnerëve ndërkombëtarë të Reformës në Drejtësi duhet të kanalizohet në këtë drejtim pa humbur më kohë.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, si institucioni më i rëndësishëm i Reformës në Drejtësi, ka gjithashtu nevojë të ndihmohet me stafet përkatëse, sistemet e brendshme të menaxhimit të ankesave si dhe sisteme të tjera efektive që mundësojnë rolin e tij kontrollues ndaj vonesave arbitrare si në gjykim ashtu edhe në arsyetimin e vendimeve gjyqësore, të cilat çenojnë besimin e publikut tek gjykatat dhe Drejtësia në tërësi.

Vonesat e shprehura në arsyetimin brenda afatit ligjor të masave të sigurimit në apel, por edhe në shkallët më të ulëta duhet të merren në shqyrtim tematik të posaçëm duke evidentuar raste të mundshme parregullsish që përsëriten në mënyrë konstante.

1. Shkëputur nga fjala e gjyqtar Dorian Pavli, përfaqësues i Shqipërisë në GJEDNJ Strasbourg, me rastin e Konferencës ndërkombëtare në kuadër të 110 Vjetorit të Gjykatës së Lartë, Tiranë 10 Maj 2023.

GJETJET E VLERESIMIT TEMATIK VITI 2020-2023

GJYKATA E APELIT TIRANË

NGARKESA SIPAS LLOJIT TE ÇESHTJEVE DHE TRUPA GJYQESORE

Gjykata e Apelit Tiranë dha 3317 vendime gjatë vitin 2022; 2695 vendime në vitin 2021 dhe 2498 vendime në 2020-ën. *Tabela nr.1* paraqet treguesit e volumit vendimarrës të Gj. Apelit Tiranë për 3-vjeçarin 2020-2021-2022, sipas të dhënave që përmbajnë numratorët e kësaj gjykate.


Tabela 1

Lloji / Tipologjia	Total Vendime viti 2022	Total Vendime viti 2021	Total Vendime viti 2020
Çështje Civile Themeli	238	246	394
Çështje Penale Themeli	1322	735	515
Masa Sigurimi	1149	1212	1138
Urdhër Mbrojtje	119	88	65
Njohje vendim i huaj	259	175	138
Pezullim/rivendosje	230	239	248
TOTAL VJETOR	3317	2695	2498
Nr. efektiv gjyqtarësh²⁴	10.9	7.9	15.4
Mes. Vendime/Gjyqtar	304	341	162

Gjykata e Apelit Tiranë funksionoi gjatë vitit 2022 me 1/3 e kapacitetit të saj, konkretisht me 10.9 gjyqtarë të efektivë, nga 31 që kishte të dekretuar si trupë gjyqësore. Në tabelën 1, në dy rreshtat e fundit jepen të dhënat për numrin efektiv të gjyqtarëve dhe mesataren vendimarrëse të tyre për periudhën 2020-2022.

Masat e sigurimit përfaqësojnë numrin më të madh të shqyrtimeve gjyqësore, ndjekur nga çështje penale themeli dhe çështje civile themeli. Nëse grupohen penale dhe civile themeli së bashku, ato përbëjnë kategorinë me numrin më të madh të gjykimeve të përfunduara në vitin 2022. Në *grafikun 1* vihet re se, pavarësisht ngarkesës së gjykimit apo trupës gjyqësore, raportet mes kategorive të gjykimit tentojnë të jenë të pandryshuara. Dhoma Penale ka përballuar ngarkesë më të lartë (masa sigurimi dhe çështje penale themeli) krahasuar me Dhomën Civile.


Graf. 1



²⁴ Sipas raportimit zyrtar të KLGJ në raportet vjetore 2021 dhe 2022

Për të krijuar një vizualizim të raportit të shpërndarjes së ngarkesës, *grafiku 2* paraqet situatën për vitin 2022, ndërkohë që grafikët respektivë të çdo viti mund të hulumtohen në Platformën www.gjykataehapur.al. Në *grafikun 2* paraqitet sipas përqindjes ngarkesa e vitit 2022, ndërkohë tek legjenda (*djathtas*) jepet dhe numri për çdo tipologji/kategori vendimesh, sikurse rezulton në numratorët përkatës.

Grafiku 2



KOHËZGJATJA GJYQËSORE & ARSYETIM/DOREZIMI I VENDIMIT

INFOÇIP ka analizuar kohëzgjatjen gjyqësore për katër tipologji të rëndësishme vendimesh: Çështje **Civile Themeli**, Çështje **Penale Themeli**, **Masa Sigurimi** dhe **Urdhra Mbrojtje**. Periudha e matur dhe e analizuar përfshin 3 fasha kohore:

- *3-vjeçarin 2020-2022- kjo periudhë ndërlidh me të dhëna të krahasueshme periudhën 2016-2019 të cilën INFOCIP e ka analizuar në raportet pararendëse sa i takon treguesve të kohëzgjatjes gjyqësore, kryesisht për çështjet e themelit në shkallë të dytë të gjykimit. Fundi i periudhës 2020-2022 përkon me shkrirjen e 6 gjykatave të apelit në një gjykatë të vetme, të vendosur në Tiranë²⁵, e cila nisi nga puna në 1 Shkurt 2023.*
- *6-mujorin e parë të funksionimit të GJAJP Tiranë. Kjo periudhë fillon nga data 1 Shkurt 2023 deri në datën 31 Korrik 2023 duke krijuar bazë krahasimi për treguesit e kohëzgjatjes gjyqësore me periudhën 2016-2022 (para dhe pas Reformës së Rretheve Gjyqësore).*
- *Krahasim i të dhënave të periudhës 2016-2019 me të dhënat e reja të periudhës 2020-2022 dhe 6-mujori i parë 2023, për identifikimin e trendit të vonesave gjyqësore para dhe pas Reformës në Drejtësi në interval të pandërprerë 7-vjeçar.*

²⁵ Kjo gjykatë do të referohet më poshtë me akronimin GJAJP Tiranë.

ÇËSHTJE THEMELI, CIVILE DHE PENALE, 2020-2022

Të dhënat e analizuara nga INFOÇIP përmes Platformës www.gjykataehapur.al sugjerojnë se treguesit e shqyrtimit gjyqësor për gjykimet e themelit u përkeqësuan në mënyrë domethënëse nga viti 2020 e deri në fund të vitit 2022. Në 1 Shkurt 2023, kjo gjykatë u shkri bashkë me 5 gjykata të tjera apeli në GJAJP Tiranë.

Tabela 2 paraqet totalin e çështjeve të themelit, civile dhe penale, që ka mundur të shqyrtojë dhe të përmbylle me vendim Gj. Apelit Tiranë, në periudhën 2020-2022.

Tabela 3 ofron të dhënat për periudhën 2020-2022 mbi kohëzgjatjes mesatare në shqyrtim për çështjet e themelit, Penale dhe Civile, për Gjykatën e Apelit Tiranë.

Tabela 4 ofron të dhënat e tre-vjeçarit për këtë gjykatë sa i takon kohës së arsyetimit/ dorëzimit të vendimeve për çështjet e themelit, civile dhe penale.

Tabela 2

Lloji / Tipologjia	Total Vendime viti 2022	Total Vendime viti 2021	Total Vendime viti 2020
Civile Themeli	238	246	394
Penale Themeli	1322	735	515
Total Themele	1560	981	911

Tabela 3

GJA Tiranë	Mesatare shqyrtim (dite), viti 2022	Mesatare shqyrtim (dite), viti 2021	Mesatare shqyrtim (dite), viti 2020
Civile Themeli	1118	908	714
Penale themeli	635	621	358

Tabela 4

GJA Tiranë	Mesatare dorëzim (dite) 2022	Mesatare dorëzim (dite) 2021	Mesatare dorëzim (dite) 2020
Civile Themeli	60	46	23
Penale themeli	65	41	44

Konkluzione të përmbledhura për periudhën 2020-2022

Koha mesatare e pritjes së palëve ndërgjyqëse që Gjykata e Apelit Tiranë të përfundonte shqyrtimin e një ankimi për **çështje civile themeli** u përkeqësua ndjeshëm në vitin 2022 me 404 ditë më shumë se në viti 2020 (nga 714 ditë në 1118 ditë). Për **çështje penale themeli**, për të njëjtën periudhë vlerësimi, kohëzgjatja pothuajse u dyfishua (nga 358 në 635 ditë).

Koha e arsyetimit të vendimit pësoi përkeqësim të ndjeshëm në **çështje civile themeli themeli**, dorëzimi i të cilave mori trefish më shumë kohë në vitin 2022 krahasuar me 2020-ën (nga 23 ditë në 60 ditë). Arsyetimi i vendimeve në **çështje penale themeli** gjithashtu u përkeqësua mesatarisht nga 44 ditë në 65 ditë.

Analiza krahasuese 2016-2022 (vetëm gjykime themeli)

Vlerësimi tematik i kohëzgjatjes gjyqësore për çështjet e themelit në Gjykatën e Apelit Tiranë realizohet nga INFOÇIP që prej vitin 2015. *Baseline* për efekt të këtij studimi është zgjedhur viti 2016, që përkon edhe me fillimin e Reformës në Drejtësi.

Gjykimet e themelit zunë numrin më të madh të shqyrtimeve në Gjykatën e Apelit Tiranë në vitin 2022 me 47% të totalit vendimarrës (shih Graf. 2). Në vitin 2021 dhe 2020 ato zunë respektivisht 36.4% dhe 36.3% të totalit, duke u tejkaluar nga vendimet për masat e sigurisë (50% e totalit në 2021 dhe 45.5% në 2020).

Tabela më poshtë paraqet kohën mesatare të shqyrtimit gjyqësor dhe arsyetim/dorëzimit të vendimeve gjyqësore të themelit në Gjykatën e Apelit Tiranë për periudhën 2016-2022. Nga 1 Shkurti 2023, kjo gjykatë është “absorbuar” nga GJAJP Tiranë, e cila ka juridiksion tokësor për të gjithë Shqipërinë.

Tabela 5

Viti	Civile themeli mesatare shqyrtim (dite)	Penale themeli mesatare shqyrtim (dite)	Civile themeli mes. dorëzim (dite)	Penale themeli mes. dorëzim (dite)
2016	377	325	13.8	9.7
2017	376	393	12	12
2018	437	406	15	13.8
2019	587	411	18.6	18.5
2020	714	358	23	44
2021	908	621	46	41
2022	1118	635	60	65
2023 ²⁶	646	547	-	-


Në krahasim me vitin 2016, kohë e cila përkon me fillimin e Reformës në Drejtësi, e deri në fund të vitit 2022, një muaj më pas kjo gjykatë u shkri në GJAJP Tiranë, treguesit e matur mbi kohëzgjatjen e shqyrtimit gjyqësor dhe dorëzimit të vendimit të arsyetuar dalin në këto perfundime (shih dhe grafikun 2 & 3) :

- *Viti 2022 shënoi treguesit më të përkeqësuar të kohëzgjatjes së shqyrtimit gjyqësor për çështjet e themelit në 8 vitet e fundit (2016-2022);*
- *Nga viti 2016 deri në vitin 2022, përkeqësimi i treguesve të kohëzgjatjes gjyqësore ka qenë konstant dhe në progresion domethënës sa i takon gjykimet të themelit në shkallë të dytë;*
- *Për **çështje civile themeli** koha mesatare për shqyrtimin u trefishua, kurse koha mesatare për arsyetim/dorëzim vendimi u katërfishua (4.3 herë);*
- *Për **çështje penale themeli** koha mesatare për shqyrtimin u dyfishua, kurse koha mesatare për arsyetim/dorëzimi vendimi u shtatëfishua (me 6.7 herë);*

²⁶ vetëm të dhënat e gjateshtëmujorit të parë: 1 Shkurt 2023-31Korrik 2023

Përveç treguesve të përkeqësuar ndjeshëm të kohëzgjatjes gjyqësore, rënie pësoi edhe pesha specifike që zunë çështjet e themelit në totalin e çështjeve të shqyrtuara. Në vitin 2016, GjA Tiranë arrinte të shqyrtonte dhe të merrte vendim për një total prej 4625 dosje gjyqësore themeli (2743 civile²⁷ dhe 1882 penale²⁸). Në 2017 dhe 2018 u morën respektivisht 4549 dhe 4359 vendime themeli (civile dhe penale). Në vitin 2019 u dhanë rreth 2400 vendime themeli. Ndërkohë, në vitin 2022, GjA Tiranë dha vetëm 1560 vendime themeli (238 civile dhe 1322 penale), pra rreth 3 herë më pak krahasuar me 2016-ën. Volumi i shqyrtimeve të çështjeve të themelit është reduktuar ndjeshëm, duke e bërë këtë kategori furnizuesen kryesore të *backlogut*.

Grafiku 3



Gjykata e Apelit Tiranë nisi vitin 2022 me 17647 dosje të mbartura në vitet pararendëse (11191 civile dhe 5656 penale). Ky stok përfaqësoi 63% të totalit të gjithë gjykatave të apelit gjatë vitit 2022²⁹. Gjatë 2022-it u regjistruan 5728 ankime të reja.

Mbartjet dhe prurjet e reja arritën së bashku një volum rekord prej 23375 dosje në vitin 2022. Prej këtij volumi, trupa gjyqësore efektive prej 10.9 gjyqtarësh arriti të evadonte 3317 vendime gjatë vitit 2022. Kjo do të thotë se në 1 Janar 2023, Gj. Apelit Tiranë mbarti në vitin e ri 20058 dosje gjyqësore. Rreth gjysma e këtij stoku përlogaritet të jenë çështje themeli, të cilat do të presin një radhë të papërcaktuar deri në datën e gjykimit. Vendimet në apel për masat e sigurisë vërtet përfaqësojnë një grupim realisht të madh, por trupa gjyqësore nuk ka diskrecion të mos i marrë në shqyrtim këto çështje. Ankimi kundër masave të sigurimit në apel duhet të shqyrtohet **brenda 10 ditëve** nga marrja në dorëzim e akteve (paragrafi 6, neni 249, KPrP), ndërkohë që vendimi i arsyetuar duhet të depozitohet **brenda 10 ditëve** (paragrafi 7, neni 249, KPrP). Kjo do të thotë se mungesa e trupës gjyqësore prek më së shumti vonesat në stokun e çështjeve të themelit (civile dhe penale) si në terma të kohëzgjatjes së tyre (barten që nga viti 2027-2028) ashtu edhe në sasinë e evakuuar gjatë një viti kalendarik, e cila ka pësuar rënie të ndjeshme (shih Graf. 3)

²⁷ link: <https://www.gjykataehapur.al/2016-civile/>

²⁸ link: <https://www.gjykataehapur.al/2016-penale/>

²⁹ burimi: Raporti vjetor 2022 i KLGJ, fq. 71


Kohëzgjatja pas Reformës së Rretheve Gjyqësore, Shkurt-Korrik 2023

Referuar **6-mujorit të parë 2023** (1 Shkurt-31 Korrik), treguesit e përpunuar nga INFOÇIP për GJAJP Tiranë, sugjerojnë se kohëzgjatja mesatare për shqyrtimin e çështjeve civile të themelit ka qenë 646 ditë, kurse për çështjet penale të themelit ka qenë 547 ditë. Të dhënat limitohen në 6-mujorin e parë (1-shkurt-31 korrik 2023)

GJAJP Tiranë, ku janë absorbuar edhe çështjet e mbartura nga (ish) Gjykata e Apelit Tiranë ka performuar më mirë në 2023 (1 Shkurt- 31 Korrik 2023) se sa kjo e fundit. Trendi përkeqësues është ndalur dhe ka një përmirësim domethënës në kohëzgjatjen mesatare të shqyrtimit gjyqësor të çështjeve të themelit (nga 1118 ditë në 646 ditë për civile themeli dhe nga 635 ditë ka zbritur në 547 për penale themeli).


Megjithatë, siç sugjerojnë të dhënat e *Graf. 4*, një palë ndërgjyqëse e zgjidhte ankimin për një çështje civile themeli në Gjykatën e Apelit Tiranë më shpejt në vitet 2016-2019 se sa në vitin 2023 (sot GJAJP Tiranë), ndërkohë që një çështje penale themeli zgjidhej më shpejt në periudhën 2016-2020, krahasuar me 2023-ishin.

Grafiku 4



Sa i takon kohës së arsyetimit të vendimit, të dhënat e përditësuar në muajin shtator 2023 nga INFOÇIP sugjerojnë se nga 1346 vendime penale themeli vetëm 791 prej tyre ishin dorëzuar të arsyetuara për periudhën Shkurt–Korrik 2023. Ndërkohë, nga 641 vendime të dhëna për çështje civile themeli në të njëjtën periudhë, vetëm 321 ishin dorëzuar deri në fund të shtatorit 2023. Duhet pritur fundi i vitit 2023 për të përcaktuar nëse trendi i vitit 2023 do të jetë përmirësues apo përkeqësues në raport me periudhën 2016-2022 (shih *Graf. 5*, për trendin 2016-2022).

Grafiku 5



Gjykimi brenda një afati të arsyeshëm, krahasimi 2016-2023

Sipas përcaktimeve në nenin 399/2, për gjykimin civil në shkallë të dytë afat i arsyeshëm konsiderohet përfundimi i procesit brenda dy viteve. Në gjykimin penal në apel gjykimin për krimet [duhet të mbyllet] në një afat kohor prej 1 viti dhe për kundërvajtjet penale brenda 6 muajsh.

Objekt vlerësimi në kuadër të këtij studimi janë vetëm çështjet e themelit (civile dhe penale), si kategoria më e madhe e vendimarrjes në Gjykatën e Apelit Tiranë. Këto çështje janë gjithashtu më të prekura nga fenomeni i vonesave, krahasuar me tipologjitë e tjera, siç sugjerojnë të dhënat e analizuara.

Sa i takon gjykimeve penale të themelit, INFOCIP nuk ka diferencuar krimet nga kundërvajtjet penale (edhe sepse as numratori vetë nuk i diferencon), duke përdorur si kontrast të vetëm ligjor për të dyja kategoritë afatin 1-vjeçar. Rrjedhimisht, çështjet penale jashtë afateve të arsyeshme të gjykimin mund të jenë më të shumta në realitet se sa shifra e referuar në këtë vlerësim.

Tabela 6

VITI	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023 ³⁰
CIVILE THEMELI	2753	2726	1749	999	394	246	238	641
TOTAL VENDIME								
JASHTË AFATIT	21	24	134	445	200	153	172	502
TE ARSYESHËM								
Ne %	0.76%	0.88%	7.4%	44.5%	50.7%	62%	72%	78.3

Tabela 7

VITI	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023 ³¹
PENALE THEMELI	1901	1836	2624	1397	515	735	1322	1346
TOTAL VENDIME								
JASHTË AFATIT	636	1115	1486	633	177	376	747	599
TE ARSYESHËM								
Ne %	33.4%	60.7%	56.6%	45.3%	34%	51%	56%	44.5%

Një shumicë e konsiderueshme prej 72% e totalit të gjykimeve civile të themelit dolën jashtë afatit të arsyeshëm të gjykimin në vitin 2022 në Gj. Apelit Tiranë (Tab.6). Para Reformës në Drejtësi, më pak se 1% e çështjeve civile të themelit në Gj. Apelit Tiranë dilyn jashtë afatit 2-vjeçar të gjykimin.

Në tre-vjeçarin 2020-2022, edhe gjykimet penale pësuan përkeqësim të dukshëm³². Numri më i lartë i gjykimeve penale jashtë afatit të arsyeshëm konstatohet në vitin 2017.

Nëse krahasohen treguesit e Gj. Apelit Tiranë me treguesit e GJAJT Tiranë në 6-mujorin e parë të punës (1-Shkurt-30 Korrik 2023), përkeqësimi ka vijuar të thellohet (me 6 pikë përqindje me keq krahasuar me 2022) sa i takon çështjeve civile të themelit të cilat kanë marrë vendim jashtë afatit të arsyeshëm, por ka shënuar përmirësim relative sa i takon çështjeve penale të themelit (tab. 7)

³⁰ Numratori i ri i GJAJT Tiranë për vendime themeli civile hapet me vendim nr.1, dt 6 Shkurt 23 dhe në kohen e marrjes së të dhënave nga INFOCIP mbyllet me vendimin nr. 641, dt 20 Korrik 2023.

³¹ Numratori i ri i GJAJT Tiranë për vendime penale themeli hapet me vendim nr.1, dt 1 Shkurt 23 dhe në kohen e marrjes së të dhënave nga INFOCIP mbyllet me vendimin nr. 1346, dt 31 Korrik 2023.

³² INFOCIP nuk ka diferencuar krimet nga kundërvajtjet penale, duke përdorur si kontrast të vetëm ligjor për të dyja kategoritë afatin 1-vjeçar. Rrjedhimisht, çështjet penale jashtë afateve të arsyeshme të gjykimin mund të jenë më shumë në realitet se sa shifra e referuar në këtë vlerësim.

MASAT E SIGURIMIT, vlerësimi i kohëzgjatjes 2020-2021-2022 & krahasimi me treguesit e 6-mujorit të parë 2023 të GJ.A.J.P Tiranë

Për herë të parë, INFOCIP ka vlerësuar afatet ligjore për shqyrtimin e masave të sigurimit në Gjykatën e Apelit Tiranë. Nga 1 Shkurti 2023, kjo është gjykata e vetme e apelit me juridiksion të përgjithshëm. Ankimi kundër masave të sigurimit në apel duhet të shqyrtohet **brenda 10 ditëve** nga marrja në dorëzim e akteve (paragrafi 6, neni 249, KPrP), ndërkohë që vendimi i arsyetuar duhet të depozitohet **brenda 10 ditëve** (paragrafi 7, neni 249, KPrP). Në vitin 2022, gjykimet për masat e sigurimit ishin kategorinë e dytë me numrin më të lartë të vendimeve, dhe kategoria e parë në vitet 2020 dhe 2021 në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Lloji / Tipologjia	Total Vendime viti 2022	Total Vendime viti 2021	Total Vendime viti 2020
Çështje Civile Themeli	238	246	394
Çështje Penale Themeli	1322	735	515
Masa Sigurimi	1149	1212	1138

Për vitin 2023, INFOCIP ka analizuar 1000 vendime për masa sigurimi të dhëna në periudhëm 1 Shkurt-4 Korrik, ku për herë të parë vihet re si treguesi i mesatares në shqyrtim ashtu dhe ai i mesatares në dorëzim dalin jashtë afatit ligjor. Nëse vendimet analizohen veç e veç, vihet re se një numër i konsiderueshëm janë dhënë në tejkalim të afatit ligjor (kolona 5 në Tabelën 6).

Tabela 6

Viti	Vendime masa sigurimi gjithsej	Mesatare e shqyrtimit (ditë)	Mesatare e dorëzimit (ditë)	Total vendime tej afatit ligjor 10-ditor të shqyrtimit	Total vendime tej afatit ligjor 10-ditor të dorëzimit
2020	1138	6.1	36.7	45 (3.9%)	811 (71.2%)
2021	1212	5	32	37 (3%)	958 (79%)
2022	1149	6.5	35.4	61 (5.3%)	875 (74.5%)
2023	1000	10.5	34.1	88 (8.97%)	755 (75.5%)

Me probleme domethënëse paraqiten afatet e arsyetimit /dorëzimit të vendimit. Treguesi i mesatarizuar, për vitet e marra në analizë është tejkaluar mbi 3 herë (kolona 4, Tabela. 6). Ndërkohë, shumica dërrmuese e vendimeve për masa sigurimi kanë dalë jashtë afatit ligjor 10 ditor të dorëzimit (kolona 6, Tab. 6). Kur vendimi nuk shpallet ose nuk zbatohet brenda afatit të caktuar, akti në bazë të të cilit është marrë masa shtrënguese e humbet fuqinë (paragrafi 8, neni 249, KPrP). Mbetet e paqartë se si do duhet të trajtohet kjo problematikë e hasur në GJ. Apelit Tiranë³³. Tabelat verifikuese për vendimet e masave të sigurimit mund të hulumtohen në Platformën www.gjykataehapur.al, në linket më poshtë:

2023: <https://www.gjykataehapur.al/masa-sigurimi-viti-2023-gjykata-e-apelit-i-p-tirane-me-kontrast-10-ditor-6-mujori-pare/>

2022: <https://www.gjykataehapur.al/masa-sigurimi-viti-2022-gjykata-e-apelit-tirane-me-kontrast-10-ditor/>

2021: <https://www.gjykataehapur.al/masa-sigurimi-viti-2021-gjykata-e-apelit-tirane-me-kontrast-ligjor-k-p-p/>

2020: <https://www.gjykataehapur.al/masa-sigurimi-viti-2020-gjykata-e-apelit-tirane/>

³³ Gjykata Kushtetuese ka theksuar domosdoshmerine e arsyetimit të vendimeve gjyqesore, penale apo civile, si një garanci për procesin ligjor. Mungesa e pjesës së arsyetuar të vendimit cënon integritetin dhe ligjshmerine e vetë procesit/vendimit gjyqësor. Po ashtu, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin nr. 5, date 12.12.2013, kanë elaboruar rrethanat në të cilat vonesat në arsyetimin e vendimit gjyqësor passjellin përgjegjesi disiplinore për gjyqtarin.

URDHRAT E MBROJTJES, vlerësimi i kohëzgjatjes 2020-2021-2022 & krahasimi me treguesit e 6-mujorit të parë 2023 të GJ.A.J.P Tiranë

Ligji nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, parashikon në nenin 21 të tij se Gjykata e Apelit shprehet me vendim brenda 15 ditëve nga dita e regjistrimit të ankimit ndaj urdhrit të mbrojtjes.

INFOÇIP ka analizuar për herë të parë kohëzgjatjen e kësaj kategorie çështjes në gjykatat e apelit për periudhën 2020-2022. Të dhënat e analizuar shërbejnë si baseline krahasimi me të dhënat që do të fillojnë të grumbullohen nga GJAJ.P Tiranë, me synim vlerësimin e treguesve në kuadër të Reformës së Rretheve gjyqësore.

Tabela 7

Viti	Vendime apel U. Mbrojtje gjithsej	Mesatare (dite) shqyrtimi U.Mbrojtje	Mesatare dorëzimi (ditë) U. Mbrojtje	Total vendime tej afatit 15-ditor të shqyrtimit
2020	65	73	20	42 (64.6%)
2021	88	62	47	80 (90.9%)
2022	119	57	50	100 (84%)
2023	113	31.7	51 ³⁴	70 (61.9%)

Pavarësisht numrit relativisht të vogël të vendimeve në Gjykatës së Apelit Tiranë për urdhrat e mbrojtjes, vihet re shumica dërrmuese e tyre shqyrtohen tej afatit ligjor 15 ditor. Përkeqësim domethënës konstatohet në vitin 2021, ku mbi 90% e totalit të vendimeve për apelim Urdhër Mbrojtje u morën tej afatit ligjor (kolona 5 në tabelë). Viti 2022, por edhe 6 mujori i parë 2023 kanë shënuar gjithsesi përmirësim sa i takon vendimeve që merren tej afatit ligjor. Sa i takon mesatares vjetore (kolona 3 në tabelë), ajo është në cdo rast katër herë më e lartë se afati ligjor i përcaktuar.

Shumica dërrmuese e vendimeve për urdhrat e mbrojtjes në GJ. Apelit Tiranë janë shqyrtuar tej afatit ligjor. Treguesit më problematikë hasen në vitin 2021 pasuar nga vitit 2022, respektivisht me 90% dhe 84% të gjithë vendimeve jashtë afatit ligjor.

Tabelat verifikuese me të dhënat gjyqësore për vendimet e GJ. Apelit Tiranë për ankimet ndaj urdhrave të mbrojtjes mund të hulumtohen në Platformën www.gjykataehapur.al sipas viteve, në linket më poshtë:

Viti	Link ne www.gjykataehapur.al
2023	https://www.gjykataehapur.al/urdher-mbrojtje-gjykata-e-apelit-te-juridiksionit-te-pergjithshem-tirane-viti-2023-6-mujori-i-pare-shqyrtimi-dorezimi-respektimi-i-afatit-ligjor/
2022	https://www.gjykataehapur.al/vendim-urdher-mbrojtje-gjykata-e-apelit-tirane-viti-2022-shqyrtimi-dorezimi/
2021	https://www.gjykataehapur.al/vendim-urdher-mbrojtje-gjykata-e-apelit-tirane-viti-2021-shqyrtimi-dorezimi/
2020	https://www.gjykataehapur.al/urdher-mbrojtje-gjykata-e-apelit-tirane-viti-2020-shqyrtimi-dorezimi/

³⁴ Mesatarja i referohet vetëm 75 vendimeve nga 113 gjithsej; per 38 vendime ende nuk ishte pasqyruar në numerator data e dorëzimit të tyre në sekretarinë e gjykatës deri në fund të muajit gusht kur janë grumbulluar këto të dhëna nga INFOÇIP.

GJETJET E VLERESIMIT TEMATIK VITI 2020-2023

GJYKATA E APELIT DURRES

NGARKESA SIPAS LLOJIT TE ÇESHTJEVE DHE TRUPA GJYQESORE

Referuar numratorëve të saj, Gjykata e Apelit Durrës dha 2017 vendime gjatë vitin 2022; 2426 vendime në vitin 2021 dhe 1622 vendime në 2020-ën. *Tabela nr.1* paraqet treguesit e volumit vendimarrës të GjA Durrës për 3-vjeçarin 2020-2022.


Tabela 1

Lloji / Tipologjia	Total Vendime viti 2022	Total Vendime viti 2021	Total Vendime viti 2020
Çështje Civile Themeli	459	623	387
Çështje Penale Themeli	321	372	176
Masa Sigurimi	458	416	458
Civile të Veçanta	384	608	288
Penale të Veçanta	395	407	313
TOTAL VJETOR	2017	2426	1622
Nr. efektiv gjyqtarësh¹	4.5	5.3	5.3
Mes. Vendime/Gjyqtar	488.2	457.7	253.4

Gjykata e Apelit Durrës funksionoi gjatë vitit 2022 me 4.5 gjyqtarë të efektivë, nga 13 të dekretuar. Në tabelën 1, në dy rrjeshtat e fundit jepen të dhënat për numrin efektiv të gjyqtarëve dhe mesataren vendimarrëse të tyre për periudhën 2020-2022.

Çështjet civile të themelit dhe masat e sigurimit përfaqësojnë numrin më të madh shqyrtimeve, në të treja vitet e marra në analizë. Nëse grupohen penale dhe civile themeli së bashku, ato përbëjnë kategorinë me numrin më të madh të gjykimeve të përfunduara në periudhën 2020-2022. Në *grafikun 1* vihet re se, pavarësisht ngarkesës së gjyimit apo trupës gjyqësore, raportet mes kategorive të gjyimit tentojnë të jenë të pandryshuara, me përjashtim të vitit 2021 ku një shtim të vendimeve të dhëna për kategorinë “Civile të veçanta”.


Graf. 1



¹ sipas raportimit zyrtar të KLGJ në raportet vjetore 2020 dhe 2022.


Dhoma Penale përballoi ngarkesën më të lartë (masa sigurimi, çështe penale themeli dhe penale të veçanta) gjatë vitit 2022 dhe 2020.

Grafiku 2 (përmbi djathtas) paraqet në përqindje ndarjen e ngarkesës për dy dhomat e kësaj gjykate për periudhën tre vjeçare 2020-2022.




Për të krijuar një vizualizim të raportit sipas tipologjise se vendimeve, *grafiku 3* paraqet situatën për vitin 2022, ndërkohë që grafikët respektivë të çdo viti mund të hulumtohen në Platformën www.gjykataehapur.al. Në *grafikun 3* shpërndarja sipas tipologjisë gjatë 2022-it paraqitet në përqindje, ndërkohë tek legjenda (*djathtas*) jepet dhe numri për çdo tipologji/kategori vendimesh.

Grafiku 3



Grafiku 4



Trupa gjyqësore e Gj. Apelit Durrës e rriti progresivisht ngarkesën mesatare për gjyqtar në periudhën 2020-2022. Grafiku përmbi ilustron këtë rritje e cila përllogaritet për vitin 2020 me 253.4 vendime mesatarisht për çdo gjyqtar efektiv (5.3) për të arritur në 482.2 mesatarisht për gjyqtar në vitin 2022, kur efektivisht kishte më pak gjyqtarë (4.5).

KOHËZGJATJA GJYQËSORE & ARSYETIM/DORËZIMI I VENDIMIT

INFOÇIP ka analizuar kohëzgjatjen gjyqësore për katër tipologji të rëndësishme vendimesh: Çështje Civile Themeli, Çështje Penale Themeli, Masa Sigurimi dhe Urdhëra Mbrojtje. Këto të fundit nuk mbahen në një regjistër të veçantë nga Gjykata e Apelit Durrës dhe janë përpunuar duke u nxjerrë nga Numratori “Civile të Veçanta”. Periudha e matur dhe e analizuar përfshin 3 fasha kohore:

- 3-vjeçarin 2020-2022
- 6-mujorin e parë të funksionimit të GJAJP Tiranë.
- Krahësim i të dhënave të periudhës 2016-2019 me të dhënat e reja të periudhës 2020-2022 dhe 6-mujorit të parë 2023, për identifikimin e trendit të vonësive gjyqësore para në interval të pandërprerë 7-vjeçar.

ÇËSHTJE THEMELI, CIVILE DHE PENALE, 2020-2022

Të dhënat e analizuar nga INFOÇIP përmes Platformës së automatizuar www.gjykataehapur.al sugjerojnë se treguesit e shqyrtimit gjyqësor u përkeqësuan në mënyrë domethënëse nga viti 2020 e deri në fund të vitit 2022. Në 1 Shkurt 2023, kjo gjykatë u shkri bashkë me 5 gjykata të tjera apeli në GJAJP Tiranë.

Tabela 2 paraqet totalin e çështjeve të themelit, civile dhe penale, që ka mundur të shqyrtojë dhe të përmbyle me vendim Gj. Apelit Durrës, në periudhën 2020-2022.

Tabela 3 ofron të dhënat për periudhën 2020-2022 mbi kohëzgjatjes mesatare në shqyrtim për çështjet e themelit, Penale dhe Civile, për Gjykatën e Apelit Durrës.

Tabela 2

Lloji / Tipologjia	Total Vendime viti 2022	Total Vendime viti 2021	Total Vendime viti 2020
Civile Themeli	459	623	387
Penale Themeli	321	372	176
Total Themele	777	950	563

Tabela 3

GJA Durrës	Mesatare shqyrtim (dite), viti 2022	Mesatare shqyrtim (dite), viti 2021	Mesatare shqyrtim (dite), viti 2020
Civile Themeli	676.7	603.8	419.8
Penale themeli	301.3	376	318.5

SHENIM: Gjykata e Apelit Durrës nuk ka të reflektuar në numratorët përkatës datat e dorëzimit të vendimit të arsyetuar. Këto të dhëna mbahen në regjistra të veçantë, të administruar nga sekretaret e gjyqtarëve.

Konkluzione të përmbledhura për periudhën 2020-2023:

Koha mesatare e pritjes së palëve ndërgjyqëse që Gjykata e Apelit Durrës të përfundonte shqyrtimin e një ankimi për **çështje civile themeli** u përkeqësua ndjeshëm në vitin 2022 me 257 ditë më shumë krahasuar me vitin 2020 (nga 419.9 ditë në 676.7 ditë). Për **çështje penale themeli**, për të njëjtën periudhë vlerësimi, kohëzgjatja u përmirësua (reduktua) me 17 ditë (nga 318.5 në 301.3 ditë).

Analiza krahasuese Para dhe Pas Reformës në Drejtësi

Vlerësimi tematik i kohëzgjatjes gjyqësore për çështjet e themelit në Gjykatën e Apelit Durrës realizohet nga INFOÇIP që prej vitin 2016, që shërbën edhe si *baseline* për efekt të këtij studimi. Ky vit përkon me fillimin e Reformës në Drejtësi.

Masat e sigurisë përfaqësojnë grupin më të madhe të vendimeve në Gjykatën e Apelit Durrës. Vendimet për çështje civile themeli vijnë të dytat, pasuar nga vendimet për çështje penale themeli. Nëse themelet grupohen si kategori e përbashkët (civile dhe penale), në vitin 2022 ato përfaqësonin 39% të totalit vendimarrës. Në vitin 2021 dhe 2020 ato zunë respektivisht 41% dhe 36% të totalit.

Tabela 4 paraqet kohën mesatare të shqyrtimit gjyqësor të vendimeve të themelit në Gjykatën e Apelit Durrës për periudhën 2016-2022².

Tabela 4

Viti	Civile themeli mesatare shqyrtim (dite)	Penale themeli mesatare shqyrtim (dite)	Civile themeli mes. dorëzim (dite)	Penale themeli mes.dorëzim (dite)
2016	361	310	12.4	10.3
2017	285	300	12.5	9
2018	267	253	11.5	9.8
2019	342	270	16.5	12.1
2020	420	319	-	-
2021	603	376	-	-
2022	677	301	-	-
2023 ³	646	547	-	-

Nga fillimi i Reformës në Drejtësi (2016) e deri në fund të vitit 2022, treguesit e matur mbi kohëzgjatjen e shqyrtimit gjyqësor, **dalën në këto perfundime:**

- *Viti 2022 shënoi treguesit më të përkeqësuar të kohëzgjatjes së shqyrtimit gjyqësor për çështjet e themelit në 8 vitet e fundit (2016-2022).*
- *Për çështje civile themeli koha mesatare për shqyrtimin u rrit thuajse dyfish (1.9 herë); Nga 361 ditë mesatarisht në 2016-ën, kjo kohë arriti në mesatarisht 677 ditë në 2022-in.*
- *Për çështje penale themeli, koha mesatare për shqyrtimin u ul me 9 ditë krahasuar viti 2016 me vitin 2022. Treguesit më problematikë për periudhën 2016-2022 janë regjistruar në vitin 2021, me një vonesë mesatare 376 ditë.*

Rënie pësoi edhe pesha specifike që zunë çështjet e themelit në totalin e çështjeve të shqyrtuara. Në vitin 2016, Gj. Apelit Durrës arrinte të shqyrtonte dhe të merrte vendim për një total prej 2147 dosje themeli (1167 civile⁴ dhe 980 penale⁵). Në 2017 dhe 2018 u morën respektivisht 2073 dhe 1337 vendime themeli (civile dhe penale); në 2022 GJA Durrës dha vetëm 777 vendime themeli (459 civile dhe 321 penale), ose rreth tre herë më pak (2.8) krahasuar me 2016-ën.

² Për të njëjtën periudhë nuk ishte e mundur të realizohej përpunim të dhënash sa i takon kohës së dorëzimit të vendimeve, për shkak të mbajtjes së datave jashtë numratorit përkatës

³ vetëm të dhënat e gjateshtëmujorit të parë: 1 Shkurt 2023-31Korrik 2023

⁴ <https://www.gjykataehapur.al/gjykata-e-apelit-durres-viti-2016-kohezgjitja-e-shqyrtimit-gjyqesor-ceshtje-civile-themeli/>

⁵ link: <https://www.gjykataehapur.al/vleresimi-i-kohezgjitjes-gjyqesore-ceshtje-penale-gjykata-e-apelit-durres-2016/>

Gjykimi brenda një afati të arsyeshëm, krahasimi 2016-2022

Sipas përcaktimeve në nenin 399/2, për gjykimin civil në apel afat i arsyeshëm konsiderohet përfundimi i procesit brenda dy viteve, kurse gjykimi për krimet në apel duhet të mbyllet në një afat prej 1 viti dhe për kundërvajtjet brenda 6 muajsh.

Objekt vlerësimi në kuadër të këtij studimi janë vetëm çështjet e themelit (civile dhe penale), si kategoria me numrin më të madh të vendimeve në Gjykatën e Apelit Durrës. Këto çështje rezultojnë dukshëm më të prekura nga fenomeni i vonesave, krahasuar me tipologjitë e tjera, sikurse sugjerojnë të dhënat e analizuar.

Tabela 5

VITI	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
CIVILE THEMELI	1167	1194	856	762	387	623	459
TOTAL VENDIME							
JASHTË AFATIT	16	10	3	22	59	288	212
TE ARSYESHËM							
Ne %	1.37%	0.83%	0.35%	2.88%	15.2%	46%	46%

VITI	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
PENALE THEMELI	979	912	521	399	176	372	321
TOTAL VENDIME							
JASHTË AFATIT	394	310	109	98	72	172	91
TE ARSYESHËM							
Ne %	40.2%	33.9%	20.9%	24.5%	40.9%	46%	28%

- Nga vlerësimi rezultoi se 46% e gjykimeve civile të themelit dolën jashtë afatit të arsyeshëm në vitin 2022 në Gj. Apelit Durrës (Tab.5).
- Në vitin 2016, para Reformës në Drejtësi, vetëm 1.37% e çështjeve civile të themelit në Gj. Apelit Durrës dilnin jashtë fashës kohore 2-vjeçare.
- Në periudhën 2016-2022, treguesi ka ardhur në përkeqësim të vazhdueshëm, sa i takon çështjeve civile të themelit.

Sa i takon gjykimeve penale të themelit, INFOCIP nuk ka diferencuar krimet nga kundërvajtjet penale, duke përdorur si kontrast të vetëm ligjor për të dyja kategoritë afatin 1-vjeçar. Rrjedhimisht, çështjet penale jashtë afateve të arsyeshme të gjykimit mund të jenë më shumë në realitet se sa shifra e referuar në këtë vlerësim.

Në 2022-in numri i gjykimeve penale për çështje themeli që u mbyllën tej afatit të arsyeshëm shkoi në 28%. Në vitin 2021, shifra e analizuar ishte 46%, duke e bërë këtë vitin më problematik në harkun kohor 2016-2022 për Gj. Apelit Durrës.

Volumi Vendimarrës


Në vitin 2022, Dhoma Penale e GJ. Apelit Durrës gjykoi thuhetse tre herë më pak çështje themeli krahasuar me vitin 2016. Po ashtu, Dhoma Civile mbylli me vendim 2.5 herë më pak çështje themeli krahasuar me vitin 2016.

Kohëzgjatja pas Reformës së Rretheve Gjyqësore

Gjykata e Apelit Durrës funksionoi si e tillë deri në 31 Janar 2023. Në 1 Shkurt 2023 ajo u shkri në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (GJAJP). Referuar 6-mujorit të parë (1 Shkurt-31 Korrik, '23), treguesit e përpunuar nga INFOÇIP, sugjerojnë se kohëzgjatja mesatare për shqyrtimin e çështjeve civile të themelit në GJAJP Tiranë ka qenë 646 ditë; për penale të themelit ka qenë 547 ditë⁶.

Grafiku 5 paraqet në një interval kohor 8-vjeçar kohëzgjatjen e shqyrtimit gjyqësor të çështjeve të themelit, ku mund të krahasohen treguesit e Gj. Apelit Durrës 2016-2022 me 6-mujorin e parë 2023, ku ajo është e shkrirë në GJAJP Tiranë.

Grafiku 5



Pas Reformës së Rretheve Gjyqësore, vihet re një përmirësim sa i takon kohëzgjatjes mesatare të shqyrtimit të çështjeve civile të themelit krahasuar me vitin 2022, por një përkeqësim të ndjeshëm me 246 ditë të kohës mesatare për shqyrtimin e çështjeve penale të themelit.

Viti 2022 nisi me 2902 çështje të mbatura nga 2021 për Gj. Apelit Durrës. Gjatë vitit 2022 u regjistruan 2060 ankime të reja⁷. Gj. Apelit Durrës mundi të merrte vetëm 1826 vendime gjatë vitit 2022. Mbartjet për vitin 2023 u përlogatitën në 3136, të gjitha këto të sjella këto GJAJP Tiranë në momentin e shkrirjes së gjykatave.

Një trupë prej 4.5 gjyqtarësh efektive, me një mesatare prej 488 çështjes të shqyrtuara në vit për gjyqtar, do ta evakonte këtë stok për 1.4 vjet (pa llogaritur prurjet e reja). Ndërkohë, në mes të Tetorit 2023, backlog-u në GJAJP Tiranë kaloi 37 mijë dosje Nëse një trupë prej vetëm 21 gjyqtarësh do të punonte për të evaduar këtë stok, me një mesatare prej 300 vendimesh në vit për gjyqtar, do të nevojiteshin 5.8 vite; me një mesatare prej 488 çështjes në vit koha e evadimit do të ishte 3.6 vjet.

Në të dyja rastet, koha e pritjes për palët ndërgjyqëse për të futur në shqyrtim gjyqësor një ankim në ish-Apelin Durrës ka qenë më e ulët para Reformës së Rretheve Gjyqësore, krahasuar me pritjen sot në GJAJP.

⁶ Sa i takon arsytimit të vendimeve, një pjesë e konsiderueshme nuk ishin dorëzuar në sekretarinë gjyqësore deri në Shtator 2023.

⁷ referuar Raportit Vjetor për vitin 2022 të KLGJ, fq. 71-72

MASAT E SIGURIMIT, vlerësimi i kohëzgjatjes 2020-2021-2022 & krahasimi me treguesit e 6-mujorit të parë 2023 të GJ.A.J.P Tiranë

Masat e sigurimit përfaqësojnë kategorinë e dytë me numrin më të lartë të vendimeve në Gjykatën e Apelit Durrës gjatë 3-vjeçarit 2020-2023. Ato renditen pas gjykimeve për çështje civile themeli në terma të volumit (*shih tab. 1*).

Ankimi kundër masave të sigurimit në apel duhet të shqyrtohet **brenda 10 ditëve** nga marrja në dorëzim e akteve (paragrafi 6, neni 249, KPrP), ndërkohë që vendimi i arsyetuar duhet të depozitohet **brenda 10 ditëve** (paragrafi 7, neni 249, KPrP).

Nga të dhënat e analizuara nga INFOÇIP rezulton se **kohëzgjatja mesatare** për shqyrtimin e ankimeve në apel ndaj masave të sigurimit nuk e kapërceu afatin ligjor 10-ditor në Gj. Apelit Durrës. Megjithatë, nëse vendimet analizohen veç e veç, vihet re se një numër i konsiderueshëm vendimesh të këtij lloji janë dhënë në tejkalim të afatit ligjor (*kolona 5 në Tabelën 6*).

Për shkak të sistemit të brendshëm të administimit të dhënave gjyqësore, datat e dorëzimit të vendimeve të arsyetuara nuk reflektohen në numbatorin përkatës. Ato regjistrohen në numratorët që mbahen nga sekretaret e gjyqtarëve. Për Gjykatën e Apelit Durrës, këto të dhëna nuk janë disponuar nga INFOÇIP për shkak të vështirësisë në përpunimin e tyre.

Tabela 6

Viti	Vendime masa sigurimi gjithsej	Mesatare e shqyrtimit (ditë)	Mesatare e dorëzimit (ditë)	Total vendime tej afatit ligjor 10-ditor të shqyrtimit	Total vendime tej afatit ligjor 10-ditor të dorëzimit
2020	458	9.5	-	63 (13.7%)	-
2021	416	8.3	-	45 (10.8%)	-
2022	458	6	-	25 (5.4%)	-
2023	1000	10.5	34.1	88 (8.97)	755 (75.5%)

INFOCIP analizoi 1000 vendime për masa sigurimi të dhëna në periudhëm 1 Shkurt-4 Korrik nga GJAJP Tiranë, në të cilën u shkri Gjykata e Apelit Durrës. **Treguesi i mesatares së shqyrtimit është më i përkeqësuar në GJAJP Tiranë se sa në ish-Gjykatën e Apelit Durrës në periudhën 2020-2021-2022.** Mungon gjithsesi baza krahasuese për treguesin e dorëzimit të vendimeve brenda afatit ligjor 10-ditor.

Tabelat verifikuese me të dhënat gjyqësore për ankimet ndaj masave të sigurimit mund të hulumtohen në Platformën www.gjykataehapur.al sipas viteve, në linket më poshtë:

2023: <https://www.gjykataehapur.al/masa-sigurimi-viti-2023-gjykata-e-apelit-j-p-tirane-me-kontrast-10-ditor-6-mujori-pare/>

2022: <https://www.gjykataehapur.al/masa-sigurimi-viti-2022-gjykata-e-apelit-durres-2/>

2021: <https://www.gjykataehapur.al/masa-sigurimi-viti-2021-gjykata-durres/>

2020: <https://www.gjykataehapur.al/masa-sigurimi-viti-2020-gjykata-e-apelit-durres/>

URDHRAT E MBROJTJES, vlerësimi i kohëzgjatjes 2020-2021-2022 & krahasimi me treguesit e 6-mujorit të parë 2023 të GJ.A.J.P Tiranë

INFOÇIP analizoi për herë të parë kohëzgjatjen e shqyrtimit të urdhrave të mbrojtjes në Gj. Apelit Durrës për periudhën 2020-2022. Të dhënat e analizuara shërbejnë si *baseline* krahasimi me të dhënat e mbledhura në GJAJP Tiranë (6-mujori i parë 2023), me synim vlerësimin e trendit në kuadër të Reformës së Rretheve Gjyqësore.

Ligji nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, parashikon në nenin 21 të tij se Gjykata e Apelit shprehet me vendim brenda 15 ditëve nga dita e regjistrimit të ankimit ndaj urdhrit të mbrojtjes.

Pavarësisht numrit relativisht të vogël të vendimeve në GJA Durrës për urdhrat e mbrojtjes, vihet re një pjesë e tyre janë shqyrtuar tej afatit ligjor 15 ditor. Krahasuar me 6-mujorin e parë të vitit 2023, treguesit kanë vijuar të përkeqësohen. INFOCIP analizoi 113 vendime për masa sigurimi të dhëna gjithësej në periudhën 1 Shkurt-4 Korrik nga GJAJP Tiranë, në të cilën u shkri Gjykata e Apelit Durrës. Treguesi i mesatares në shqyrtim ka pësuar rritje, po ashtu edhe totali i vendimeve të shqyrtuara në tejkalim të afatit ligjor.

Viti	Vendime apel U. Mbrojtje gjithsej	Mesatare (dite) shqyrtimi U.Mbrojtje	Mesatare dorëzimi (ditë) U. Mbrojtje	Total vendime tej afatit 15-ditor të shqyrtimit
2020	-	-	-	-
2021	25	35	-	9 (36%)
2022	15	13	-	3 (20%)
2023	113	31.7	51 ⁸	70 (61.9%)

Gjykata e Apelit Durrës nuk i ka mbajtur të dhënat për urdhrat e mbrojtjes në një regjistër të posaçëm. Ato grupohen në regjistrin (numratorin) ku janë të administruara rekordet gjyqësore për Civile të Veçanta. Gabimi metodologjik nga evidentimin e këtyre lloj vendimesh nga ky numrator është i përlogaritur në masën 5% (mundësi gabimi njërëzor në vlerësimin e objekt-padisë). Për shkak të sistemit të brendshëm të administrimit të të dhënave gjyqësore, datat e dorëzimit të vendimeve të arsyetuara nuk reflektohen në numbatorin përkatës. Ato regjistrohen në regjistra që mbahen nga sekretaret e gjyqtarëve. Për Gjykatën e Apelit Durrës, këto të dhëna nuk janë disponuar nga INFOÇIP për shkak të vështirësisë në përpunimin e tyre.

Tabelat verifikuese me të dhënat gjyqësore për vendimet e GJ. Apelit Durrës për ankimet ndaj urdhrave të mbrojtjes mund të hulumtohen në Platformën www.gjykataehapur.al sipas viteve, në linket me poshtë:

Viti	Link verifikues në www.gjykataehapur.al
2023	https://www.gjykataehapur.al/urdher-mbrojtje-gjykata-e-apelit-te-juridiksionit-te-pergjithshem-tirane-viti-2023-6-mujori-i-pare-shqyrtimi-dorezimi-respektimi-i-afatit-ligjor/
2022	https://www.gjykataehapur.al/urdher-mbrojtje-gjykata-e-apelit-durres-viti-2022-2/
2021	https://www.gjykataehapur.al/urdher-mbrojtje-gjykata-e-apelit-durres-viti-2021/

⁸ Mesatarja i referohet vetëm 75 vendimeve nga 113 gjithsej; për 38 vendime ende nuk ishte pasqyruar në numrator data e dorëzimit të tyre në sekretarinë e gjykatës deri në fund të muajit gusht kur janë grubulluar këto të dhëna nga INFOÇIP.

GJETJET E VLERESIMIT TEMATIK VITI 2020-2023

GJYKATA E APELIT SHKODER

NGARKESA SIPAS LLOJIT TE ÇESHTJEVE DHE TRUPA GJYQESORE

Referuar numratorëve të saj, Gjykata e Apelit Shkodër dha 1826 vendime gjatë vitit 2022; 1938 vendime në 2021-in dhe 1394 vendime në 2020-ën. *Tabela nr.1* paraqet treguesit e volumit vendimarrës të Gj. Apelit Shkodër për 3-vjeçarin 2020-2022.


Tabela 1

Lloji / Tipologjia	Total Vendime viti 2022	Total Vendime viti 2021	Total Vendime viti 2020
Çështje Civile Themeli	516	487	329
Çështje Penale Themeli	285	259	198
Masa Sigurimi	320	389	272
Numrator shkalle e parë	286	248	178
Administrative Civile	149	263	157
Administrative Penale	270	292	260
TOTAL VJETOR	1826	1938	1394
Nr. efektiv gjyqtarësh¹	5	4.8	5.5
Mes. Vendime/Gjyqtar	365.2	403.7	253.4

Gjykata e Apelit Shkodër funksionoi gjatë vitit 2022 me gjysmën e kapacitetit të saj, konkretisht me 5 gjyqtarë të efektivë, nga 10 të dekretuar. Në *tabelën 1*, në dy rrjeshtat e fundit jepen të dhënat për numrin efektiv të gjyqtarëve dhe mesataren vendimarrëse të tyre për periudhën 2020-2022.

Çështjet civile të themelit përfaqësojnë numrin më të madh shqyrtimeve, në të treja vitet e marra në analizë, ndjekur nga masat e sigurimit dhe nga çështje penale themeli. Në *grafikun 1* vihet re se, pavarësisht ngarkesës së gjykimit apo trupës gjyqësore, raportet mes kategorive të gjykimit tentojnë të jenë të pandryshuara, ku Dhoma Penale përballoi ngarkesën më të lartë (masa sigurimi dhe çështje penale themeli)


Graf. 1



¹ sipas raportimit zyrtar të KLGJ në raportet vjetore 2020 dhe 2022.

Për të krijuar një vizualizim të raportit të shpërndarjes së ngarkesës, *grafiku 1* paraqet situatën për vitin 2022, ndërkohë që grafikët respektivë të çdo viti mund të hulumtohen në Platformën www.gjykataehapur.al. Në *grafikun 2* ngarkesa e vitit 2022 paraqitet sipas përqindjes, ndërkohë tek legjenda (*djathtas*) jepet dhe numri për çdo tipologji/kategori vendimesh.

Grafiku 2



KOHËZGJATJA GJYQËSORE & ARSYETIM/DOREZIMI I VENDIMIT

INFOÇIP ka analizuar kohëzgjatjen gjyqësore për katër tipologji të rëndësishme vendimesh: Çështje Civile Themeli, Çështje Penale Themeli, Masa Sigurimi dhe Urdhra Mbrojtje. Këto të fundit nuk mbahen në një regjistër të veçantë nga Gjykata e Apelit Shkoder dhe janë përpunuar duke u nxjerrë nga Numratori “Administrative Civile”. Periudha e matur dhe e analizuar përfshin 3 fasha kohore:

- *3-vjeçarin 2020-2022-kjo periudhë ndërlidh me të dhëna të krahasueshme periudhën 2016-2019 të cilën INFOCIP e ka analizuar në raportet pararendëse sa i takon treguesve të kohëzgjatjes gjyqësore, kryesisht për çështjet e themelit në shkallë të dytë të gjykimit. Fundi i periudhës 2020-2022 përkon me shkrirjen e 6 gjykatave të apelit në një gjykatë të vetme, të vendosur në Shkodër², e cila nisi nga puna në 1 Shkurt 2023.*
- *6-mujorin e parë të funksionimit të GJAJP Tiranë. Kjo periudhë fillin nga data 1 Shkurt 2023 deri në datën 31 Korrik 2023 duke krijuar bazë krahasimi për treguesit e kohëzgjatjes gjyqësore pas Reformës së Rretheve Gjyqësore.*
- *Krahasim i të dhënave të periudhës 2016-2019 me të dhënat e reja të periudhës 2020-2022 dhe 6-mujori i parë 2023, për identifikimin e trendit të vonesave gjyqësore para dhe pas Reformës në Drejtësi në interval të pandërprerë 7-vjeçar.*

² Kjo gjykatë do të referohet më poshtë me akronimin GJAJP Tiranë.

ÇËSHITJE THEMELI, CIVILE DHE PENALE, 2020-2023

Të dhënat e analizuara nga INFOÇIP përmes Platformës së automatizuar www.gjykataehapur.al sugjerojnë se treguesit e shqyrtimit gjyqësor u përkeqësuan në mënyrë domethënëse nga viti 2020 e deri në fund të vitit 2022 (në 1 Shkurt 2023, kjo gjykatë u shkri bashkë me 5 gjykata të tjera apeli në GJAJP Tiranë).

Tabela 2 paraqet totalin e çështjeve të themelit, civile dhe penale, që ka mundur të shqyrtojë dhe të përmbylle me vendim Gj. Apelit Shkodër, në periudhën 2020-2022.

Tabela 3 ofron të dhënat për periudhën 2020-2022 mbi kohëzgjatjen mesatare në shqyrtim për çështjet e themelit, Penale dhe Civile, për Gjykatën e Apelit Shkodër.

Tabela 4 ofron të dhënat e tre-vjeçarit për këtë gjykatë sa i takon kohës së arsyetimit/ dorëzimit të vendimeve për çështjet e themelit, civile dhe penale.

Tabela 2

Lloji / Tipologjia	Total Vendime viti 2022	Total Vendime viti 2021	Total Vendime viti 2020
Civile Themeli	516	487	329
Penale Themeli	285	259	198
Total Themele	801	746	527

Tabela 3

GJA Shkodër	Mesatare shqyrtim (dite), viti 2022	Mesatare shqyrtim (dite), viti 2021	Mesatare shqyrtim (dite), viti 2020
Civile Themeli	603.2	563.5	448.2
Penale themeli	343.3	428.1	413

Tabela 4

GJA Shkodër	Mesatare dorëzim (dite) 2022	Mesatare dorëzim (dite) 2021	Mesatare dorëzim (dite) 2020
Civile Themeli	120.6	82.3	37.6
Penale themeli	86.1	66.9	38.5

Konkluzione të përmbledhura për periudhën 2020-2022

Koha mesatare e pritjes së palëve ndërgjyqëse që Gjykata e Apelit Shkodër të përfundonte shqyrtimin e një ankimi për **çështje civile themeli** u përkeqësua sistematikisht. Në vitin 2022 pritja u rrit me 105 ditë më shumë se në viti 2020 (nga 448.2 ditë në 603 ditë). Për **çështje penale themeli**, për të njëjtën periudhë vlerësimi, kohëzgjatja u përmirësua (reduktua) me 70 ditë (nga 413 në 343 ditë).

Koha e arsyetimit të vendimit pësoi përkeqësim të ndjeshëm në **çështje civile themeli themeli**, dorëzimi i të cilave mori thuajse katërfish më shumë kohë nga viti 2020 në 2022 (nga 37.6 ditë në 120.6 ditë). Arsyetimi i vendimeve në **çështje penale themeli** gjithashtu u përkeqësua mbi dyfish, (nga 38.5 ditë në 86.1 ditë).

Analiza krahasuese 2016-2022 (vetëm gjykime themeli)

Vlerësimi tematik i kohëzgjatjes gjyqësore për çështjet e themelit në Gjykatën e Apelit Shkodër realizohet nga INFOÇIP që prej vitin 2016 që shërbën si *baseline* për efekt të këtij studimi. Ky vit përkon edhe me fillimin e Reformës në Drejtësi.

Gjykimet e themelit zunë numrin më të madh të shqyrtimeve në Gjykatën e Apelit Shkodër në vitin 2022 me 44% të totalit vendimarrës (shih Graf. 2). Në vitin 2021 dhe 2020 ato zunë respektivisht 38.4% dhe 37.8% të totalit. Vendimet për masat e sigurisë janë kategoria e dytë më e madhe në tërësinë e çështjeve të shqyrtuara.

Tabela 5 më poshtë paraqet kohën mesatare të shqyrtimit gjyqësor dhe arsyetim/dorëzimit të vendimeve të themelit në Gjykatën e Apelit Shkodër për periudhën 2016-2022. Nga 1 Shkurti 2023, kjo gjykatë është shkrire në GJAJP Tiranë, që ka juridiksion tokësor për të gjithë Shqipërinë.

Tabela 5

Viti	Civile themeli mesatare shqyrtim (dite)	Penale themeli mesatare shqyrtim (dite)	Civile themeli mes. dorëzim (dite)	Penale themeli mes. dorëzim (dite)
2016	325	264	17.7	17.8
2017	422	363	19	14
2018	392	426	23.5	18.4
2019	350	353	20.2	18.8
2020	448	413	37.6	38.5
2021	564	428	82.3	66.9
2022	603	343	120.6	86.1
2023 ³	646	547	-	-

Në krahasim me vitin 2016 (fillimi i Reformës në Drejtësi), e deri në fund të vitit 2022, kohë e cila pasoi me mbylljen e Gjykatës së Apelit Shkodër (1 Shkurt 2023), treguesit e matur mbi kohëzgjatjen e shqyrtimit gjyqësor dhe dorëzimit të vendimit të arsyetuar (shih dhe grafikun 2 & 3), dalin në këto perfundime:

- **Për çështje civile themeli koha mesatare për shqyrtimin u rrit dyfish, kurse koha mesatare për arsyetim/dorëzim vendimi u shtatëfishua (6.8 herë);**
- **Për çështje penale themeli koha mesatare për shqyrtimin u rrit 79 ditë (nga 264 në 343), kurse koha mesatare për arsyetim/dorëzimin e vendimit u pesëfishua (nga 17.8 ditë në 86.1 ditë);**

Përveç treguesve të përkeqësuar të kohëzgjatjes gjyqësore, rënie pësoi edhe pesha specifike që zunë çështjet e themelit në totalin e çështjeve të shqyrtuara. Në vitin 2016, Gj. Apelit Shkodër shqyrtonte dhe merrte vendim për një total prej 1308 dosje themeli (692 civile⁴ dhe 616 penale⁵). Në 2017 dhe 2018 u morën respektivisht 1621 dhe 1779 vendime themeli (civile dhe penale); në 2022 Gj. Apelit Shkodër dha vetëm 801 vendime themeli (516 civile dhe 285 penale), pra rreth 1.6 herë më pak krahasuar me 2016-ën. Volumi i shqyrtimeve të themelit është reduktuar, por jo ankimet, duke e bërë këtë kategori furnizuesen kryesore të *backlog-ut*.

³ vetëm të dhënat e gjatështëmujorit të parë: 1 Shkurt 2023-31 Korrik 2023

⁴ link: <https://www.gjykataehapur.al/2016-civile/>

⁵ link: <https://www.gjykataehapur.al/2016-penale/>

Gjykimi brenda afatit të arsyeshëm, krahasimi 2016-2022

Sipas përcaktimeve në nenin 399/2, për gjykimin civil në apel afat i arsyeshëm konsiderohet përfundimi i procesit brenda dy viteve, kurse gjykimi për krimet duhet të mbyllet në një afat kohor prej 1 viti dhe për kundërvajtjet brenda 6 muajsh.

Objekt vlerësimi në kuadër të këtij studimi janë vetëm çështjet e themelit (civile dhe penale), si kategoria më e madhe e vendimarrjes në Gjykatën e Apelit Shkodër. Këto çështje janë gjithashtu më të prekura nga fenomeni i vonesave, krahasuar me tipologjitë e tjera, sikurse sugjerojnë të dhënat e analizuara (shih: Tabela 6)

Sa i takon gjykimeve penale të themelit, INFOCIP nuk ka diferencuar krimet nga kundërvajtjet penale, duke përdorur si kontrast të vetëm ligjor për të dyja kategoritë afatin 1-vjeçar. Rrjedhimisht, çështjet penale jashtë afateve të arsyeshme të gjykimit mund të jenë më shumë në realitet se sa shifra e referuar në këtë vlerësim.

Tabela 6

VITI	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
CIVILE THEMELI	700	902	848	506	329	487	516
TOTAL VENDIME				6-mujori pare			
JASHTË AFATIT TE ARSYESHËM	0	16	48	12	54	194	199
Ne %	0%	1.7%	5.66%	2.37%	16.4%	39%	38%

VITI	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
PENALE THEMELI	617	731	972	294	198	259	285
TOTAL VENDIME				6-mujori pare			
JASHTË AFATIT TE ARSYESHËM	206	473	603	110	78	100	85
Ne %	33.3%	64.7%	62%	37.4%	39.3%	38%	29%

Një shumicë prej 38% e totalit të gjykimeve civile të themelit dolën jashtë afatit të arsyeshëm të gjykimit në vitin 2022 në Gj. Apelit Shkodër (Tab.6). Para Reformës në Drejtësi, më pak se 1% e çështjeve civile të themelit në Gj. Apelit Shkodër dëlnin jashtë afatit 2-vjeçar të gjykimit.

Nga vlerësimi 2016-2022, rezulton se pati përmirësim me 4 pike % në çështjet penale të themelit sa i takon afateve të arsyeshme të gjykimit. Në 2022-in numri i gjykimeve penale që mbyllen tej afatit të arsyeshëm shkoi në 29% të totalit, duke shënuar edhe treguesin më të mirë të periudhës 2016-2022 në të cilën janë realizuar matjet dhe vlerësimet nga INFOCIP për Gjykatën e Apelit Shkodër.

NGARKESA: Në vitin 2022, Dhoma Penale e GJ. Apelit Shkodër gjykoi thuajse tre herë më pak çështje themeli krahasuar me vitin 2016. Çështjet e mbartura nga 2021 u përlogaritën në shifrën 2186, prej të cilave 702 penale. Ndërkohë, në 2022 u regjistruan edhe 1773 ankime të reja, prej të cilave 993 ishin penale⁶. Nga 1695 çështje në pritje në vitin 2022 (702 mbartje dhe 993 prurje), kjo gjykatë arriti të shqyrtojë dhe të japë vendim për vetëm 285 prej tyre në 2022-in.

⁶ Shih fq. 71-72 e Reportit vjetor të KLGJ për vitin 2022.


Kohëzgjatja pas Reformës së Rretheve Gjyqësore

Referuar 6-mujorit të parë 2023 (1 Shkurt-31 Korrik), treguesit e përpunuar nga INFOÇIP për Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, sugjerojnë se kohëzgjatja mesatare për shqyrtimin e çështjeve civile të themelit ka qenë 646 ditë, kurse për çështjet penale të themelit ka qenë 547 ditë. Sa i takon arsytimit të vendimeve, një pjesë e konsiderueshme e tyre nuk ishin dorëzuar ende në sekretarinë gjyqësore deri në Shtator 2023.


Nëse krahasohen treguesit para dhe pas Reformës së Rretheve Gjyqësore, koha e pritjes për palët gjyqësore në juridiksionin tokësor të (ish) Apelit Shkodër ka pësuar përkeqësim me 43 ditë më shumë se në 2022-in për shqyrtimin e çështjeve civile të themelit dhe një përkeqësim domethënës me 204 ditë më shumë për çështjet penale të themelit.

Në mes të Tetorit 2023, backlog-u i kaloi 37000 mijë dosje në GJAJP Tiranë. Nga 78 gjyqtarë që duhet të kishte, GJAJP Tiranë nisi punën në 1 Shkurt 2023 me 24; në Korrik 2023 ajo mbeti me 22 gjyqtarë, ndërkohë që nga Tetori 2023, një gjyqtare Apelit u zgjodh anëtare e KLGJ. Të dhënat e *Graf. 3*, vizualizojnë përkeqësimin sistematik të kohëzgjatjes gjyqësore në intervalin 2016-2023., kurse *Graf. 4* paraqet situatën e matur për kohën arsytimit/dorëzimit të vendimit (themelet vetëm)

Grafiku 3



Grafiku 4



MASAT E SIGURIMIT, vlerësimi i kohëzgjatjes 2020-2021-2022 & krahasimi me treguesit e 6-mujorit të pare 2023 të GJ.A.J.P Tiranë

Masat e sigurimit përfaqësojnë kategorinë e dytë me numrin më të lartë të vendimeve në Gjykatën e Apelit Shkodër gjatë 3-vjeçarit 2020-2022. Ato renditen pas gjykimeve për çështje civile themeli në terma të volumit (*shih tab. 1*).

Ankimi kundër masave të sigurimit në apel duhet të shqyrtohet **brenda 10 ditëve** nga marrja në dorëzim e akteve (paragrafi 6, neni 249, KPrP), ndërkohë që vendimi i arsyetuar duhet të depozitohet **brenda 10 ditëve** (paragrafi 7, neni 249, KPrP).

Nga të dhënat e analizuar nga INFOÇIP rezulton se **kohëzgjatja mesatare** për shqyrtimin e ankimeve në apel ndaj masave të sigurimit nuk e kapërceu afatin ligjor 10-ditor. Megjithatë, nëse vendimet analizohen veç e veç, vihet re se një numër vendimesh të këtij lloji janë dhënë në tejkalim të afatit ligjor (*kolona 5 në Tab. 6*).

Me probleme domethënëse paraqiten afatet e arsyetimit /dorëzimit të vendimit. Treguesi i mesatarizuar i ditëve të konsumuara për të arsyetuar dhe dorëzuar një vendim mase sigurie në Gjykatën e Apelit Shkodër, për të treja vitet e marra në analizë 2020-2023, është i tejkaluar mbi 3 herë (kolona 4, Tabela. 6). Ndërkohë, shumica dërrmuese e vendimeve kanë dalë jashtë afatit ligjor 10 ditor të dorëzimit (*paragrafi 7, neni 249, KPrP*), sikurse ilustron në kolonën 6, Tab. 6.

Tabela 6

Viti	Vendime masa sigurimi gjithsej	Mesatare e shqyrtimit (ditë)	Mesatare e dorëzimit (ditë)	Total vendime tej afatit ligjor 10-ditor të shqyrtimit	Total vendime tej afatit ligjor 10-ditor të dorëzimit
2020	272	6	23	5 (1.8%)	189 (69.4%)
2021	389	6.9	22.1	17 (4.3%)	304 (78%)
2022	320	7.5	24.3	14 (4.3%)	211 (66%)
2023	1000	10.5	34.1	88 (8.97)	755 (75.5%)

Në vitin 2022, 6 vendime u dorëzuan në sekretarinë e Gj. Apelit Shkodër tej 259 ditësh; në vitin 2021 bie në sy një vendim i dorëzuar pas 371 ditë tej afatit ligjor, kurse në 2020 ka 4 vendime që janë dorëzuar përmbi 100 ditë tej afatit ligjor të dorëzimit (*shih linkun e afishuar më poshtë*).

INFOCIP analizoi 1000 vendime për masa sigurimi të dhëna në periudhëm 1 Shkurt-4 Korrik nga GJAJP Tiranë, në të cilën u shkri Gjykata e Apelit Shkodër. **Të gjithë treguesit e matur në GJAJP rezultojnë me përkeqësim nëse krahasohen me ato të Gjykatës së Apelit Shkodër në periudhën 2020-2021-2022.**

Tabelat verifikuese me të dhënat gjyqësore për ankimet ndaj masave të sigurimit mund të hulumtohen në Platformën www.gjykataehapur.al në linket më poshtë:

2023: <https://www.gjykataehapur.al/masa-sigurimi-viti-2023-gjykata-e-apelit-j-p-tirane-me-kontrast-10-ditor-6-mujori-pare/>

2022: <https://www.gjykataehapur.al/masa-sigurimi-viti-2022-gjykata-e-apelit-shkoder/>

2021: <https://www.gjykataehapur.al/masa-sigurimi-viti-2021-gjykata-e-apelit-shkoder/>

2020: <https://www.gjykataehapur.al/masa-sigurimi-viti-2020-gjykata-e-apelit-shkoder/>

URDHRAT E MBROJTJES, vlerësimi i kohëzgjatjes 2020-2021-2022 & krahasimi me treguesit e 6-mujorit të parë 2023 të GJ.A.J.P Tiranë

INFOÇIP analizoi për herë të parë kohëzgjatjen e shqyrtimit të urdhrave të mbrojtjes në Gj. Apelit Shkodër për periudhën 2020-2022. Të dhënat e analizuara shërbejnë si *baseline* krahasimi me të dhënat e mbledhura në GJAJP Tiranë (6-mujori i parë 2023), me synim vlerësimin e trendit në kuadër të Reformës së Rretheve Gjyqësore.

Gjykata e Apelit Shkodër nuk i ka mbajtur të dhënat për urdhrat e mbrojtjes në një regjistr të posaçëm. Ato grupohen në regjistrin (numratorin) ku janë të administruara rekordet gjyqësore për Administrave Civile. Për këtë arsye vitit 2020 nuk është i procesuar. Gabimi metodologjik është i përlogaritur në masën 5%, gjatë procesit të evidentimit të këtyre lloj vendimesh nga Numratori.

Ligji nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, parashikon në nenin 21 të tij se Gjykata e Apelit shprehet me vendim brenda 15 ditëve nga dita e regjistrimit të ankimit ndaj urdhrit të mbrojtjes.

Pavarësisht numrit relativisht të vogël të vendimeve në Gj. Apelit Shkodër për urdhrat e mbrojtjes, gjysma e tyre janë shqyrtuar tej afatit ligjor 15 ditor. Përkeqësimi konstatohet si në treguesin e *mesatares në shqyrtim* ashtu edhe në treguesin e *mesatares në dorëzim*, krahasuar viti 2021 me vitin 2022.

Viti	Vendime apel U. Mbrojtje gjithsej	Mesatare (dite) shqyrtimi U.Mbrojtje	Mesatare dorëzimi (ditë) U. Mbrojtje	Total vendime tej afatit 15-ditor të shqyrtimit
2020	-	-	-	-
2021	26	21	101	13 (50%)
2022	14	26	142	7 (50%)
2023	113	31.7	51 ⁷	70 (61.9%)

INFOCIP analizoi 113 vendime për masa sigurimi të dhëna gjithësej në periudhën 1 Shkurt-4 Korrik nga GJAJP Tiranë, në të cilën u shkri Gjykata e Apelit Shkodër. **Treguesi i mesatares në shqyrtim ka pësuar rritje, por ndërkohë vihet re një ulje domethënëse sa i takon kohës mesatare të dorëzimit të vendimit.**

Tabelat verifikuese me të dhënat gjyqësore për vendimet e GJ. Apelit Shkodër për ankimet ndaj urdhrave të mbrojtjes mund të hulumtohen në Platformën www.gjykataehapur.al sipas viteve, në linket me poshtë:

Viti	Link në www.gjykataehapur.al
2023	https://www.gjykataehapur.al/urdher-mbrojtje-gjykata-e-apelit-te-juridiksionit-te-pergjithshem-tirane-viti-2023-6-mujori-i-pare-shqyrtimi-dorezimi-respektimi-i-afatit-ligjor/
2022	https://www.gjykataehapur.al/urdher-mbrojtje-gjykata-e-apelit-shkoder-viti-2022/
2021	https://www.gjykataehapur.al/urdher-mbrojtje-gjykata-e-apelit-shkoder-viti-2021/

⁷ Mesatarja i referohet vetëm 75 vendimeve nga 113 gjithsej; për 38 vendime ende nuk ishte pasqyruar në numerator data e dorëzimit të tyre në sekretarinë e gjykatës deri në fund të muajit gusht kur janë grumbulluar këto të dhëna nga INFOÇIP.

GJETJET E VLERESIMIT TEMATIK VITI 2020-2023

GJYKATA E APELIT VLORE

NGARKESA SIPAS LLOJIT TE ÇESHTJEVE DHE TRUPA GJYQESORE

Referuar numratorëve të saj, Gjykata e Apelit Vlorë dha 2486 vendime gjatë vitin 2022; 2864 vendime në vitin 2021 dhe 1993 vendime në 2020-ën. *Tabela nr.1* paraqet volumin vendimarrës të Gjykatës së Apelit Vlorë për 3-vjeçarin 2020-2022, renditur sipas numratorëve që ajo vetë administron.

Tabela 1

Lloji / Tipologjia	Total Vendime viti 2022	Total Vendime viti 2021	Total Vendime viti 2020
Çështje Penale Themeli	262	286	231
Çështje Civile Themeli	375	393	349
Masa Sigurimi	473	534	434
Civile shkalle e parë	217	228	0
Familjare	56	23	2
Civile e veçantë	135	205	133
Urdhër Ekzekutimi	249	432	254
Urdhër Mbrojtje	47	51	35
Mardhënie Pune	56	28	1
Tragtare	0	4	1
Penale për të Mitur	11	16	7
Kundravajtje Penale	21	13	4
Penale e veçantë	233	335	321
Penale Shkalla 1	84	58	64
Pushim Procedimi Penal	201	201	106
Dhunë në Familje	66	57	51
TOTAL VJETOR	2486	2846	1993
Nr. efektiv gjyqtarësh¹	7.6	6.8	7.6
Mes. Vendime/Gjyqtar	327.1	418.5	262.2

Gjykata e Apelit Vlorë ka përdorur një sistem të larmishëm numratorësh, ku regjistrohen të dhënat gjyqësore për rreth 16 kategori gjykimesh/vendimesh. Kjo shumësi regjistrash vështirëson analizën krahasuese me gjykatat e tjera të apelit të cilat i grupojnë gjykimet e tyre në 5 apo 6 tipologji regjistrash. Gjykata e Apelit Vlorë nuk pasqyron në numratorët e saj datën e dorëzimit të vendimit të arsyetuar.

Gjykata e Apelit Vlorë funksionoi gjatë vitit 2022 me 7.6 gjyqtarë të efektivë, nga 12 që kishte të dekretuar. Në tabelën 1, në dy rrjeshtat e fundit jepen të dhënat për numrin efektiv të gjyqtarëve dhe mesataren vendimarrëse të tyre për periudhën 2020-2021-2022. Viti 2022 ka treguesit më të lartë, krahasuar vitet e tjera.

Masat e sigurimit përfaqësojnë numrin më të madh shqyrtimeve, në të treja vitet e marra në analizë, ndjekur nga çështjet civile të themelit. Nëse grupohen penale dhe civile themeli së bashku, ato përbëjnë kategorinë me numrin më të madh të gjykimeve të përfunduara në periudhën 2020-2023. Pavarësisht ngarkesës së gjykitimit apo trupës gjyqësore, raportet mes kategorive të gjykitimit tentojnë të jenë të pandryshuara.

¹ sipas raportimit zyrtar të KLGJ në raportet vjetore 2020 dhe 2022.

KOHËZGJATJA GJYQËSORE & ARSYETIM/DOREZIMI I VENDIMIT

INFOÇIP ka analizuar kohëzgjatjen gjyqësore për katër tipologji të rëndësishme vendimesh: Çështje Civile Themeli, Çështje Penale Themeli, Masa Sigurimi dhe Urdhra Mbrojtje. Periudha e matur dhe e analizuar përfshin 3 fasha kohore:

- 3-vjeçarin 2020-2022
- 6-mujorin e parë të funksionimit të GJAJP Tiranë.
- Krahësim i të dhënave të periudhës 2016-2019 me të dhënat e reja të periudhës 2020-2022 dhe 6-mujorit të parë 2023, për identifikimin e trendit të vonësive gjyqësore para në interval të pandërprerë 7-vjeçar.

ÇËSHTJE THEMELI, CIVILE DHE PENALE, 2020-2022

Të dhënat e analizuar nga INFOÇIP përmes Platformës së automatizuar www.gjykataehapur.al sugjerojnë se treguesit e shqyrtimit gjyqësor u përkeqësuan në mënyrë domethënëse nga viti 2020 e deri në fund të vitit 2022 (në 1 Shkurt 2023, kjo gjykatë u shkri bashkë me 5 gjykata të tjera apeli në GJAJP Tiranë).

Tabela 2 paraqet totalin e çështjeve të themelit, civile dhe penale, që ka mundur të shqyrtojë dhe të përmbyle me vendim Gj. Apelit Vlorë, në periudhën 2020-2022.

Tabela 3 ofron të dhënat për periudhën 2020-2022 mbi kohëzgjatjes mesatare në shqyrtim për çështjet e themelit, Penale dhe Civile, për Gjykatën e Apelit Vlorë.

Tabela 2

Lloji / Tipologjia	Total Vendime viti 2022	Total Vendime viti 2021	Total Vendime viti 2020
Penale Themeli	262	286	231
Civile Themeli	375	393	349
Total Themele	637	679	580

Tabela 3

GJA Vlorë	Mesatare shqyrtim (dite), viti 2022	Mesatare shqyrtim (dite), viti 2021	Mesatare shqyrtim (dite), viti 2020
Penale Themeli	372	504.6	351.7
Civile themeli	1084	967	691.5

Konkluzione të përmbledhura për periudhën 2020-2021-2022

Koha mesatare e pritjes së palëve ndërgjyqëse që Gjykata e Apelit Vlorë të përfundonte shqyrtimin e një ankimi për **çështje civile themeli** u përkeqësua ndjeshmë dhe sistematikisht. Në vitin 2022 ajo u rrit 393 ditë krahasuar me vitin 2020 (nga 691.5 ditë në 1084 ditë).

Për **çështje penale themeli**, për të njëjtën periudhë vlerësimi, kohëzgjatja u përkeqësua ndjeshëm në vitin 2021, por u rikuperua në vitin 2022, në nivelet e vitit 2020.

Analiza krahasuese 2016-2022 (Para dhe Pas Reformës në Drejtësi)

Vlerësimi tematik i kohëzgjatjes gjyqësore për çështjet e themelit në Gjykatën e Apelit Vlorë realizohet nga INFOÇIP që prej vitin 2016 që shërbën si *baseline* për efekt të këtij studimi. Ky vit përkon edhe me fillimin e Reformës në Drejtësi.

Gjykimet e themelit, të marra së bashku (civile dhe penale), zënë numrin më të madh të shqyrtimeve në Gjykatën e Apelit Vlorë në periudhën 2020-2022. Tabela më poshtë paraqet kohën mesatare të shqyrtimit gjyqësor të vendimeve të themelit në Gjykatën e Apelit Vlorë për periudhën 2016-2022. Kjo gjykatë nuk pasqyron në numratorët e saj datën e dorëzimit të vendimit të arsyetuar dhe të dhënat për këtë tregues janë pjesërisht të pasqyruara në tabelën e mëposhtme.

Tabela 5

Viti	Civile themeli mesatare shqyrtim (dite)	Penale themeli mesatare shqyrtim (dite)	Civile themeli mes. dorëzim (dite)	Penale themeli mes. dorëzim (dite)
2016	346	262	20.8	20.7
2017	478	321	26.8	23.5
2018	546	391	-	-
2019	614	433	-	-
2020	692	352	-	-
2021	967	505	-	-
2022	1084	372	-	-
2023 ²	646	547	-	-

Në krahasim me vitin 2016 (fillimi i Reformës në Drejtësi), e deri në fund të vitit 2022, kohë e cila pasoi me mbylljen e Gjykatës së Apelit Vlorë (1 Shkurt 2023), treguesit e matur mbi kohëzgjatjen e shqyrtimit gjyqësor dalin në këto perfundime:

- **Për çështje civile themeli** koha mesatare për shqyrtimin u rrit **trëfish**, duke arritur shifrën rekord prej 1084 ditë në vitin 2022 krahasuar me vetëm 346 ditë në vitin 2016;
- **Për çështje penale themeli** koha mesatare për shqyrtimin u rrit **sistematikisht nga viti 2016**; ajo u dyfishua në vitin 2021 me 505 ditë, për t'u përmirësuar disi në vitin 2022 me 372 ditë mesatarisht për zgjidhjen e një gjykimi penal themeli në apel.

Përveç treguesve të përkeqësuar të kohëzgjatjes gjyqësore, rënie pësoi edhe pesha specifike që zunë çështjet e themelit në totalin e çështjeve të shqyrtuara. Në vitin 2016, Gjykata e Apelit Vlorë arrinte të shqyrtonte dhe merrte vendim për një total prej 2194 dosje themeli (1407 civile³ dhe 786 penale⁴). Në 2022 GJA Vlorë dha vetëm 637 vendime themeli (375 civile dhe 262 penale), pra rreth 3.4 herë më pak krahasuar me 2016-ën. Volumi i shqyrtimeve të themelit është reduktuar, por jo ankimet, duke e bërë këtë kategori furnizuesen kryesore të *backlog*-ut.

² vetëm të dhënat e gjateshtëmujorit të parë: 1 Shkurt 2023-31 Korrik 2023

³ link: <https://www.gjykataehapur.al/gjykata-e-apelit-vlore-viti-2016-kohezgjatja-e-shqyrtimit-gjyqesor-ceshtje-civile-themeli/>


⁴ link: <https://www.gjykataehapur.al/gjykata-e-apelit-vlore-viti-2016-kohezgjatja-e-shqyrtimit-gjyqesor-ceshtje-penale-themeli/>

Kohëzgjatja pas Reformës së Rretheve Gjyqësore

Gjykata e Apelit Vlorë funksionoi si e tillë deri në 31 Janar 2023. Në 1 Shkurt 2023 ajo u shkri në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (GJAJP). Referuar 6-mujorit të parë (1 Shkurt-31 Korrik, '23), treguesit e përpunuar nga INFOÇIP, sugjerojnë se kohëzgjatja mesatare për shqyrtimin e çështjeve civile të themelit në GJAJP Tiranë ka qenë 646 ditë; për penale të themelit ka qenë 547 ditë⁵.

Grafiku 5 paraqet në një interval kohor 8-vjeçar kohëzgjatjen e shqyrtimit gjyqësor të çështjeve të themelit, ku mund të krahasohen treguesit e Gj. Apelit Vlorë 2016-2022 me 6-mujorin e parë 2023, ku ajo është e shkrirë në GJAJP Tiranë.

Grafiku 3



Pas Reformës së Rretheve Gjyqësore, vihet re një përmirësim sa i takon kohëzgjatjes mesatare të shqyrtimit të çështjeve civile të themelit krahasuar me vitin 2022, por një përkeqësim të ndjeshëm me 175 ditë të kohës mesatare për shqyrtimin e çështjeve penale të themelit.

Viti 2022 nisi me 4234 çështje të mbatura nga 2021 në Gj. Apelit Vlorë, shifër kjo e cila në vetvete përbën një tregues historik. Gjatë vitit 2022 u regjistruan 2943 ankime të reja⁶. Gj. Apelit Vlorë mundi të merrte vetëm 2486 vendime gjatë vitit 2022. Mbartjet për vitin 2023 u përlogatitën në 4691, të gjitha këto të sjella këto GJAJP Tiranë në momentin e shkrirjes së gjykatave. Ky është stoku i dytë më i madh që GJAJP Tiranë “trashëgoi” nga ish gjykatat e Apelit, pas asaj të Tiranës.

Një trupë prej 7.6 gjyqtarësh efektivë, me një mesatare prej 327 çështjesh të shqyrtuara në vit për gjyqtar (shih treguesit e tab. 1 për 2022-in), ish-Gjykata e Apelit Vlorë do të mund ta evakuonte këtë stok për 1.9 vjet (pa llogaritur prurjet e reja).

Ndërkohë, në mes të Tetorit 2023, backlog-u në GJAJP Tiranë kaloi 37 mijë dosje. Për një trupë prej vetëm 21 gjyqtarësh që do të punon për të evaduar këtë stok, me një mesatare prej 300 vendimesh në vit për gjyqtar, do të nevojiteshin 5.8 vite; me një mesatare prej 327 çështjes në vit/gjyqtar, koha e evadimit do të ishte 5.4 vjet.

Në të dyja rastet, koha e pritjes për palët ndërgjyqëse për të futur në shqyrtim gjyqësor një ankim në ish-Apelin Vlorë ka qenë më e ulët para Reformës së Rretheve Gjyqësore, krahasuar me pritjen sot në GJAJP.

⁵ Sa i takon arsytimit të vendimeve, një pjesë e madhe nuk ishin dorëzuar në sekretarinë gjyqësore deri në Shtator 2023.

⁶ referuar Raportit Vjetor për vitin 2022 të KLGJ, fq. 71-72

Gjykimi brenda një afati të arsyeshëm, krahasimi 2016-2022

Sipas përcaktimeve në nenin 399/2, për gjykimin civil në apel afat i arsyeshëm konsiderohet përfundimi i procesit brenda dy viteve, kurse gjykimi për krimet duhet të mbyllet në një afat kohor prej 1 viti dhe për kundërvajtjet brenda 6 muajsh.

Objekt vlerësimi në kuadër të këtij studimi janë vetëm çështjet e themelit (civile dhe penale), si kategoria më e madhe e vendimarrjes në Gjykatën e Apelit Vlorë. Këto çështje rezultojnë gjithashtu më të prekura nga fenomeni i vonesave, krahasuar me tipologjitë e tjera, sipas të dhënave që analizon ky studim.

Sa i takon gjykimeve penale të themelit, INFOCIP nuk ka diferencuar krimet nga kundërvajtjet penale, duke përdorur si kontrast të vetëm ligjor për të dyja kategoritë afatin 1-vjeçar. Rrjedhimisht, çështjet penale jashtë afateve të arsyeshme të gjykimit mund të jenë më shumë në realitet se sa shifra e referuar në këtë vlerësim.

Një shumicë prej 81% e totalit të gjykimeve civile të themelit dolën jashtë afatit të arsyeshëm të gjykimit në vitin 2022 në Gj. Apelit Vlorë (Tab.6).

Para Reformës në Drejtësi, vetëm 1.2% e çështjeve civile të themelit në Gj. Apelit Vlorë dilnin jashtë një afati 2-vjeçar gjykimi.

Nga vlerësimi 2016-2022, rezulton se pati përmirësim në çështjet penale të themelit sa i takon afateve të arsyeshme të gjykimit. Në 2022-in numri i gjykimeve penale që mbyllen tej afatit të arsyeshëm shkoi në 27% të totalit, duke shënuar edhe treguesin më të mirë të periudhës 2017-2022. Përrjashtim bënë vetëm viti 2016, gjatë të cilin vetëm 0.5% e gjykimeve penale të themelit dilnin jashtë afatit 1-vjeçar të gjykimit në ish-Gjykatën e Apelit Vlorë.

Tabela 6

VITI	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
CIVILE THEMELI	1407	1303	1097	823	349	393	375
TOTAL VENDIME							
JASHTË AFATIT	17	37	175	302	165	273	307
TE ARSYESHEM							
Ne %	1.2%	2.8%	15.9%	36.6%	47.2%	69%	81%

VITI	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
PENALE THEMELI	795	825	668	449	231	286	262
TOTAL VENDIME							
JASHTË AFATIT	4	342	366	277	80	131	71
TE ARSYESHEM							
Ne %	0.5%	41.4%	54.7%	61.6%	34%	45%	27%

Pavarësisht rritjes së numrit të gjykimeve që tejkaluan afatet e arsyeshme, në vitin 2022, Dhoma Penale e GJ. Apelit Vlorë gjykoj thujse tre herë më pak çështje themeli krahasuar me vitin 2016, kurse Dhoma Civile 3.7 herë më pak krahasuar me vitin 2016. Shifra 81% tej afateve të arsyeshme është historike dhe duhet trajtuar me shumë kujdes !

MASAT E SIGURIMIT, vlerësimi i kohëzgjatjes 2020-2021-2022 & krahasimi me treguesit e 6-mujorit të parë 2023 të GJ.A.J.P Tiranë

Masat e sigurimit përfaqësojnë kategorinë me numrin më të lartë të vendimeve në Gjykatën e Apelit Vlorë gjatë 3-vjeçarit 2020-2023. Pas tyre renditen gjykimet për çështje civile themeli, pasuar nga penale themeli (*shih tab. 1*).

Ankimi kundër masave të sigurimit në apel duhet të shqyrtohet **brenda 10 ditëve** nga marrja në dorëzim e akteve (paragrafi 6, neni 249, KPrP), ndërkohë që vendimi i arsyetuar duhet të depozitohet **brenda 10 ditëve** (paragrafi 7, neni 249, KPrP).

Nga të dhënat e analizuara nga INFOÇIP rezulton se **kohëzgjatja mesatare** për shqyrtimin e ankimeve në apel ndaj masave të sigurimit nuk e kapërcen afatin ligjor 10-ditor. Megjithatë, nëse vendimet analizohen veç e veç, vihet re disa vendime të këtij lloji janë dhënë në tejkalim të afatit ligjor (*kolona 5 në Tabelën 6*).

Sa i takon afateve të arsyetim /dorëzimit të vendimit, numratorët e analizuar nga Gjykata e Apelit Vlorë nuk e regjistrojnë / ofrojnë këtë të dhënë.

Tabela 6

Viti	Vendime masa sigurimi gjithsej	Mesatare e shqyrtimit (ditë)	Mesatare e dorëzimit (ditë)	Total vendime tej afatit ligjor 10-ditor të shqyrtimit	Total vendime tej afatit ligjor 10-ditor të dorëzimit
2020	434	9.6	-	6 (1.38%)	-
2021	534	6.9	-	34 (6.3%)	-
2022	473	9.7	-	43 (9%)	-
2023	1000	10.5	34.1	88 (8.97)	755 (75.5%)

Në vitin 2022, ka më shumë vendime për masa sigurimi në apel që janë dorëzuar në sekretarinë e gjykatës tej afatit ligjor krahasuar me dy vitet pararendëse. Ka vetëm një vendim, shqyrtimi i të cilit ka konsumuar më shumë se 200 ditë, dhe dy vendime të tjera të cilat janë marrë pas një shqyrtimi mbi 100-ditor nga momenti i depozitimit të ankimit.

Treguesit e matur nga INFOÇIP kanë një tendencë të lehtë përkeqësimi në 6-mujorin e parë të vitit 2023 teksa Gjykata e Apelit Vlorë u shkri në 1 shkurt 2023 në GJAJ.P Tiranë.

Tabelat verifikuese me të dhënat gjyqësore për ankimet ndaj masave të sigurimit mund të hulumtohen në Platformën www.gjykataehapur.al sipas viteve, në linket më poshtë:

2023: <https://www.gjykataehapur.al/masa-sigurimi-viti-2023-gjykata-e-apelit-j-p-tirane-me-kontrast-10-ditor-6-mujori-pare/>

2022: <https://www.gjykataehapur.al/masa-sigurimi-viti-2022-gjykata-e-apelit-vlore/>

2021: <https://www.gjykataehapur.al/masa-sigurimi-viti-2021-gjykata-e-apelit-vlore/>

2020: <https://www.gjykataehapur.al/masa-sigurimi-viti-2020-gjykata-e-apelit-vlore/>

URDHRAT E MBROJTJES, vlerësimi i kohëzgjatjes 2020-2021-2022 & krahasimi me treguesit e 6-mujorit të parë 2023 të GJ.A.J.P Tiranë

Ligji nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, parashikon në nenin 21 të tij se Gjykata e Apelit shprehet me vendim brenda 15 ditëve nga dita e regjistrimit të ankimit ndaj urdhrat të mbrojtjes.

INFOÇIP ka analizuar për herë të parë kohëzgjatjen e kësaj kategorie çështjes në gjykatat e apelit për periudhën 2020-2022. Të dhënat e analizuara shërbejnë si *baseline* krahasimi me të dhënat që do të fillojnë të grumbullohen nga GJAJP Tiranë, me synim vlerësimin e treguesve në kuadër të Reformës së Rretheve Gjyqësore.

Viti	Vendime apel U. Mbrojtje gjithsej	Mesatare (dite) shqyrtimi U.Mbrojtje	Mesatare dorëzimi (ditë) U. Mbrojtje	Total vendime tej afatit 15-ditor të shqyrtimit
2020	35	15.8	-	6 (17%)
2021	51	18.3	-	17 (33%)
2022	47	26.6	-	28 (59.5%)
2023	113	31.7	51 ⁷	70 (61.9%)

Pavarësisht numrit relativisht të vogël të vendimeve në GJA Vlorë për urdhrat e mbrojtjes, vihet re mbi gjysma e tyre në vitin 2022 janë shqyrtuar tej afatit ligjor 15 ditor. Përkeqësimi shtohet progresivisht nga vitit 2020 në vitin 2022, duke nisur nga 6% tej afatit ligjor për të përfunduar në 59.5% .

Krahasuar me treguesit e matur gjatë vitit 2023, 6-mujori i parë në GJAJP Tiranë, në të cilën Gj. Apelit Vlorë është shkrire, rezulton një përkeqësim i mëtejshëm i treguesve për këtë kategori vendimesh.

Gjykata e Apelit Vlorë i ka mbajtur të dhënat për urdhrat e mbrojtjes në një regjistër të posaçëm. Në të njëjtin regjistër nuk pasqyrohen datat e dorëzimit të vendimit në sekretarinë e gjykatës.

Tabelat verifikuese me të dhënat gjyqësore për vendimet e GJ. Apelit Vlorë për ankimet ndaj urdhrave të mbrojtjes mund të hulumtohen në Platformën www.gjykataehapur.al sipas viteve, në linket me poshtë:

Viti	Link ne www.gjykataehapur.al
2023	https://www.gjykataehapur.al/urdher-mbrojtje-gjykata-e-apelit-te-juridiksionit-te-pergjithshem-tirane-viti-2023-6-mujori-i-pare-shqyrtimi-dorezimi-respektimi-i-afatit-ligjor/
2022	https://www.gjykataehapur.al/urdher-mbrojtje-gjykata-e-apelit-shkoder-viti-2022/
2021	https://www.gjykataehapur.al/urdher-mbrojtje-gjykata-e-apelit-vlore-viti-2021/
2020	https://www.gjykataehapur.al/urdher-mbrojtje-gjykata-e-apelit-vlore-viti-2020/

⁷ Mesatarja i referohet vetëm 75 vendimeve nga 113 gjithsej; per 38 vendime ende nuk ishte pasqyruar në numerator data e dorëzimit të tyre në sekretarinë e gjykatës deri në fund të muajit gusht kur janë grumbulluar këto të dhëna nga INFOÇIP.

GJETJET E VLERESIMIT TEMATIK VITI 2020-2023

GJYKATA E APELIT KORÇË

NGARKESA SIPAS LLOJIT TE ÇESHTJEVE DHE TRUPA GJYQESORE

Gjykata e Apelit Korçë dha 716 vendime gjatë vitin 2022; 862 vendime në vitin 2021 dhe 538 vendime në 2020-ën. *Tabela nr.1* paraqet treguesit e volumit vendimarrës të Gjykatwn e Apelit Korçë për 3-vjeçarin 2020-2022. Në të treja vitet, raportet midis kategorive të ndryshme të çështjeve gjyqësore nuk kanë ndryshime thelbësore. Kategoria me më shumë vendime në GJA Korçë mbetet ajo e masave të sigurimit, e ndjekur nga çështje themeli civile dhe penale.


GJ. Apelit Korçë, që nga viti 2020 e deri sa u shkri në 1 Shkurt 2023 funksionoi me më pak se gjysmën e trupës gjyqësore; numri i gjyqtarëve sipas dekretit duhet të ishte 6. Në *tabelën 1*, në dy rrjeshtat e fundit jepen të dhënat për numrin efektiv të gjyqtarëve dhe mesataren vendimarrëse të tyre për periudhën 2020-2022.

Tabela 1

Lloji / Tipologjia	Total Vendime viti 2022	Total Vendime viti 2021	Total Vendime viti 2020
Çështje Civile Themeli	141	188	34
Çështje Penale Themeli	117	110	73
Masa Sigurimi	238	278	240
Urdhër Mbrojtje	5	7	9
Penale e veçantë	110	153	110
Civile e veçante	34	72	20
Njohje vendim i huaj	60	48	46
Gjykime shkallë e parë	11	6	5
TOTAL VJETOR	716	862	538
Nr. efektiv gjyqtarësh	2.75	3	2.3
Mes. Vendime/Gjyqtar	260	287	234

Për të krijuar një vizualizim të raporteve të shpërndarjes së ngarkesës, grafiku më poshtë paraqet situatën për vitin 2022, ndërkohë që grafikët respektivë të çdo viti mund të hulumtohen në Platformën www.gjykataehapur.al. Në *grafikun 1* ngarkesa e vitit 2022 paraqitet sipas përqindjes, ndërkohë tek legjenda (*djathtas*) jepet dhe numri për çdo tipologji/kategori vendimesh.

Grafiku 1



KOHËZGJATJA GJYQËSORE & ARSYETIM/DORËZIMI I VENDIMIT

INFOÇIP ka analizuar kohëzgjatjen gjyqësore për katër tipologji të rëndësishme vendimesh: Çështje Civile Themeli, Çështje Penale Themeli, Masa Sigurimi dhe Urdhra Mbrojtje. Secila prej këtyre kategorive ka afate specifike brenda të cilave duhet gjykata duhet të konkludojë me vendim. Periudha e matur dhe e analizuar përfshin 3 fasha kohore:

- *3-vjeçarin 2020-2022- kjo periudhë ndërlidh me të dhëna të krahasueshme periudhën 2016-2019 të cilën INFOCIP e ka analizuar në raportet pararendëse sa i takon treguesve të kohëzgjatjes gjyqësore, kryesisht për çështjet e themelit në shkallë të dytë të gjykimit. Fundi i periudhës 2020-2022 përkon me shkrirjen e 6 gjykatave të apelit në një gjykatë të vetme, të vendosur në Tiranë¹, e cila nisi nga puna në 1 Shkurt 2023.*
- *6-mujorin e parë të funksionimit të GJAJP Tiranë. Kjo periudhë fillon nga data 1 Shkurt 2023 deri në datën 31 Korrik 2023 duke krijuar bazë krahasimi për treguesit e kohëzgjatjes gjyqësore me periudhën 2016-2022 (para dhe pas Reformës së Rretheve Gjyqësore).*
- *Krahasim i të dhënave të periudhës 2016-2019 me të dhënat e reja të periudhës 2020-2022 dhe 6-mujori i parë 2023, për identifikimin e trendit të vonesave gjyqësore para dhe pas Reformës në Drejtësi në interval të pandërprerë 7-vjeçar.*

Kohëzgjatja gjyqësore është koha e përlogaritur në ditë (ose vite) nga momenti i regjistrimit të ankimit në sekretarinë e gjykatës deri në momentin kur gjykata merr vendim dhe shpall dispozitivin.

INFOÇIP gjithashtu ka matur dhe vlerësuar kohën e arsyetimit të vendimit dhe dorëzimit të tij në sekretarinë gjyqësore. Ligji procedural parashikon afate për dorëzimin e vendimit të arsyetuar në sekretarinë e gjykatës, sipas llojit të çështjes gjyqësore. Koha e dorëzimit përlogaritet në ditë dhe fillon nga momenti i shpalljes së vendimit (dispozitivit) deri në momentin kur vendimi i arsyetuar dorëzohet dhe regjistrohet në sekretarinë e gjykatës.

Për herë të parë, vendimet e dhëna në shkallën e dytë të gjykimit për periudhën 2020-2022 analizohen edhe në terma të respektimit të afatit gjykimit të arsyeshëm, konform parashikimeve të nenit 399/2 të K.Pr.C.

Për herë të parë INFOÇIP ka vlerësuar edhe respektimin e afateve ligjore për masat e sigurimit, ankimi në apel i të cilave duhet të shqyrtohet **brenda 10 ditëve** nga marrja në dorëzim e akteve (paragrafi 6, neni 249, KPrP), ndërkohë që vendimi i arsyetuar duhet të depozitohet **brenda 10 ditëve** (paragrafi 7, neni 249, KPrP).

Po për herë të parë vlerësohen edhe urdhrat e mbrojtjes, për të cilat neni 21 i ligjit nr.9669, datë 18.12.2006 “*Per masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare*”, përcakton se Gjykata e Apelit shprehet me vendim brenda 15 ditëve nga dita e regjistrimit të ankimit.

¹ Kjo gjykatë do të referohet më poshtë me akronimin GJAJP Tiranë.

ÇËSHTJE THEMELI, CIVILE DHE PENALE, 2020-2022

Të dhënat e analizuara nga INFOÇIP përmes Platformës së automatizuar www.gjykataehapur.al sugjerojnë se treguesit e shqyrtimit gjyqësor u përkeqësuan në mënyrë domethënëse nga viti 2020 e deri në fund të vitit 2022, kur GJ. Apelit Korçë po mbyllte aktivitetin për t'u shkrire në GJA të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, si pasojë e Reformës së Rretheve Gjyqësore.

Tabela 2 paraqet totalin e çështjeve të themelit, civile dhe penale, që ka mundur të shqyrtojë dhe të përmbylle me vendim GJA Korçë, në periudhën 2020-2022.

Tabela 3 ofron të dhënat për periudhën 2020-2022 sa i takon treguesit të kohëzgjatjes mesatare në shqyrtim për çështjet e themelit, Penale dhe Civile, për Gjykatën e Apelit Korçë.

Tabela 4 ofron të dhënat e tre-vjeçarit për këtë gjykatë sa i takon kohës së arsyetimit/dorëzimit të vendimeve për çështjet e themelit, civile dhe penale.

Lloji / Tipologjia	Total Vendime viti 2022	Total Vendime viti 2021	Total Vendime viti 2020
Civile Themeli	141	188	34
Penale Themeli	117	110	73
Total Themele	258	298	107

GJA Korçë	Mesatare shqyrtim (dite), viti 2022	Mesatare shqyrtim (dite), viti 2021	Mesatare shqyrtim (dite), viti 2020
Civile Themeli	533	361.8	222
Penale themeli	322	183.5	149

GJA Korçë	Mesatare dorëzim (dite) 2022	Mesatare dorëzim (dite) 2021	Mesatare dorëzim (dite) 2020
Civile Themeli	89.2	91.2	81.6
Penale themeli	108	68.7	56

Konkluzione të përmbledhura për periudhën 2020-2022

Koha mesatare e pritjes së palëve që GJ. Apelit Korçë të përfundonte shqyrtimin e një ankimi **për çështje civile themeli u rrit me 2.4 herë** (nga 222 në 533 ditë) nga viti 2020 në vitin 2022. Për të njëjtën periudhë vlerësimi, **për çështje penale themeli, kohëzgjatja mesatare u rrit me 2.2 herë** (nga 149 në 322 ditë).

Koha mesatare e arsyetimit të vendimit pësoi përkeqësim të ndjeshëm në **çështje penale themeli, dorëzimi i të cilave u zgjat dyfish** nga viti 2020-2022 (nga 56 ditë në 108 ditë). Arsyetimi i vendimeve në **çështje civile themeli** u luhet në interalin midis 80 dhe 90 ditësh në periudhën 2020-2022.

Analiza krahasuese, 2016-2022 (Para dhe Pas Reformës në Drejtësi)

Vlerësimi tematik i kohëzgjatjes gjyqësore për çështjet e themelit realizohet sistematikisht nga INFOÇIP që prej vitin 2016, duke siguruar një bazë krahasimi të plotë të treguesve që nga momenti i fillimit të Reformës në Drejtësi. Vendimet për çështjet e themelit, nga viti 2016 deri në vitin 2019 përfaqësonin pjesën më të madhe të totalit të ngarkesës të gjykimeve në Apelin Korçë.

Pas nisjes së Reformës në Drejtësi, kjo kategori vendimesh rezulton të jetë më e vonuara krahasuar me të tipologjitë e tjera (masa sigurimi, urdhra mbrojtje, etj). Po ashtu, volumi i shqyrtimeve të themelit është reduktuar ndjeshëm duke e bërë këtë kategori furnizuesen kryesore të *backlogut*. Çështjet e themelit në apel janë ato që më së shumti tejkalojnë edhe afatet e gjykimit të arsyeshëm.

Viti	Civile themeli mesatare shqyrtim (dite)	Penale themeli mesatare shqyrtim (dite)	Civile themeli mes. dorëzim (dite)	Penale themeli mes. dorëzim (dite)
2016	147	135	16.4	14.4
2017	151	141	21.1	17
2018	135	125	25.6	26
2019	145	131	24.9	25.2
2020	222	149	81.6	56
2021	362	184	91.2	68.7
2022	533	322	89.2	108
2023 ²	646	547	-	-

Në krahasim me vitin 2016, që përkon me fillimin e Reformës në Drejtësi, e deri në fund të vitit 2022, kohë e cila pasoi me mbylljen e Gjykatës së Apelit Korçë (1 Shkurt 2023), treguesit e matur mbi kohëzgjatjen e shqyrtimit gjyqësor dhe dorëzimit të vendimit të arsyetuar (*shih dhe grafikun 2 & 3*), dalin në këto perfundime:

- Koha mesatare për shqyrtimin e një **çështje civile themeli** u rrit me 4 herë;
- Koha mesatare për shqyrtimin e një **çështje penale themeli** u rrit 2.3 herë;
- Koha mesatare për arsyetimin e vendimit në çështje civile themeli u rrit 5 herë;
- Koha mesatare për arsyetimin e vendimit në çështje penale themeli u rrit 7 herë

Pavarësisht treguesve të përkeqësuar të kohëzgjatjes gjyqësore, rënie pësoi edhe pesha specifike që zunë çështjet e themelit si çështje të shqyrtuara. Në vitin 2016, Gj. Apelit Korçë arrinte të shqyrtonte dhe merrte vendim për një total prej 720 dosjesh themeli (443 civile³ dhe 277 penale⁴). Në 2017 dhe 2018, u morën respektivisht 703 dhe 701 vendime themeli (civile dhe penale). Ndërkohë, në vitin 2022, GJA Korçë dha vetëm 258 vendime themeli (141 civile dhe 117 penale), pra rreth 3 herë më pak krahasuar me 2016-ën, duke rritur në stokun.

Viti 2022 nisi me 1252 çështje të mbartura që nga vitit 2021 (550 civile dhe 282 penale). Gjatë vitit 2022 u regjistruan si ankime të reja (prurje) 296 çështje civile dhe 526 çështje penale, pra një total prej 822 ankimesh/dosjesh. Ndërkohë, viti 2021 nisi me 674 dosje të mbartura nga vitit paraardhës, ndërkohë që u regjistruan 1019 ankime të reja, me një total Mbartje+Prurje prej 1693 dosjesh.

² vetëm të dhënat e gjatështëmujorit të parë: 1 Shkurt 2023-31 Korrik 2023

³ link: <https://www.gjykataehapur.al/gjykata-e-apelit-korce-viti-2016-kohezgjitja-e-shqyrtimit-gjyqesor-ceshtje-civile-themeli/>

⁴ link: <https://www.gjykataehapur.al/gjykata-e-apelit-korce-viti-2016-kohezgjitja-e-shqyrtimit-gjyqesor-ceshtje-penale-themeli/>


Kohëzgjatja pas Reformës së Rretheve Gjyqësore, Shkurt-Korrik 2023

Referuar 6-mujorit të parë 2023 (1 Shkurt-31 Korrik), treguesit e përpunuar nga INFOÇIP për Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, sugjerojnë se kohëzgjatja mesatare për shqyrtimin e çështjeve civile të themelit ka qenë 646 ditë, kurse ajo për shqyrtimin e çështjeve penale të themelit ka qenë 547 ditë.


Nëse krahasohen treguesit para dhe pas Reformës së Rretheve Gjyqësore, koha e pritjes për palët gjyqësore nën juridiksionin tokësor të (ish) Apelit Korçë ka pësuar një përkeqësim me 225 ditë më shumë se në 2022-in për shqyrtimin e çështjeve penale të themelit dhe 113 ditë më shumë për çështjet civile të themelit.

Të dhënat flasin qartë se **një palë ndërgjyqëse e zgjidhte ankimin në GJ. Apelit Korçë më shpejt se sa mund ta zgjidhë sot në GJAJP Tiranë**, edhe pse GJ. Apelit Korçë ka punuar tre vitet e fundit me më pak se 3 gjyqtarë, pra më pak se gjysmën e trupës gjyqësore që duhet të kishte në dispozicion.

Grafiku 3



Edhe koha e arsyetimit të vendimit pritet të pësojë përkeqësim në GJAJP Tiranë. Në të dhënat e përditësuar në muajin shtator 2023 nga INFOÇIP, nga 1346 vendime penale themeli vetëm 791 prej tyre ishin dorëzuar të arsyetuara për periudhën Shkurt – Gusht 2023. Ndërkohë, nga 641 vendime të dhëna për çështje civile themeli në Shkurt – Korrik 2023, vetëm 321 ishin dorëzuar në fund të shtatorit 2023.



Gjykimi brenda një afati të arsyeshëm, krahasimi 2016-2022

Sipas përcaktimeve në nenin 399/2, për gjykimin civil në apel afat i arsyeshëm konsiderohet përfundimi i procesit brenda dy viteve, kurse gjykimi për krimet duhet të mbyllet në një afat kohor prej 1 viti dhe për kundërvajtjet brenda 6 muajsh.

Objekt vlerësimi në kuadër të këtij studimi janë vetëm çështjet e themelit (civile dhe penale), të cilat janë kategoria më voluminoze e vendimeve në apel. Vendimet për çështjet e themelit ishin rreth 47% e totalit të pergjithshëm të vendimarrjes në Gjykatën e Apelit Korçë për vitin 2022. Këto çështje janë gjithashtu më të prekura prej fenomeni i vonesave, krahasuar me tipologjitë e tjera të vendimeve (Tabela 6).

Masat e sigurimit, urdhrat e mbrojtjes, njehsimet apo rivendosjet në afat, preken pak ose aspak nga rreziku i daljes jashtë afateve të arsyeshme, për shkak të afatit ligjor të përshkruar në ligj, i cili nëse shkelet, mund të pasojë me penalitete për gjykatën duke filluar që me humbjen e fuqisë juridike të vendimit (masat e sigurisë) e deri në krijimin e kushteve për ankesë ndaj gjyqtarit në organin kompetent.

Tabela 6

VITI	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
CIVILE THEMELI	443	385	433	281	34	188	141
TOTAL VENDIME				6-mujori pare			
JASHTË AFATIT	3	3	7	2	0	18	50
TE ARSYESHEM							
Ne %	0.67%	0.77%	1.6%	0.7%	0%	9.5%	35%

VITI	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
PENALE THEMELI	277	318	263	104	73	110	117
TOTAL VENDIME				6-mujori pare			
JASHTË AFATIT	1	0	3	0	2	8	28
TE ARSYESHEM							
Ne %	0.36%	0%	1.14%	0%	2.7%	7.2%	23%

Si përfundim, për periudhën e krahasuar 2016-2022, ka një përkeqësim të ndjeshëm të treguesve të matur nga INFOÇIP, dhe konkretisht:

35% e totalit të gjykimeve civile të themelit dolën jashtë afatit të arsyeshëm të gjykimit në vitin 2022 në Gj. Apelit Korçë (Tab.6). Para Reformës në Drejtësi, vetëm 0.67% e çështjeve civile të themelit në Gj. Apelit Korçë dilnin jashtë afatit 2-vjeçar të gjykimit.

Numri i gjykimeve penale të themelit që u mbyllën tej afatit të arsyeshëm në Gjykatën e Apelit Korçë u rriti progresivisht. Ai arriti arriti në 23% të totalit në vitin 2022, nga 0.3% që ishte ky tregues në vitin 2016.

Shifrat e raportuar nga INFOCIP për gjykimet penale që dolën jashtë afatit të gjykimit të arsyeshëm është më i vogël se në realitet, për shkak të mos diferencimit të krimeve nga kundravajtjes penale në gjykimin në apel (shih Metodologjia).

MASAT E SIGURIMIT, vlerësimi i kohëzgjatjes 2020-2021-2022 & krahasimi me treguesit e 6-mujorit të parë 2023 të GJ.A.J.P Tiranë

Ankimi kundër masave të sigurimit në apel duhet të shqyrtohet **brenda 10 ditëve** nga marrja në dorëzim e akteve (paragrafi 6, neni 249, KPrP), ndërkohë që vendimi i arsyetuar duhet të depozitohet **brenda 10 ditëve** (paragrafi 7, neni 249, KPrP). Kur vendimi nuk shpallet ose nuk zbatohet brenda afatit të caktuar, akti në bazë të të cilit është marrë masa shtrënguese e humbet fuqinë (paragrafi 8, neni 249, KPrP).⁵

Masat e sigurimit përfaqësojnë kategorinë me numrin më të lartë të vendimeve në Gjykatën e Apelit Korçë gjatë 3-vjeçarit 2020-2023. Nga të dhënat e analizuar nga INFOÇIP rezultoi se kohëzgjatja mesatare për shqyrtimin e ankimeve në Gjykatën e Apelit Korçë ndaj masave të sigurimit nuk e kapërcen afatin ligjor 10-ditor. Megjithatë, nëse analizohen veç e veç, vihet re se një numër i konsiderueshëm vendimesh të këtij lloji janë dhënë në tejkalim të afatit ligjor (kolona 5 në Tabelën 6).

Me probleme domethënëse paraqiten afatet e arsyetimit /dorëzimit të vendimit. Treguesi i mesatarizuar i ditëve që janë nevojitur për të arsyetuar dhe dorëzuar një vendim masë sigurie në gjykatën e Apelit Korçë, për të treja vitet e marra në analizë 2020-2023, është tejkaluar nga 5 deri në 8 herë (kolona 4, Tabela. 6). Ndërkohë, shumica dërrmuese e vendimeve dalën jashtë afatit ligjor 10 ditor të dorëzimit (paragrafi 7, neni 249, KPrP), sikurse ilustron në kolonën 6, Tab. 6.

Tabela 6

Viti	Vendime masa sigurimi gjithsej	Mesatare e shqyrtimit (ditë)	Mesatare e dorëzimit (ditë)	Total vendime tej afatit ligjor 10-ditor të shqyrtimit	Total vendime tej afatit ligjor 10-ditor të dorëzimit
2020	240	7.5	52.5	40 (28.5%)	191 (79.5%)
2021	278	9.2	85.5	45 (15.6%)	264 (94.9%)
2022	238	8.9	59.7	55 (23.1%)	218 (91.5%)
2023	1000	10.5	34.1	88 (8.8)	755 (75.5%)

INFOCIP analizoi 1000 vendime për masa sigurimi të dhëna në periudhëm 1 Shkurt-4 Korrik nga GJAJ.P Tiranë, në të cilën u shkri Gjykata e Apelit Korçë. Me përjashtim të treguesit të mesatares në shqyrtim, treguesit e tjerë kanë pësuar **përmirësim**.

Tabelat verifikuese me të dhënat gjyqësore për vendimet e GJ. Apelit Korçë për ankimet ndaj masave të sigurimit mund të hulumtohen në Platformën www.gjykataehapur.al sipas viteve, në linket me poshtë:

Viti 2023: <https://www.gjykataehapur.al/masa-sigurimi-viti-2023-gjykata-e-apelit-i-p-tirane-me-kontrast-10-ditor-6-mujori-pare/>

Viti 2022: <https://www.gjykataehapur.al/masa-sigurimi-viti-2022-gjykata-e-apelit-korce/>

Viti 2021: <https://www.gjykataehapur.al/masa-sigurimi-viti-2021-gjykata-e-apelit-korce/>

Viti 2020: <https://www.gjykataehapur.al/masa-sigurimi-viti-2020-gjykata-e-apelit-korce/>

⁵ Mbetet e paqartë se si do duhet të trajtohet kjo problematikë e hasur në GJ. Apelit Korçë, sa i takon vlefshmërinë ligjore të shumicës dërrmuese të vendimeve ndaj ankimeve për masat e sigurimit. Gjykata Kushtetuese ka theksuar domosdoshmerine e arsyetimit të vendimeve gjyqësore, penale apo civile, si një garanci për procesin ligjor. Mungesa e pjesës së arsyetuar të vendimit çënon integritetin dhe ligjshmerine e vetë procesit/vendimit gjyqësor. Po ashtu, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin nr. 5, date 12.12.2013, kanë elaboruar rrethanat në të cilat vonesat në arsyetimin e vendimit gjyqësor passjellin pergjegjesi disiplinore për gjyqtarin.

URDHRAT E MBROJTJES, vlerësimi i kohëzgjatjes 2020-2021-2022 & krahasimi me treguesit e 6-mujorit të parë 2023 të GJ.A.J.P Tiranë

INFOÇIP analizoi për herë të parë kohëzgjatjen e shqyrtimit të urdhrave të mbrojtjes në Gj. Apelit Korçë për periudhën 2020-2022. Të dhënat e analizuara shërbejnë si *baseline* krahasimi me të dhënat e mbledhura në GJAJ P Tiranë (6-mujori i parë 2023), me synim vlerësimin e trendit në kuadër të Reformës së Rretheve Gjyqësore.

Ligji nr.9669, datë 18.12.2006 “Per masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, parashikon në nenin 21 të tij se Gjykata e Apelit shprehet me vendim brenda 15 ditëve nga dita e regjistrimit të ankimit ndaj urdhrit të mbrojtjes.

Viti	Vendime apel U. Mbrojtje gjithsej	Mesatare (dite) shqyrtimi U.Mbrojtje	Mesatare dorëzimi (ditë) U. Mbrojtje	Total vendime tej afatit 15-ditor të shqyrtimit
2020	9	23	32.6	3 (33.3%)
2021	7	16.8	79.8	3 (42.8%)
2022	5	32	67	4 (80%)
2023	113	31.7	51 ⁶	70 (61.9%)

Pavarësisht numrit të vogël të vendimeve për urdhra mbrojtje në Gjykatën e Apelit Korçë (2020-2022), vihet re ato janë shqyrtuar tej afatit ligjor 15 ditor. Përkeqësim domethënës kishte në vitin 2022, gjatë të cilit vetëm një vendim (nr 3, dt 06.07.2022) është marrë brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga regjistrimi në gjykatë i ankimit.

Përkeqësim domethënës pësoi edhe treguesi i mesatares në dorëzim, ku koha është mbi-dyfishuar krahasuar viti 2020 me 2021 dhe 2022.

INFOCIP analizoi 113 vendime për masa sigurimi të dhëna gjithësej në periudhën 1 Shkurt-4 Korrik nga GJAJ P Tiranë, në të cilën u shkri Gjykata e Apelit Korçë. **Treguesi i mesatares në shqyrtim është pothuajse i njëjtë me vitin 2022, por ndërkohë vihet re një ulje sa i takon kohës mesatare të dorëzimit të vendimit.**

Tabelat verifikuese me të dhënat gjyqësore për vendimet e GJ. Apelit Korçë për ankimet ndaj urdhrave të mbrojtjes mund të hulumtohen në Platformën www.gjykataehapur.al sipas viteve, në linket me poshtë:

Viti	Link në www.gjykataehapur.al
2023	https://www.gjykataehapur.al/urdher-mbrojtje-gjykata-e-apelit-te-juridiksionit-te-pergjithshem-tirane-viti-2023-6-mujori-i-pare-shqyrtimi-dorezimi-respektimi-i-afatit-ligjor/
2022	https://www.gjykataehapur.al/urdher-mbrojtje-gjykata-e-apelit-korce-viti-2022/
2021	https://www.gjykataehapur.al/urdher-mbrojtje-gjykata-e-apelit-korce-viti-2021/
2020	https://www.gjykataehapur.al/urdher-mbrojtje-gjykata-e-apelit-korce-viti-2020-kohezgjitja-ne-shqyrtim/

⁶ Mesatarja i referohet vetëm 75 vendimeve nga 113 gjithsej; per 38 vendime ende nuk ishte pasqyruar në numerator data e dorëzimit të tyre në sekretarinë e gjykatës deri në fund të muajit gusht kur janë grumbulluar këto të dhëna nga INFOÇIP.

METODOLOGJIA

Metodologjia e hartuar dhe e përdorur nga INFOÇIP për këtë lloj vlerësimi tematik konsiston në mbledhjen sistematike të të dhënave gjyqësore. Këto të dhëna konsistojnë kryesisht në datën e regjistrimit të çështjes gjyqësore civile apo penale në gjykatë, datën e marrjes së vendimit, trupit gjykues respektiv, dispozitivin e vendimit, datës dorëzimit në sekretarinë gjyqësore të vendimit përfundimtar të arsyetuar (dosjes gjyqësore pas mbylljes së shqyrtimit gjyqësor).

Të dhënat mblidhen direkt nga gjykata nga monitories të trajnuar nga INFOÇIP për përdorimin e protokollit të vlerësimit tematik. Ato përpunohen më pas në një sistem kompjuterik të avancuar. INFOÇIP i proceson të dhënat në databaza online të cilat janë dizenuar sipas specifikës së gjykatave shqiptare. Që prej vitit 2017, produkti përfundimtar bëhet i shfletueshëm në Platformën Kombëtar GJYKATAEHAPUR.AL

Metoda e vlerësimit që ka hartuar INFOÇIP analizon të gjitha vendimet një për një, siç janë të regjistruara në varg indeksues të rregullt në numratorët e posaçëm të çështjeve gjyqësore që administrohen nga kancelarët apo sekretarët e gjykatave. Metoda e INFOÇIP nuk proceson një numër të reduktuar çështjes (30-40) të zgjedhura me kampionim, por të gjitha vendimet gjyqësore të dorëzuar në një kohë të dhënë.

Proceset analizuese mundësohen nga digitalizimi i të dhënave, kombinuar me kontrollin e plotë manual të çdo të dhëne nga ekipet e specializuara të monitoruesve. Konsistenca e të dhënave konfirmohet nga dy ekipe supervisorësh të pavarur si dhe nga stafet administrative të vetë gjykatave. Kontrolli i trefishtë është garanci për saktësi të dhënave gjyqësore që i nështrohen përpunimit. Marzhi i gabimit pas kontrollit të trefishtë është 3%.

Për të realizuar efektivisht vlerësimet tematike të kohëzgjatjes së shqyrtimit gjyqësor bëhet më parë identifikimi i saktë i dispozitave në kode dhe ligje që përcaktojnë afatet e shqyrtimit, afatet e gjykimit të arsyeshme, afatet e arsyetimit/ dorëzimit të vendimeve gjyqësore. Legjitimiteti i matjeve dhe vlerësimeve në kuadër të këtij monitorimi buron vetëm nga ligji procedural si dhe nga praktika e konsoliduar gjyqësore.

Në Platformën Kombëtare GJYKATAEHAPUR.AL gjendet një seksion i veçantë në të cilin janë të renditura/publikuara online të gjitha ligjet materiale dhe procedurale në të cilat bazohet funksionimi i sistemit gjyqësor pas Reformës në Drejtësi.

Treguesi KSHGJ (Kohëzgjatja e Shqyrtimit Gjyqësor) është një indikator i posaçëm i konceptuar nga ekspertët e INFOÇIP posaçërisht për këtë lloj vlerësimi tematik. Ai pasqyrohet në vlerë diferenciale ose në pikë përqindje sipas rastit. Përqindja përdoret në rastete kur vetë ligji procedural cakton afat të fiksuar për gjykatën sa i takon shqyrtimit gjyqësor apo arsyetimit/dorëzimit të vendimit.

“KSHGJ vertikal” përlllogaritet si funksion i diferencës midis së treguesve të vitit aktual dhe vitit paraardhës për vlerat që kanë të bëjnë kohën e shpenzuar nga gjykata për të dhënë vendim mbi një çështje gjyqësore që nga momenti i regjistrimit në gjykatë. “KSHGJ horizontal” aplikohet për të indikuar diferencat kur objekt krahasimi janë gjykata të ndryshme brenda të njëjtit vit.

Treguesi DAV (Dorëzimi në Afat i Vendimeve) është një indikator i posaçëm i konceptuar nga INFOÇIP posaçërisht për këtë lloj vlerësimi tematik. DAV pasqyrohet në pikë përqindje. Kur ligji procedural nuk ka afat eksplisit të përcaktuar, DAV mund të paraqitet si vlerë numerike e krahasuar.

DAV përdoret për të matur progresin vit pas viti, në kushtet kur krijohet një bazë fillestare me të dhëna të krahasueshme (baseline). Në këtë rast ai indekskohet si “DAV vertikal”, për ta dalluar atë nga “DAV horizontal”, i cili aplikohet për të indikuar diferencat kur objekt krahasimi janë gjykata të ndryshme brenda të njëjtit vit. DAV është një indikator absolut. Ai nuk relativizon apo ponderon rezultatin bazuar në ngarkesën e gjyqtarëve, vështirësinë e çështjeve apo shkaqe të tjera subjektive.

Vlerësimet tematike që realizon INFOÇIP synojnë të ofrojnë një skanim të plotë të situatës së efektshmërisë së gjykatave/gjyqtarëve, për kuptuar më mirë dinamikat që favorizojnë (ose jo) shqyrtimin e çështjeve gjyqësore (themeli) brenda një kohë të arsyeshme si dhe dorëzimin në afat të vendimeve. Në një rast të tillë, treguesit KSHGJ dhe DAV aplikohen për të krijuar uniformitet dhe bazë të njëjtë krahasueshmërie.

Në thelb, analiza synon të rendisë bazuar në vlerat e treguesve gjykatat e të njëjtit lloj të marra nën shqyrtim. Po ashtu kjo analizë ofron mundësi për të bërë përgjithësime në bllok. Për të aplikuar analizën KSHGJ/DAV vertikal, është e nevojshme të fiksohet një baseline i bashkë-matshëm kohor. Kjo do të thotë se të dhënat që krahasohen nga viti në viti duhet të jenë të mbledhura brenda të njëjtës periudhë kohorë për të siguruar bazë krahasimore të njëjtë. Kjo analiza synon të indikojë progresin/regresin apo stanjacionin midis dy viteve të ndryshme.

Nga vitit 2017, të gjitha të dhënat e analizuara nga INFOÇIP janë të shfletueshme online, të organizuara në format open-data në Platformën Kombëtare www.gjykataehapur.al. Sistemi është konceptuar dhe ndërtuar nga INFOÇIP dhe përfaqëson një moment kulmor të përdorimit të teknologjive të informacionit në fushën e vlerësimeve tematike në sistemin gjyqësor të RSH.

Aktualisht, të gjitha evidencat e vlerësimeve tematike mbi performacën e gjykatave janë të rigrupuara online në formate tabelore, me funksione të avancuara kërkimi

dhe filtrimi. Sistemi GJYKATAEHAPUR.AL përfaqëson një kapërcim teknologjik të rëndësishëm që e vendos monitorimin e performancës gjyqësore në një terren plotësisht të automatizuar dhe të aksesueshëm online në çdo kohë.

Metodologjia e dizenuar nga INFOÇIP, e kombinuar me fuqinë procesuese të teknologjisë dixhitale analizon gjithashtu edhe të dhënat e performancës profesionale të gjyqtarëve përmes raporteve nominale të vlerësimit. Të dhënat procesohen përmes funksioneve të programuara nga një *softëare* i posaçëm.

Për efekt të një vlerësimi tematik INFOÇIP mund të procesojë deri 4 milion të dhëna gjyqësore përmes teknologjisë dixhitale dhe kompjuterike. Përpunimi i tyre do të ishte i pamundur jashtë kushteve që tashmë janë siguruar në kuadër të Programit **Open Court**.

Sistemi Open Court përllogarit apo realizon edhe analiza të posaçme të performancës gjyqësore bazuar në objektin e dosjes gjyqësore. Në vitin 2017 INFOÇIP analizoi për herë të parë në terma të kohëzgjatjes së shqyrtimit gjyqësor çështjet gjyqësore administrative me objekt “ndërrprerjen e marrëdhënieve të punës”.

Metodologjia e vlerësimeve tematike të pavaruara është konceptuar nga INFOÇIP. Gjetjet që ajo ka prodhuar në 9 vitet e fundit janë pranuar gjerësisht nga trupa gjyqësore. Ky është tregues i efikasitetit të saj. Të dhënat mbi të cilat bazohet vlerësimi janë 100% të verifikueshme përmes regjistrave të gjykatës, sistemeve kompjuterike të administruara nga vetë gjykatat si dhe përmes sistemeve kombëtare kompjuterike ku administrohen të dhëna gjyqësore.



MBI PLATFORMËN ONLINE “GJYKATA E HAPUR”

Platforma <http://www.gjykataehapur.al> mundëson vlerësimet tematike të vonesave gjyqësore përmes filtrave dhe algoritmeve të dizenuara për këtë qëllim nga INFOCIP. Vlerësimi i vonesave është i bazuar 100% në të dhëna të faktueshme dhe rrjedhimisht objektiv.

Platforma www.gjykataehapur.al përfaqëson të vetmin sistem të automatizuar në RSh që mundëson vlerësimin sistematik të kohëzgjatjes dhe vonesave eventuale në arsyetimin dhe dorëzimin e vendimeve gjyqësore.

Platforma www.gjykataehapur.al është një sistem informativ online, i hapur për publikun, gjykatat, median dhe gjithë partnerët institucionalë të interesuar. Aktualisht Platforma administron dhe përpunon mbi 9.5 milion të dhëna gjyqësore, të cilat janë në shtim të vazhdueshëm.

Platforma www.gjykataehapur.al është pasuruar me të dhëna gjyqësore nga gjykatat e sistemit të zakonshëm, duke përfshirë fillimisht gjykatat e karrierës në shkallë të parë dhe në shkallë të dytë dhe duke u zgjeruar gradualisht në të gjitha gjykatat e rretheve gjyqësore të RSH.

Ambasada e SHBA në Tiranë përmes Programit të Granteve të Vogla ka mbështetur INFOCIP për të realizuar popullimin e Platformës me të dhëna të reja për gjykatat e apelit në Vlorë, Shkodër dhe Tiranë. Edhe gjykatat e shkallës së parë në këto rrethe janë monitoruar gjithashtu dhe të dhënat e tyre janë pasqyruar në www.gjykataehapur.al për vitet 2016-2019.

Funksione të reja janë duke u projektuar dhe shtuar nga stafet e INFOCIP, të cilat mundësojnë vlerësime tematike speciale. Konkretisht ka përfunduar dhe është operacional online sistemi i ri i vlerësimit tematik për çështjet gjyqësore administrative me objekt “marrdhëniet e punës”, ku për herë të parë është testuar me sukses edhe afishim i skedave gjyqësore si dhe përlllogaritja e dëmit ekonomik.



**JURISPRUDENCE NGA
GJYKATA EUROPIANE E TE DREJTAVE TE
NJERIUT, STRASBOURG
dhe
GJYKATA E LARTE E RSH**

SEKSIONI I TRETË

ÇËSHTJA BARA DHE KOLA KUNDËR SHQIPËRISË

(Kërkesat nr. 43391/18 dhe 17766/19)

VENDIM

Neni 6 § 1 (civil dhe penal) – Kohëzgjatje e paarsyeshme e procedurave – Vonesa të gjata në Gjykatën e Lartë, të cilat janë të papranueshme, pavarësisht kontekstit të reformës së thellë në sistemin e drejtësisë, neni 13 (+ neni 6§1) – Zgjidhje efektive – Zgjidhje e re përshpejtuese/parandaluese dhe kompensuese në çështjet që kanë të bëjnë me kohëzgjatjen e procedurave, e cila edhe pse është efektive në parim dhe në përgjithësi në praktikë, nuk është efektive në rrethanat e posaçme të çështjes.

STRASBURG

12 tetor 2021

PËRFUNDIMTAR

28.2.2022

Ky vendim është bërë përfundimtar, sipas nenit 44§2 të Konventës. Ai mund të bëhet objekt i rishikimit redaktues.

Në çështjen Bara dhe Kola kundër Shqipërisë

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë) e mbledhur si Dhomë, e përbërë nga:

Paul Lemmens, *kryetar*,

Georgios A. Serghides,

Dmitry Dedov,

Georges Ravarani,

Darian Pavli,

Anja Seibert-Fohr,

Peeter Roosma, *gjyqtarë*,dhe Milan Blaško, *regjistrar i Seksionit*,

duke marrë në konsideratë:

kërkesat (nr. 43391/18 dhe 17766/19) kundër Republikës së Shqipërisë paraqitur në Gjykatë, sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (“Konventa”) nga dy shtetas shqiptarë, z. Petrit Bara (“kërkuesi i parë”) dhe z. Eduard Kola (“kërkuesi i dytë”), më 4 shtator 2018 dhe 27 mars 2019, respektivisht;

vendimin për të njoftuar Qeverinë Shqiptare (“Qeverinë”), në lidhje me ankimet për kohëzgjatje të tepërt të procedurave, për procedurat e padrejta ndaj kërkuessit të dytë dhe mungesën e një zgjidhjeje efektive, në lidhje me ankesat për kohëzgjatjen e procedurave;

vërejtjet e palëve;

pasi diskutoi me dyer të mbyllura më 7 shtator 2021,

shpall vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua në po atë datë.

HYRJE

1. Çështja ka të bëjë me pretendimin për kohëzgjatje të tepërt të procedurave administrative dhe penale, si edhe me efikasitetin e një zgjidhjeje të re të paraqitur në vitin 2017 mbi kohëzgjatjen e tepërt të procedurave.

FAKTET

I. RRETHANAT E ÇËSHTJEVE

2. Kërkuessi i parë ka lindur në vitin 1953 dhe jeton në Tiranë. Ai u përfaqësua përpara Gjykatës nga znj. B. Bara dhe më pas nga z. J. Bara, një avokat i cili e ushtron profesionin e tij në Tiranë.

3. Kërkuessi i dytë ka lindur në vitin 1986 dhe aktualisht po vuan një dënim me burgim në Shqipëri. Ai u përfaqësua përpara Gjykatës nga z. A. Doda, një avokat i cili e ushtron profesionin e tij në Tiranë.

4. Qeveria u përfaqësua nga agjenti i saj në atë periudhë, z. A. Metani, dhe më pas nga znj. E. Muçaj nga Zyra e Avokaturës së Shtetit.

5. Faktet e çështjeve, sipas parashtrimeve të palëve, mund të përmbliidhen, si më poshtë.

A. Kërkesa nr. 43391/18, *Bara kundër Shqipërisë*

6. Kërkuessi i parë është një doktor dhe profesor i mjekësisë në Universitetin Shtetëror të Mjekësisë, Tiranë (“UMT”).

7. Pas zgjedhjeve për pozicionin e rektorit në UMT, ku kërkuessi i parë ishte njëri prej tre kandidatëve, të cilët kandiduan për këtë pozicion (shih paragrafët 47 dhe 48 në vijim), më datë 23 prill 2016, Komisioni Institucional Zgjedhor (“Komisioni Zgjedhor” – shih paragrafin 48 në vijim) njoftoi rezultatet paraprake të zgjedhjeve, sipas të cilave kërkuessi i parë kishte marrë 36.3% të votave, dhe dy kandidatët e tjerë 38.3% dhe 25.4%. Në po të njëjtën datë, me pretendimin për një sërë parregullsish gjatë procesit të zgjedhjeve, kërkuessi i parë bëri një ankim administrativ, i cili u rrëzua nga Komisioni Zgjedhor më 24 prill 2016.

8. Më 29 prill 2016, Komisioni i Apelit, një organ tjetër administrativ i UMT-së, e rrëzoi ankimin administrativ të kërkuessit të parë. Në po të njëjtën datë, Komisioni Zgjedhor konfirmoi se fituesi i zgjedhjeve ishte kandidati i cili kishte marrë 38.3% të votave.

9. Pasi kishte shteruar mjetet administrative në dispozicion, më 3 maj 2016, kërkuessi i parë paraqiti një ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë,

Tiranë, ku kërkonte mosnjohjen e zgjedhjeve.

10. Më 3 korrik 2016, Gjykata Administrative, Tiranë, e rrëzoi ankimin. Më 29 shtator 2016, Gjykata Administrative e Apelit e la në fuqi atë vendim, duke dalë në përfundimin se kontestimi i ankuesit të parë për saktësinë e listës së votuesve ishte i papranueshëm, për shkak se lista ishte publikuar përpara zgjedhjeve dhe asnjë kontestim nuk ishte paraqitur në atë periudhë. Për sa i përket mospërputhjes midis kodeve të sigurisë në një kuti votimi dhe kodeve që rezultojnë në të dhënat zyrtare, gjykata vendosi se kjo ishte si rezultat i një gabimi njerëzor. Në fund, gjykata konstatoi se duke qenë se tetë votat e pavlefshme, për të cilat ishte ankuar kërkuesi i parë ishin hedhur në favor të kundërshtarit të tij, ai nuk kishte asnjë interes ligjor që të kërkonte zhvlefësimin e tyre nga Komisioni.

11. Më 27 tetor 2016, kërkuesi i parë paraqiti një ankim kasacioni në Gjykatën e Lartë, duke argumentuar se gjykatat më të ulëta kishin gabuar në zbatimin e parashikimeve statutores përkatëse.

12. Më 4 maj 2017, 26 shkurt dhe 5 korrik 2018, kërkuesi i parë i kërkoi Gjykatës së Lartë përshpejtimin e procedurave, në lidhje me shqyrtimin e ankimit të tij.

13. Më 4 maj 2018, kërkuesi i parë paraqiti një kërkesë në Gjykatën e Lartë, në mbështetje të neneve 399/1 e në vijim të Kodit të Procedurës Civile (“KPC”), duke i kërkuar gjykatës konstatimin e një shkeljeje të së drejtës së tij për t’u dëgjuar brenda një afati të arsyeshëm kohor.

14. Më 24 shkurt 2021, Gjykata e Lartë shqyrtoi ankimin e kasacionit të kërkuesit të parë dhe, pasi identifikoi një sërë mangësish në procedurat e Gjykatës Administrative të Apelit, e ktheu çështjen për një gjykim të ri nga një tjetër trupë gjyqësore në atë gjykatë. Nën këto rrethana, aktualisht çështja është pezull në Gjykatën Administrative të Apelit.

15. Sipas faqes së internetit të Gjykatës së Lartë rezulton, se më 13 korrik 2021, Gjykata e Lartë ka vendosur ta ndërpresë shqyrtimin e kërkesës së kërkuesit të parë, në mbështetje të neneve 399/1 e në vijim të KPC-së, duke konstatuar se çështja nuk ishte në mënyrë përjashtimore komplekse, dhe se kishte pasur një vonesë prej një viti e gjashtë muajsh, duke nisur nga data kur dosja e çështjes ishte regjistruar në gjykatë dhe deri në datën kur kërkuesi i parë kishte paraqitur kërkesën e tij në mbështetje të neneve 399/1 e në vijim të KPC-së. Gjykata e Lartë ia atribuoi vonesën reformës në sistemin e drejtësisë (shih paragrafin 24 në vijim), dhe u shpreh se çdo vonesë e vogël e shkaktuar nga kjo reformë nuk ishte e shpërpjesëtimuar, nëse krahasohej me përfitimet e reformës. Në vijim, gjykata argumentoi, se, sipas nenit 399/2 të KPC-së, vonesat e shkaktuara nga një situatë në të cilën ishte objektivisht e pamundur që të procedohej me çështjen nuk duhej të merreshin në konsideratë në përcaktimin e kohëzgjatjes së procedurave. Duke qenë se Gjykata e Lartë kishte shqyrtuar ankimin e kasacionit të kërkuesit të parë dhe e kishte dërguar çështjen në Gjykatën Administrative të Apelit për një gjykim të ri, ajo vendosi t’i ndërpriste procedurat.

B. Kërkesa nr. 17766/19, Kola kundër Shqipërisë

16. Më 24 shtator 2011, një roje nate i një guroreje u gjet i vdekur në kabinën e cila ishte vendi ku ai qëndronte në atë punë.

17. Pas hetimeve të policisë, më 24 nëntor 2011, kërkuesi i dytë dhe një i bashkëpandehur u akuzuan për vrasje me paramendim dhe mbajtje pa leje të armëve të gjuetisë dhe atyre sportive, në mbështetje të nenit 78§2 dhe nenit 280 të Kodit Penal.

18. Në 15 nëntor 2012, Gjykata e Rrethit Shkodër e dënoi kërkuesin e dytë me burgim të përjetshëm me akuzën për vrasje me paramendim. Akuza ndaj të bashkëpandehurit u riklasifikua dhe ai u dënua për pengim të drejtësisë duke u angazhuar në akte që kishin për qëllim të pengonin zbulimin e së vërtetës.

19. Pasi vendimi u la në fuqi në apel, më 1 mars 2016, Gjykata e Lartë e prishi vendimin me arsyetimin se i mungonte arsyetimi i mjaftueshëm. Ajo e dërgoi çështjen për rishqyrtim dhe urdhëroi, midis të tjerash, që të kryhej ekspertiza mbi armën që kishte hequr i bashkëpandehuri nga skena e krimit, në mënyrë që të verifikohet ekzistenca e ndonjë gjurme gishtash.

20. Më 23 mars 2017, Gjykata e Apelit Shkodër (“Gjykata e Apelit”) la në fuqi vendimin ndaj kërkuesit dhe e ndërpreu shqyrtimin e akuzës për mbajtje pa leje të armëve, sipas ligjit për amnistinë.

21. Më 27 mars 2017, kërkuesi i dytë paraqiti një ankim kasacioni në Gjykatën e Lartë.

22. Më 5 mars 2021, Gjykata e Lartë, e mbledhur në një trupë të përbërë nga tre gjyqtarë, e deklaroi të pranueshëm ankimin e kasacionit të kërkuesit të dytë. Nuk rezultoi që Gjykata e Lartë të ketë përcaktuar një datë për shqyrtimin e ankimit në themel.

C. Informacionet statistikore dhe të tjera për Gjykatën e Lartë

1. Informacione në lidhje me përbërjen e Gjykatës së Lartë

23. Deri në mars 2016, Gjykata e Lartë përbëhej nga shtatëmbëdhjetë gjyqtarë nga nëntëmbëdhjetë gjyqtarë që duhej të ishin në total. Nga muaji prill 2016 dhe deri në tetor 2017, shtatë gjyqtarë dhanë dorëheqjen dhe një u shpall fajtor për një vepër penale dhe u pushua.

24. Në vitin 2016, Shqipëria ndërmori reformat e gjera në sistemin e drejtësisë, të cilat sollën ndryshime në Kushtetutë dhe hyrjen në fuqi të një sërë statutesh të rëndësishme, në lidhje me, midis të tjerash, rivlerësimin e të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë (ndryshe i njohur si procesi i *vetting*-ut për gjyqtarët dhe prokurorët), organizimin e gjyqësorit, duke përfshirë organizimin e Gjykatës së Lartë dhe krijimin e organeve të reja qeverisëse në sistemin e drejtësisë (shih *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*, nr. 15227/19, §§ 4–7, 9 shkurt 2021).

25. Nga muaji korrik 2018 deri në maj 2019, si rezultat i procesit të *vetting*-ut të realizuar për gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, shtatë nga nëntë gjyqtarët e mbetur u pushuan nga detyra. Kështu, më 31 korrik deri më 11 dhjetor 2018, Gjykata e Lartë përbëhej nga katër gjyqtarë, të cilët mund të shqyrtonin lloje të caktuara të

ankimeve të kasacionit; nga data 12 dhjetor 2018 deri më 21 maj 2019, ajo përbëhej nga tre gjyqtarë; dhe nga data 22 maj 2019 deri më 18 mars 2020 Gjykatës së Lartë i mungonte kuorumi statutor prej tre gjyqtarësh për shqyrtimin e të gjithë ankimeve të kasacionit.

26. Vetëm dy gjyqtarë u konfirmuan në detyrë pas kalimit me sukses të procesit të *vetting*-ut. Në dhjetor 2018, njëri nga dy gjyqtarët e konfirmuar u zgjodh si përfaqësues në Këshillin e Lartë Gjyqësor – “KLGJ”), një organ i ri qeverisës përgjegjës për menaxhimin e gjyqësorit, kështu që mandati i tij në Gjykatën e Lartë u pezullua *ex lege*.

27. Që prej datës 30 korrik 2021, në Gjykatën e Lartë kanë ushtruar detyrën nëntë gjyqtarë nga totali i pretenduar prej nëntëmbëdhjetë gjyqtarësh.

2. Informacione në lidhje me *backlog*-un (çështjet e prapambetura) në Gjykatën e Lartë

28. Në fund të vitit 2012, në Gjykatën e Lartë ishin 9,961 çështje të prapambetura (*backlog*-u)¹, në fund të vitit 2014, çështjet e prapambetura kishin arritur në shifrën prej 11357 çështjesh², dhe në fund të vitit 2015, Gjykata e Lartë kishte 16777 çështje të prapambetura³.

29. Më 12 shkurt 2021, si përgjigje ndaj kërkesës së Gjykatës, Qeveria konfirmoi se numri i çështjeve të prapambetura (*backlog*-u) në Gjykatën e Lartë ishte 36609 çështje. Janë ndërmarrë një sërë masash për reduktimin e numrit të çështjeve të prapambetura (*backlog*-ut), si më poshtë:

Gjykata e Lartë ka vendosur të shqyrtojë çështjet më urgjente dhe ato më të vjetra; KLGJ-ja ka komanduar gjyqtarë dhe këshilltarë ligjorë të tjerë për të lehtësuar *backlog*-un në Gjykatën e Lartë, si edhe i janë shtuar burimet njerëzore, gjë e cila ka kontribuar në shqyrtimin paraprak të 22623 çështjeve.

II. KUADRI DHE PRAKTIKA LIGJORE PËRKATËSE

A. Ligji dhe praktika e brendshme

1. Organizimi dhe funksionimi i Gjykatës së Lartë

30. Neni 135 i Kushtetutës parashikon se Gjykata e Lartë është gjykata më e lartë në vend. Sipas nenit 136, anëtarët e kësaj gjykate shërbejnë për një mandat nëntëvjeçar pa të drejtë për rizgjedhjeje në detyrë.

31. Neni 31 në ligjin për pushtetin gjyqësor (ligji nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”) parashikon se Gjykata e Lartë i shqyrton ankimet e kasacionit në kolegjet civile, administrative dhe penale.

32. Në lidhje me ankimet penale të kasacionit, neni 14/a i Kodit të Procedurës Penale, hyrë në fuqi më 29 maj 2021, parashikon tre formacione të ndryshme në

1. Marrë nga një deklaratë për shtyp lëshuar nga Gjykata e Lartë më 21 mars 2013, e cila mund të aksesohet në: http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Kryetaria_eGjykates_se_Larte_Znj_Shpresa_Becaj_ka_mbledhur_diten_e_enjte_trupen_gjyqesore_te_Gjykates_se_Larte

2. Marrë nga një deklaratë për shtyp lëshuar nga Gjykata e Lartë më 18 shkurt 2015, e cila mund të aksesohet në: http://www.gjykataelarte.gov.al/web/NJOFTIM_P_R_2475_1_php

3. Progresraporti vjetor i Komisionit Evropian për Shqipërinë 2016 (SWD(2016) 364), faqe 60, i cili mund të gjendet në: https://ce.europa.eu/neighbourhoodenlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2016/20161109_report_albania.pdf

Gjykatën e Lartë: ajo shqyrton pranueshmërinë e ankimeve të kasacionit me dyer të mbyllura me një trupë prej tre gjyqtarësh, praktikën gjyqësore të harmonizuar dhe të zhvilluar në një trupë prej pesë gjyqtarësh dhe ato të shkëputura nga praktika gjyqësore e krijuar në një kolegji të përbashkët me të paktën dy të tretat e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë.

33. Në vendimin udhëheqës nr. 00-2020-473(4) të datës 22 dhjetor 2020, Gjykata e Lartë vendosi se me përjashtim të çështjeve që garantonin harmonizim dhe zhvillim të praktikës gjyqësore, një trupë me tre gjyqtarë do të shqyrtonte edhe themelin e ankimeve të pranueshme penale të kasacionit. Në këtë mënyrë, gjykata ndërpriste praktikën, sipas së cilës një trupë prej pesë gjyqtarësh shqyrtonte të gjitha ankimet penale të kasacionit në themel.

34. Në lidhje me ankimet administrative të kasacionit, neni 58 i ligjit për gjykatat administrative (ligji nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar), i cili ishte në fuqi në periudhën në fjalë, listonte shkaqet, sipas së cilave mund të paraqitej një ankim i tillë, më konkretisht: a) në rastin kur nuk ishte marrë në konsideratë, ishte keqinterpretuar ose ishte keqzbatuar ligji bazë ose, kur vendimi binte në kundërshtim me një vendim të mëparshëm të kolegjit ose kolegjit të përbashkët administrativ të Gjykatës së Lartë; b) kur kishte një shkelje të rëndë të rregullave procedurale, gjë e cila rezultonte në pavlefshmërinë e vendimit ose të procedurave gjyqësore; ose c) kur kishte një shkelje të rëndë procedurale që kishte ndikuar ndjeshëm në dhënien e vendimit. Sipas nenit 60, Gjykata e Lartë duhet të shqyrtojë ankimet administrative të kasacionit brenda 90 ditëve nga shpallja e vendimit.

2. Praktika gjyqësore e Gjykatës Kushtetuese, në lidhje me interpretimin e nenit 60 të ligjit për Gjykatat Administrative

35. Në vendimin nr. 26, të datës 27 mars 2017 (26/2017), Gjykata Kushtetuese konstatoi një shkelje të së drejtës së ankuesit për t’u dëgjuar brenda një afati të arsyeshëm, duke pasur në konsideratë faktin se procedurat në Gjykatën e Lartë kishin zgjatur pothuajse tre vjet (nga viti 2013 deri në vitin 2016), periudhë e cila shkon përtej afatit nëntëdhjetëditor të parashikuar në nenin 60 të ligjit për gjykatat administrative. Pa marrë një vendim në lidhje me shkeljen e konstatuar, gjykata u shpreh, midis të tjerash, se:

“... përderisa organi ligjvënës kishte përcaktuar afate kohore për gjykimin e procedurave administrative, kjo nënkuptonte se ai i kishte konsideruar ato si afate të arsyeshme për t’u zbatuar nga gjykatat administrative. Në lidhje me këtë aspekt, në respektim të ligjit, Gjykata e Lartë ka detyrimin, për shkak të rolit dhe pozicionit të saj, të kontrollojë zbatimin e ligjit të pavarur dhe procedural nga gjykatat më të ulëta ... *backlog*-u nuk përbën një arsye të vlefshme për të justifikuar mospërputhshmërinë me afatet kohore të parashikuara nga organi ligjvënës.”

36. Në vendimin nr. 3, të datës 6 shkurt 2018, Gjykata Kushtetuese shqyrtoi një ankesë kushtetuese, ku, midis të tjerash, argumentohej se kishte pasur një shkelje të së drejtës së ankuesit për t’u dëgjuar brenda një afati të arsyeshëm, duke qenë se procedurat në Gjykatën e Lartë kishin zgjatur për tre vjet (nga viti 2014 deri në vitin 2017). Gjykata Kushtetuese gjykoi se ankimi kushtetues, i cili ishte

paraqitur përpara hyrjes në fuqi të një zgjidhjeje të re, në lidhje me kohëzgjatjen e procedurave (shih paragrafin 37 më poshtë) kishte të bënte me kohëzgjatjen e procedurave administrative të përfunduara, për të cilat ankuesi nuk kishte asnjë zgjidhje efektive përveç se ankimin kushtetues. Gjykata Kushtetuese bëri të njëjtat konstatime, ashtu si edhe në vendimin e saj nr. 26/2017, edhe për kohëzgjatjen e procedurave administrative përpara Gjykatës së Lartë. Në lidhje me çështjen e shpërblimit, Gjykata Kushtetuese e orientoi ankuesin të bënte një kërkesë të veçantë pranë gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm.

3. Kohëzgjatja e procedurave

a) Ligji i brendshëm, në lidhje me zgjidhjen e re për kohëzgjatjen e procedimeve

37. Në zbatim të vendimit kryesues të Gjykatës, në çështjen *Luli dhe të Tjerët kundër Shqipërisë* (nr. 64480/09 dhe 5 të tjerë, 1 prill 2014), më 30 mars 2017, Shqipëria paraqiti një zgjidhje të re në Kodin e Procedurës Civile, në lidhje me kohëzgjatjen e paarsyeshme të procedurave, e cila hyri në fuqi më 5 nëntor 2017. Dispozitat përkatëse parashikonin, si më poshtë:

KREU X

GJYKIMI I KËRKESAVE PËR KONSTATIMIN E SHKELJES SË AFATIT TË ARSYESHËM, PËRSHPEJTIMIN E PROCEDURAVE DHE SHPËRBLIMIN E DËMIT

Neni 399/1

Objekti

Në kompetencë të gjykatave, sipas shkallëve të gjykimit të përcaktuar në këtë krye, hyjnë edhe shqyrtimi i kërkesave për shpërblimin e drejtë të personit që ka pësuar një dëm pasuror ose jopasuror, për shkak të kohëzgjatjes së paarsyeshme të çështjes, sipas përkufizimit të nenit 6/1 të [Konventës].

...

Neni 399/2

Afati i arsyeshëm

1. Afate të arsyeshme të përfundimit të hetimit, gjykimit apo ekzekutimit të një vendimi të formës së prerë, për qëllimet e përcaktuara në nenin 399/1, do të konsiderohen:

a) në gjykimin administrativ në shkallën e parë dhe në apel, përfundimi i gjykimit brenda një viti nga fillimi i tij në secilën shkallë;

b) në gjykimin civil në shkallë të parë përfundimi i procesit të gjykimit brenda dy viteve, në gjykim civil në apel brenda dy vjetëve; dhe gjykimin civil në Gjykatën e Lartë, brenda dy vjetëve;

c) në procedurën e ekzekutimit të një vendimi civil apo administrativ, me përjashtim të detyrimeve periodike ose të përcaktuara në kohë, afati njëvjeçar fillon nga dita e paraqitjes së kërkesës për vënie në ekzekutim;

ç) në hetimin e veprave penale afati maksimal i kohëzgjatjes së hetimeve, sipas Kodit të Procedurës Penale;

d) në gjykimin penal në shkallë të parë, afati i gjykimit të krimeve 2 vjet dhe i kundërvajtjeve 1 vit, në gjykimin në apel përfundimi i gjykimit për krimet në një afat kohor prej 1 viti dhe për kundërvajtjet 6 muaj dhe në Gjykatën e Lartë, përfundimi i gjykimit për krimet në një afat kohor prej 1 viti dhe për kundërvajtjet 6 muaj.

...

3. Në kohëzgjatjen e gjykimit ose të procedimit, nuk llogaritet koha kur çështja është pezulluar për shkaqe ligjore, kur është shtyrë për shkak të kërkesave të palës kërkuese, sipas këtij kreu, ose kur shfaqen rrethana të pamundësisë objektive për procedim.

Neni 399/6

Gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesës ose kërkesëpadisë

1. Kërkesa për konstatimin e shkeljes dhe përshpejtimin e procedurave i drejtohet gjykatës kompetente, sipas llojit të mosmarrëveshjes penale, civile ose administrative si më poshtë:

...

b) në rastet kur çështja në të cilën pretendohet të ketë shkelje, është duke u gjykuar në gjykatat e apelit, kërkesa shqyrtohet nga kolegji përkatës i Gjykatës së Lartë;

c) në rastet kur çështja në të cilën pretendohet të ketë shkelje, është duke u gjykuar në Gjykatën e Lartë, kërkesa shqyrtohet nga një kolegji tjetër i Gjykatës së Lartë;

...

2. Kur ka një vendim të formës së prerë për konstatimin e shkeljes dhe përshpejtimin e procedurës, subjekti kërkuar mund të paraqesë padi për shpërblimin e dëmit, sipas pikës 3 të këtij neni.

3. Kërkesëpadija për shpërblimin e dëmit i drejtohet gjykatës civile të shkallës së parë, ku ka qendrën organi ndaj të cilit është konstatuar shkelja. Padija parashkruhet brenda 6 muajve nga konstatimi i shkeljes me vendim të formës së prerë.

Neni 399/7

Gjykimi i kërkesës ose kërkesëpadisë

1. Gjykimi i kërkesëpadisë, sipas nenit 399/6, pika 3, bëhet sipas rregullave të

zakonshme të gjykimit brenda një afati 3-mujor nga depozitimi i kërkesëpadisë.

2. Gjykimi i kërkesës, sipas nenit 399/6, pika 1, bëhet në dhomë këshillimi dhe gjykata që shqyrton çështjen merr vendim brenda 45 ditëve, nga paraqitja e kërkesës. Brenda 15 ditëve nga paraqitja e kësaj kërkesë, organi që pretendohet se ka kryer shkeljen, i dërgon kopje të dosjes dhe mendimin me shkrim, gjykatës që shqyrton kërkesën.

3. Në rast se gjatë shqyrtimit të kërkesës organi që po kryen veprimet, ndërmerr hapat që po kërkohen nga pala, brenda 30 ditëve nga paraqitja e kërkesës [sipas nenit 399/6§1], pushon shqyrtimi i kërkesës.

Neni 399/8

Marrja e vendimit

1. Pas shqyrtimit të kërkesës gjykata vendos:

- a) pranimin e kërkesës, konstatimin e shkeljes dhe urdhërimin e ndërmarrjes brenda afateve të veprimeve të caktuara procedurale gjatë gjykimit ose ekzekutimit;
- b) rrëzimin e kërkesës.

2. Vendimi i gjykatës është përfundimtar dhe i formës së prerë.

Neni 399/9

Pranimi i kërkesës

1. Gjkata vendos pranimin e kërkesës, kur vërtetohet shkelja e afatit të arsyeshëm, sipas nenit 6/1, të Konventës Evropiane “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore”.

2. Në përcaktimin e shkeljes gjykata vlerëson kompleksitetin e çështjes, objektin e mosmarrëveshjes, të procedimit ose të gjykimit, sjelljen e palëve dhe të trupit gjykues gjatë gjykimit, ose të përmbauesit, si dhe të çdo personi tjetër të lidhur me çështjen.

Neni 399/10

Përmbajtja e vendimit për shpërblimin e dëmit

1. Pas shqyrtimit të kërkesëpadisë gjykata vendos shpërblimin e dëmit nga 50 000 lekë [EUR 400] deri në 100 000 lekë [EUR 800], për çdo vit ose muaj, në raport me vitin, përtej afatit të arsyeshëm [parashikuar në nenin 399/2].

2. Shpërblimi i dëmit bëhet duke mbajtur parasysh:

- a) vështirësinë e procesit, në të cilin është verifikuar shkelja;
- b) sjelljen e trupit gjykues ose përmbauesit dhe të palëve;
- c) natyrën e interesave në çështje;

ç) vlerën dhe rëndësinë e çështjes, në lidhje me objektin e mosmarrëveshjes ose të ekzekutimit, e vlerësuar edhe në raport me kushtet personale të palëve.”.

b) Praktika gjyqësore e brendshme në lidhje me zgjidhjen e re për kohëzgjatjen e procedurave

i. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese

38. Në vendimet e saj mbi pranueshmërinë nr. 269 dhe 270, të datës 7 dhjetor 2017, dhe nr. 49, të datës 22 shkurt 2018, Gjykata Kushtetuese, për sa i përket zgjidhjes së re, sipas neneve 399/1 e në vijim të KPC-së, e rrëzoi kërkesën e ankuesve për shqyrtim të ankimeve të tyre kushtetuese, në lidhje me kohëzgjatjen e procedurave, pasi ankuesit nuk e kishin shteruar zgjidhjen e re.

ii. Vendimet e Gjykatës së Lartë

39. Në lidhje me kërkesën e paraqitur, sipas nenit 399/6§1(b) të KPC-së, për sa i përket kohëzgjatjes së procedurave përpara gjykatave të apelit, Qeveria paraqiti një material të printuar me listën *online* të çështjeve në Gjykatën e Lartë, duke treguar se gjykata i kishte marrë këto kërkesa nga ankues të caktuar. Në vijim, Qeveria paraqiti shembuj të një sërë vendimeve të Gjykatës së Lartë. Në vendimin nr. 1, të datës 24 janar 2018, i cili u shpall një muaj dhe dy ditë, pasi u paraqit kërkesa, kolegji administrativ i Gjykatës së Lartë e pranoi kërkesën e pretenduesit dhe konstatoi një shkelje në “afatin e arsyeshëm” nga ana e gjykatës së apelit. Gjykata Administrative e Apelit u urdhërua të vijonte me procedimet, në përputhje me rregullat proceduralë të parashikuar në KPC.

40. Në vendimin nr. 5, të datës 17 prill 2018, i cili u mor një muaj dhe dymbëdhjetë ditë, pasi ishte paraqitur kërkesa, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë e pushoi shqyrtimin, sipas nenit 399/7§3 të KPC-së me argumentin se Gjykata Administrative e Apelit, tek e cila kishin mbetur procedurat pezull, kishte vendosur të shqyrtonte ankimin e pretenduesit në një seancë me dyer të hapura, më 12 prill 2018.

41. Në vendimin nr. 4/8, të datës 31 janar 2019, i cili u mor gjashtë muaj dhe katërmëdhjetë ditë, pasi ishte paraqitur kërkesa, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë e pranoi kërkesën e pretenduesit dhe konstatoi një shkelje të “afatit të arsyeshëm” nga ana e gjykatës së apelit. Gjykata Administrative e Apelit u urdhërua të planifikonte shqyrtimin e çështjes së pretenduesit sa më shpejt të ishte e mundur.

42. Në vendimin nr. 9, të datës 28 shkurt 2019, i cili u mor njëzet e një ditë pasi u paraqit kërkesa, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë e pushoi shqyrtimin në mbështetje të nenit 399/7§3 të KPC-së, për arsyen se gjykata e apelit, tek e cila procedimet ishin ende pezull, tashmë e kishte marrë një vendim për çështjen e pretenduesit.

43. Në lidhje, me kërkesën e paraqitur në mbështetje të nenit 399/6§1(c) të KPC-së, në lidhje me kohëzgjatjen e procedimeve përpara Gjykatës së Lartë, Qeveria paraqiti një kopje të vetme, një vendimi të Gjykatës së Lartë. Në vendimin nr. 7/13, të datës 15 shkurt 2019, i cili ishte marrë një muaj dhe nëntëmbëdhjetë ditë pasi ishte paraqitur kërkesa, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë e pushoi shqyrtimin e kërkesës, në mbështetje të nenit 399/7§3 të KPC-së, për arsye se ankimi në kasacion i ankuesit ishte pushuar nga Gjykata e Lartë, më 13 shkurt 2019.

44. Në lidhje me pretendimin për kompensim, në mbështetje të nenit 399/6§3 të KPC-së, Qeveria paraqiti kopje të tri vendimeve të brendshme. Në vendimin nr. 6853, të datës 27 korrik 2018, Gjykata e Rrethit Tiranë, teksa e njihte faktin se një vendim i Gjykatës Kushtetuese kishte njohur vonesën prej katërmëdhjetë vitesh në procedurat e zbatimit të vendimit, e njohu pjesërisht pretendimin për kompensim dhe i dha pretenduesit 700 000 ALL (rreth EUR 5,700) për vonesën. Gjatë shqyrtimit të kërkesës, gjykata vendosi se edhe pse kërkesa ishte paraqitur përpara hyrjes në fuqi të zgjidhjes së re, për analogji, ajo do t'u referohej parashikimeve statutore, në lidhje me zgjidhjen e re bë përcaktimin e shumës së kompensimit. Gjykata e rrëzoi kërkesën për përfitimin e interesit për pagesë të vonuar të borxhit të papaguar dhe deklaroi se vendimi ishte i apelueshëm.

45. Në vendimin nr. 11-2019-4385, të datës 25 korrik 2019, Gjykata e Rrethit Durrës, duke njohur faktin se një vendim i mëparshëm gjykate kishte njohur vonesën në procedura në një nivel të juridiksionit (prokuroria e rrethit), e pranoi pretendimin për kompensim dhe i dha kërkuarit 100 000 ALL (rreth EUR 800) për vonesën.

46. Në vendimin nr. 8016, të datës 25 nëntor 2019, Gjykata e Rrethit Tiranë njohu faktin se vendimi i Gjykatës së Lartë kishte pranuar vonesën prej pesëmbëdhjetë muajsh në procedura në një shkallë të juridiksionit (Gjykata Administrative e Apelit), e pranoi pretendimin për kompensim dhe i dha pretenduesit shumën prej 180 000 ALL (rreth 1400 EUR) për vonesën. Vendimi mund të apelohej.

4. Ligje të tjera të brendshme në lidhje me çështjen

47. Institucionet e arsimit të lartë, duke përfshirë zgjedhjen e rektorëve të tyre, veprojnë sipas ligjit për arsimin e lartë (ligji nr. 80/2015, i datës 22 korrik 2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimet Shkencore në Institucionet e Arsimit të Lartë”). Neni 39(1) parashikon se rektori është autoriteti më i lartë akademik i një institucioni të arsimit të lartë. Sipas nenit 39(2), rektori zgjidhet nga anëtarët e asambleve të stafit akademik të njësisë kryesore përbërëse (fakultetet) dhe nga studentët. Sipas nenit 39(3), rektori mban titullin “profesor” dhe mund të vijë nga brenda ose jashtë radhëve të stafit akademik. Kriteret e tjera përzgjedhëse për kandidatët, të cilët dëshirojnë të aplikojnë në pozicionin e rektorit të universitetit mund të parashikohen në statutin e një institucioni të caktuar të arsimit të lartë. Sipas nenit 39(7), rektori shërben për një mandat katërvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje edhe një herë.

48. Në përputhje me nenin 131 të ligjit për arsimin e lartë, Ministria e Arsimit miratoi një rregullore për organizimin e zgjedhjeve të para në organet drejtuese të institucioneve të arsimit të lartë. Rregulla 4§8 parashikonte se kandidati i suksesshëm për një pozicion ishte personi i cili kishte marrë shumicën e votave të vlefshme. Rregulla 6 bënte një parashikim për Komisionin Zgjedhor, i cili midis të tjerash, ishte përgjegjës edhe për organizimin dhe drejtimin e zgjedhjeve, për shpalljen e kandidatit fitues në pozicionin e rektorit të universitetit dhe shqyrtimin e ankesave të paraqitura nga kandidatët. Sipas rregullës 39, vendimet e Komisionit Zgjedhor mund të apelohehin në Komisionin e Apelit, vendimi i të cilit ishte i apelueshëm në gjykatat vendëse. Rregulla 20 parashikonte kriteret e përzgjedhjes për kandidatët, të cilët dëshironin të aplikonin për pozicionin e rektorit.

B. Materiali i Këshillit të Evropës

49. Pas hyrjes në fuqi të zgjidhjes së re, në lidhje me kohëzgjatjen e tepërt të procedurave (shih paragrafin 37 më sipër), në takimin e tij të 1377-të, të datës 4 qershor 2020, Komisioni i Ministrave (CM/Notes/1377/H46-1, Shënime për Agjendën) u shpreh si më poshtë, në lidhje me statusin e ekzekutimit të vendimit për çështjen *Luli dhe të tjerët kundër Shqipërisë*:

“Statusi i ekzekutimit

...

Masa të përgjithshme

...

3. Zhvillimet në lidhje me kohëzgjatjen e tepërt të procedurave gjyqësore:

- *Rritja e kohëzgjatjes mesatare të procedurave si rezultat i vetting-ut të gjyqtarëve*:

... autoritetet raportojnë një rritje të kohëzgjatjes mesatare të procedurave gjyqësore dhe një rritje në numrin e çështjeve të prapambetura (*backlog*) për periudhën 2017–2019. Ky trend negativ vjen si shkak i procesit të vetting-ut të nisur më 2017–ën dhe ende në vijim, sipas së cilit janë verifikuar kredencialet e gjyqtarëve të të gjitha niveleve [është hequr referenca].

Për pasojë, 60% e magjistratëve të kontrolluar ose janë pushuar nga detyra ose kanë dhënë dorëheqjen [është hequr referenca], duke përfshirë gjyqtarët në Gjykatën e Lartë dhe Gjykatën Kushtetuese (deri së fundmi, këto dy gjykata kishin vetëm nga një gjyqtar secila). Aktualisht, Gjykata e Lartë ka një *backlog* (çështje të prapambetura) me pothuajse 35000 çështje, një pjesë e të cilave është akumuluar në periudhën maj 2019 deri në mars 2020, periudhë gjatë së cilës ajo nuk mund të formonte një panel gjyqësor për të gjykuar çështjet.

Autoritetet nënvizojnë natyrën e jashtëzakonshme të kësaj situate; se ajo do të ketë pasoja që do të jenë vetëm afatshkurtra dhe se kjo situatë nuk mund t’u atribuohet veprimeve të papërshtatshme ose mosveprimeve nga ana e tyre ...

Gjykata e Lartë e krijuar rishtazi tashmë mund të gjykojë çështje me panele gjyqësore me tre gjyqtarë (numër që është i domosdoshëm për shumicën e çështjeve që trajtohen në këtë gjykatë), si rezultat i tre emërimeve të reja gjyqësore në mars të vitit 2020 ...

...

- *Plani i veprimit për reduktimin e backlog-ut në Gjykatën e Lartë*: Në muajin dhjetor 2019, u krijua një komision *ad hoc* me iniciativën e Këshillit të Lartë Gjyqësor, për propozimin e një plani veprimi për reduktimin e *backlog*-ut dhe rritjen e eficiencës së Gjykatës së Lartë. Ky komision tashmë ka propozuar masa konkrete në një memorandum.

...

4. Zhvillime në lidhje me zgjidhjen përshpejtuese dhe kompensuese:

- *Funksionimi dhe efienca e zgjidhjes*: Që prej muajit nëntor 2017, në Shqipëri ka funksionuar një zgjidhje e re përshpejtuese dhe kompensuese për kohëzgjatjen

e tepërt të procedurave gjyqësore. Ajo zbatohet për procedurat në të gjitha gjykatat penale, civile dhe administrative, për hetimet penale dhe procedurat e zbatimit të vendimeve. Ajo nuk zbatohet për procedurat në organet administrative, për të cilat autoritetet janë të mendimit se ka mjaftueshëm garanci legislative dhe, për shqyrtimin gjyqësor. Kërkesat për kompensim ose përshpejtim paraqiten në gjykatat e zakonshme ose në Gjykatën Kushtetuese, në varësi të juridiksionit.

Autoritetet raportojnë një rritje gjatë dy viteve të fundit, në përdorimin e zgjidhjes, por pranojnë se numri i kërkesave të paraqitura vijon të jetë i ulët. Statistikat tregojnë se vetëm një numër i vogël i kërkesave të paraqitura është pranuar nga gjykatat (për shembull: për vitin 2019, nga 40 kërkesa të paraqitura në Gjykatën e Lartë, 1 u pranua, 13 u pushuan dhe 26 janë ende pezull; nga 93 kërkesa të paraqitura në gjykatat e rrethit dhe të apelit, janë pranuar 19).”.

50. Pjesa përkatëse e vendimit të Komisionit të Ministrave i po së njëjtës datë (CM/Del/Dec(2020)1377/H46-1) parashikon, si më poshtë:

“Deputetët:

...

Në lidhje me masat e përgjithshme

5. Vunë re me shqetësim rritjen e kohëzgjatjes mesatare të procedurave gjyqësore dhe të *backlog*-ut të çështjeve gjatë tre vjetëve të fundit, si rezultat i krijimit të pozicioneve vakante gjyqësore për shkak të *vetting*-ut të gjyqtarëve, ku Gjykata e Lartë dhe Gjykata Kushtetuese u ndikuan në veçanti nga këto zhvillime dhe, për këtë arsye, nxitën autoritetet të vinin në zbatim të gjitha mjetet e mundshme për të garantuar se do të arrihej progres në emërimet gjyqësore, veçanërisht në Gjykatën e Lartë dhe në Gjykatën Kushtetuese, si edhe në reduktimin e *backlog*-ut të çështjeve në Gjykatën e Lartë.

...

7. Ndoqën me interes rritjen në përdorimin e zgjidhjes përshpejtuese dhe kompensuese për procedurat gjyqësore që ishin tejet të gjata, teksa vunë re se numri i kërkesave të paraqitura mbetet i ulët dhe vetëm një numër i vogël prej tyre janë pranuar nga gjykatat vendëse; ftuan autoritetet të jepnin informacione shtesë për shkaqet për rrëzimin e këtyre kërkesave dhe për masat e rritjes së ndërgjegjësimit për publikun e gjerë, në lidhje me ekzistencën dhe modalitetet e zgjidhjes;

8. Ftonin të informonin Komisionin, nëse parashikimi ligjor, i cili nuk lejon që kompensimi të kalojë vlerën e objektit të padisë, ka nevojë për ndryshime të tjera, në mënyrë që të jetë plotësisht operacional dhe në përputhje me Konventën, ose të japin shembuj nga praktika gjyqësore e brendshme ku të demonstrohet se ai po zbatohet konform Konventës; në vijim, i ftonë autoritetet të tregojnë se po konsolidohet praktika gjyqësore e brendshme që garantonte zgjidhje për procedurat gjyqësore të mbetura pezull, ashtu si edhe për vonesat që ekzistonin që përpara hyrjes në fuqi të zgjidhjes.”.

LIGJI

I. BASHKIMI I KËRKESAVE

51. Për sa i përket lëndës së ngjashme të kërkesave, Gjykata e gjen me vend që t'i shqyrtojë ato së bashku në një vendim të vetëm në mbështetje të Rregullës 42§1 të Rregullave të Gjykatës.

II. SHKELJE E PRETENDUAR E NENIT 6§1 TË KONVENTËS

52. Kërkuesit u ankuan se kohëzgjatja e procedurave, veçanërisht e atyre në Gjykatën e Lartë, ishte në shkelje me kërkesën për “afat të arsyeshëm”, sipas nenit 6§1 të Konventës. Në vijim, kërkuesi i dytë ankohej se procedurat gjyqësore nuk ishin të drejta dhe se vendimet e brendshme nuk ishin arsyetuar në mënyrën e duhur.

Neni 6§1 i Konventës parashikon si më poshtë:

“Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht ... brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij.”.

A. Sa i përket kërkesës nr. 43391/18, *Bara kundër Shqipërisë**1. Pranueshmëria*

53. Qeveria nuk e kundërshtoi zbatueshmërinë e nenit 6 të Konventës për procedurat administrative për të cilat ishte bërë kërkesa. Gjykata është e mendimit se përderisa Qeveria nuk e kundërshtoi zbatueshmërinë e Konventës, ajo duhet të ketë në konsideratë çështjen e mocionit të saj (shih *Blečić kundër Koracisë*, nr. 59532/00, §67, 29 korrik 2004; *Tănase kundër Moldavisë* [DHM], nr. 7/08, §131, GJEDNJ 2010; dhe *Studio Monitori dhe të tjerët kundër Gjeorgjisë*, nr. 44920/09 dhe 8942/10, §32, 30 janar 2020).

54. Gjykata thekson se garancitë e nenit 6§1 të Konventës zbatohen vetëm për “të drejtat dhe detyrimet civile”, të cilat duhet të njihen sipas ligjit të brendshëm, të paktën mbi arsye të diskutueshme. Për këtë arsye, në mënyrë që të përcaktohet nëse pjesa civile e nenit 6 është e zbatueshme në çështjen në fjalë, dhe për pasojë, nëse kërkuesi i parë mund të mbështetet në garancitë e atij neni, fillimisht Gjykata duhet të shqyrtojë nëse ai kishte një “të drejtë”, e cila mund të thuhet se njihet nga ligji vendës dhe, së dyti, nëse ajo e drejtë ishte një e drejtë “civile”. Mosmarrëveshja duhet të jetë e vërtetë dhe serioze; ajo mund të mos lidhet vetëm me ekzistencën aktuale të një të drejtë, por edhe me objektin dhe mënyrën e ushtrimit të saj; dhe së fundi, rezultati i procedurave duhet të jetë drejtpërdrejtë decisive për të drejtën në fjalë, por lidhjet e parëndësishme ose pasojat e largëta nuk mjaftojnë për t’iu adresuar nenit 6§1 (shih, midis autoriteteve të tjera, *Baka kundër Hungarisë* [DHM], nr. 20261/12, §100, 23 qershor 2016).

55. Gjithashtu, Gjykata thekson se as neni 6 dhe as ndonjë parashikim tjetër i Konventës apo i protokolleve të saj nuk garanton si të tillë një të drejtë për emërimin apo promovimin në shërbimin civil. Megjithatë, Gjykata ka pranuar se e drejta për një procedurë të ligjshme dhe të drejtë promovimi ose për pjesëmarrje të barabartë në një konkurs për një post publik mund të konsiderohen si të drejta të njohura në ligjin e brendshëm, të paktën aty ku gjykatat vendëse kanë njohur ekzistencën e

tyre dhe kanë shqyrtuar ankesat përkatëse të kërkuësve (shih, për shembull, *Regner kundër Republikës së Çekisë* [DHM], nr. 35289/11, § 105, 19 shtator 2017, dhe *Frezadou kundër Greqisë*, nr. 2683/12, §28, 8 nëntor 2018, dhe referencat e cituara në vijim).

56. Në lidhje me ekzistencën e një të drejte në çështjen konkrete, Gjykata vëren se ligji i brendshëm i ka dhënë kandidatëve të cilët përmbushnin kërkesat statutores të specifikuara në dispozitat përkatëse të drejtën të aplikojnë për pozicionin e rektorit të universitetit, të financuar në mënyrë publike. Gjithashtu, ligji i brendshëm parashikonte zgjidhje gjyqësore ndaj çdo parregullsie procedurale në zgjedhjet për pozicionin e rektorit të universitetit (shih paragrafët 47 dhe 48 më sipër). Si rezultat, kërkuesi i parë ishte njëri nga tre kandidatët të cilët përmbushnin kërkesat statutores të përzgjedhjes dhe kishte kualifikimet e nevojshme për të kandiduar për pozicionin e rektorit të universitetit, të financuar në mënyrë publike. Në zgjedhjet akademike, kërkuesi i parë u rendit i dyti. Në vijim, ai i kundërshtoi ligjshmërinë e zgjedhjeve dhe rezultatet përpara organeve administrative dhe gjykatave vendëse. Gjykata vëren se gjykatat nuk i rrëzuan ankimet e tij ndaj vendimeve administrative për arsyen e mosqëndrueshmërisë së një të drejte, por për shkakun se gjatë zgjedhjeve nuk kishte pasur parregullsi. Në këto rrethana, Gjykata gjykon se kërkuesi i parë mund të pretendojë të ketë të drejtën të marrë pjesë në një proces të ligjshëm dhe të drejtë zgjedhjesh akademike për pozicionin e rektorit të universitetit të financuar në mënyrë publike.

57. Në lidhje me natyrën civile të së drejtës, Gjykata gjykon se zgjedhjet dhe më pas emërimi në pozicionin e rektorit të universitetit, pa dyshim që ka të bëjë me ushtrimin e karrierës profesionale të një individi dhe, për pasojë, me interesat e tij apo të saj monetare. Gjithashtu, kërkuesi kishte pasur akses në gjykatat e brendshme për të kundërshtuar rezultatin e zgjedhjeve (shih, për shembull, *Vilho Eskelinen dhe të tjerët kundër Finlandës* [DHM], nr. 63235/00, §62, GJEDNJ 2007-II).

58. Së fundmi, Gjykata pranon se procedimet në fjalë ishin në mënyrë të drejtpërdrejtë decisive për të drejtat e kërkuësit për atë kohë sa procedurat mund të kishin përfunduar me anulimin dhe rimbajtjen e zgjedhjeve akademike, gjë e cila mund të kishte bërë që ai të zgjidhej në pozicionin e vlerësuar të rektorit të universitetit. Në lidhje me këtë rast, në çështjen *Tsanova-Gecheva kundër Bullgarisë* (nr. 43800/12, §84, 15 shtator 2015) Gjykata vendosi se procedurat ishin decisive për të drejtën e kërkuësit për një procedurë të ligjshme dhe të drejtë për atë kohë sa ato mund të kishin përfunduar në anulimin e procedurës së kundërshtuar dhe në organizimin e një konkursi të ri për postin, në rast se gjykatat vendëse do të kishin lejuar ankimin e kërkuësit (shih edhe *Dzhidzheva-Trendafilova kundër Bullgarisë* (vendim), nr. 12628/09, §43, 9 tetor 2012).

59. Në lidhje me sa më sipër, Gjykata vendos, se neni 6 i Konventës, sipas pjesës së tij civile, është i zbatueshëm në çështjen konkrete.

60. Gjithashtu, Gjykata, duke vërejtur se ankimi, në lidhje me kohëzgjatjen e procedurave nuk është as i pambështetur në fakte dhe as i papranueshëm për shkaqe të tjera të listuara në nenin 35 të Konventës, e deklaroi atë të pranueshëm.

2. Meritat

61. Kërkuesi i parë pretendonte se ishte shkelur kërkesa për “afat të arsyeshëm”, sipas nenit 6§1 të Konventës, duke iu referuar vonesës shkaktuar nga Gjykata e Lartë në shqyrtimin e ankimit të tij të kasacionit. Ai theksoi se më 27 tetor 2016, kishte paraqitur një ankim në Gjykatën e Lartë, e cila nuk kishte ndërmarrë ndonjë hap për ta shqyrtuar atë deri më 24 shkurt 2021, kur kishte vendosur ta dërgonte çështjen për rishqyrtim nga një trupë tjetër në Gjykatën Administrative të Apelit. Në vijim, ai argumentoi se nuk kishte kontribuar në ndonjë mënyrë në vonesën në procedura; përkundrazi, ai i kishte kërkuar Gjykatës së Lartë disa herë që të shqyrtonte çështjen e tij. Për më tepër, ai shtoi se duke qenë se mandati i një rektori universiteti ishte i kufizuar për katër vjet, mosmarrëveshja e kishte pasur prioritet kohën, gjë e cila do të duhej ta kishte nxitur Gjykatën e Lartë ta merrte shpejt vendimin. Së fundmi, ai argumentoi se në opinionin e tij, vonesa në Gjykatën e Lartë kishte ardhur për shkak të reformave në drejtësi, gjë e cila kishte bërë që Gjykata e Lartë të operonte me shumë pak gjyqtarë.

62. Qeveria pranoi se procedurat në Gjykatën e Lartë nuk kishin respektuar kërkesën për “afat të arsyeshëm”, sipas nenit 6§1 të Konventës, megjithatë, Qeveria shpjegoi se vonesa në shqyrtimin e ankimit të kasacionit të kërkuesit të parë kishte ardhur si pasojë e reformës në gjyqësor dhe, veçanërisht, në *vetting*-un e gjyqtarëve, reformë e cila kishte qenë një nevojë për sistemin gjyqësor në Shqipëri. Qeveria argumentoi se autoritetet përkatëse vendëse kishin miratuar një legjislacion të dytë dhe një sërë rregulloresh të brendshme, dhe se kishin punuar me shpejtësi për të finalizuar procedurën për emërimin e gjyqtarëve shtesë në Gjykatën e Lartë.

63. Gjykata thekson se arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurave duhet të vlerësohet sipas rrethanave të çështjes dhe në referencë të kriterëve të mëposhtme: kompleksiteti i çështjes, sjellja e ankuesit dhe e autoriteteve përkatëse, dhe se çfarë rrezikohej për kërkuesin në mosmarrëveshje (shih, midis shumë autoritetesh, *Sürmeli kundër Gjermanisë* [DHM], nr. 75529/01, §128, GJEDNJ 2006-VII).

64. Duke u kthyer te çështja e kërkuesit të parë, procedurat filluan më 23 prill 2016 (shih paragrafin 7 më sipër), kur kërkuesi paraqiti një ankim administrativ kundër vendimit të Komisionit Zgjedhor, për një “mosmarrëveshje” të lindur, sipas interpretimit të nenit 6§1 (shih, për shembull, *Mitkova dhe ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë*, nr. 48386/09, §49, 15 tetor 2015). Sipas një vendimi të fundit dhënë nga Gjykata e Lartë më 24 shkurt 2021 (shih paragrafin 14 më sipër), çështja u kthye për rishqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit, tek e cila procedurat janë ende pezull. Deri më sot, procedurat kanë zgjatur për mbi pesë vjet e katër muaj në të tria nivelet e juridiksionit.

65. Gjykata e pranon se kohëzgjatja e përgjithshme e procedurave, në këndvështrimin e parë, mund të duket e arsyeshme. Në fakt, procedura e shqyrtimit administrativ dhe procedura e shqyrtimit gjyqësor fillestar janë kryer relativisht shpejt. Megjithatë, në kërkesën konkrete, Gjykata shqetësohet për periudhën nga data 27 tetor 2016, kur kërkuesi i parë paraqiti një ankim kasacioni në Gjykatën e Lartë, dhe deri më 24 shkurt 2021, kur ajo gjykatë pranoi ankimin e kasacionit dhe e riktheu çështjen që të rishqyrtohej nga një trupë tjetër në Gjykatën Administrative të

Apelit. Në këtë këndvështrim, Gjykata e ka të pamundur të dakordësohet me gjetjet e Gjykatës së Lartë në vendimin e saj të datës 13 korrik 2021, se çështja kishte pasur një vonesë prej një viti e gjashtë muajsh, periudhë kohore e cila fillonte nga data kur ankimi i kasacionit ishte regjistruar në atë gjykatë dhe deri në datën kur kërkuesi i parë e kishte paraqitur kërkesën e tij në mbështetje të neneve 399/1 e në vijim të KPC-së.

66. Nga ana tjetër, Gjykata dakordësohet me konstatimin e Gjykatës së Lartë, se lënda e procedimeve, që kishte të bënte me ligjshmërinë dhe rezultatin e zgjedhjeve për pozicionin e rektorit të universitetit nuk sillte problematika veçanërisht komplekse për faktin ose ligjin.

67. Në lidhje me sjelljen e kërkuesit të parë, Gjykata thekson se gjatë gjithë procedurave ai veproi në mënyrë të kujdesshme, pa shkaktuar vonesa, dhe në disa raste ai kërkoi përshpejtimin e procedurave.

68. Gjykata vëren se, sipas dosjes së çështjes, nuk rezulton që Gjykata e Lartë të ketë ndërmarrë ndonjë hap procedural, në lidhje me ankimin e kasacionit të kërkuesit, duke qenë se çështja e tij mbeti pezull deri më 24 shkurt 2021. Qeveria u shpreh se vonesa ishte shkaktuar nga procesi i *vetting*-ut. Gjykata e Lartë paraqiti të njëjtin shpjegim në vendimin e saj të datës 13 korrik 2021. Në lidhje me këtë gjë, Gjykata konstaton se në vitin 2016 Shqipëria ndërmori reforma të thella në të gjithë sistemin e drejtësisë, gjë e cila solli ndryshime në Kushtetutë, në organizimin dhe funksionimin e gjykatave më të larta në vend, të tilla si: Gjykata e Lartë, duke përfshirë mënyrën në të cilën gjyqtarët e saj do të zgjidheshin nga institucione të ndryshme, dhe hapi rrugën për *vetting*-un e të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë.

69. Megjithatë, përpara ndërmarrjes së procesit të *vetting*-ut, Gjykata e Lartë kishte akumuluar një numër çështjesh të prapambetura (*backlog*-u) prej 16777 çështjesh (shih paragrafin 28 më sipër).

70. Gjithashtu, Gjykata e Lartë vijoi të vepronte dhe të shqyrtonte ankimet e kasacionit të paktën deri më 21 maj 2019, datë pas së cilës ajo nuk kishte kuorumin statutor të nevojshëm për të marrë vendime (shih paragrafin 25 më sipër). Për pasojë, i takonte Gjykatës së Lartë të shqyrtonte ankimin e kasacionit të kërkuesit të parë deri më atë datë. Duke e marrë në konsideratë vonesën e kuptueshme të shkaktuar nga reformat e thella në sistemin e drejtësisë dhe nga procesi i *vetting*-ut, Gjykata vëren se shtetet kanë një detyrim të përgjithshëm që t'i organizojnë sistemet e tyre ligjore për të garantuar respektim të kushteve të parashikuara në nenin 6§1, duke përfshirë edhe një seancë të drejtë dëgjimore brenda një afati të arsyeshëm (shih *Krastanov kundër Bullgarisë*, nr. 50222/99, §74, 30 shtator 2004).

71. Gjithashtu, Gjykata mban në konsideratë edhe interpretimin e Gjykatës së Lartë për nenin 399/2§3 të KPC-së, sipas së cilës periudhat kohore gjatë të cilave “rrethanat e kanë bërë të pamundur objektivisht [për gjykatën] procedimin”, me shqyrtimin e një çështjeje – të cilat përfshinin, sipas saj, ndikimet e reformave në vijim në sektorin e drejtësisë për funksionimin e vetë Gjykatës së Lartë – nuk do të duhej të përlloraritëshin në kohëzgjatjen e përgjithshme të procedurave (shih paragrafin 15 më sipër). Duke qenë se nuk i takon Gjykatës që të vendosë

për interpretimin e duhur të ligjit të brendshëm, ajo gjykon se, sipas rrethanave të kërkesës konkrete, një qasje e tillë nuk do të ishte në harmoni me praktikën e saj ligjore, në mbështetje të nenit 6§1, për kërkesën për “një afat të arsyeshëm”, sepse në këtë mënyrë e gjithë barra për ndonjë vonesë të shkaktuar nga reformat në sektorin e drejtësisë do të kalonte te pala ndërgjyqëse individuale.

72. Së fundmi, në përcaktimin e asaj që rrezikohej për kërkuesin, Gjykata pranon se çështja nuk kishte relevancë të drejtpërdrejtë me mjetet për jetesë të kërkuesit, me përfitimet apo dietat e tij, duke qenë se ai vazhdonte të ishte i punësuar si doktor dhe lektor në universitet. Ai as nuk u pushua dhe as nuk u pezullua nga detyra, procedura këto të cilat nga vetë natyra e tyre do të kishin shkaktuar nevojën për vendime të përsheptuara (shih, për shembull, *Launikari kundër Finlandës*, nr. 34120/96, §36, 5 tetor 2000, e cila kishte të bënte me një mosmarrëveshje punësimi për pushimin e kërkuesit nga detyra, dhe *Hajrudinović kundër Sllovenisë*, nr. 69319/12, § 45, 21 maj 2015, e cila kishte të bënte me pretendimin e kërkuesit për pagesat e shkurtimit nga puna). Pavarësisht kësaj, për sa i përket mandatit katërvjeçar për pozicionin e rektorit, Gjykata është e mendimit se çështja ka pasur rëndësi për kërkuesin dhe do të duhej ta kishte nxitur Gjykatën e Lartë ta shqyrtonte atë me kujdes.

73. Në këtë situatë është shkelur neni 6§1 i Konventës.

B. Në lidhje me kërkesën nr. 17766/19, Kola kundër Shqipërisë

1. Pranueshmëria

a) Në lidhje me ankimin për kohëzgjatjen e procedurave

74. Qeveria parashtroi se kërkuesi i dytë nuk kishte shfrytëzuar zgjidhjen e brendshme të parashikuar nga nenet 399/1 e në vijim të KPC-së. Qeveria argumentoi veçanërisht se në mbështetje të nenit 399/6§1(c), ankimet në lidhje me kohëzgjatjen e procedurave që ishin pezull përpara një kolegji në Gjykatën e Lartë, mund të paraqiteshin në çdo kohë përpara një kolegji tjetër të Gjykatës së Lartë.

75. Kërkuesi i dytë nuk ra dakord dhe u shpreh se Gjykata e Lartë nuk kushte qenë funksionale, pasi ajo kishte pasur një numër të pamjaftueshëm gjyqtarësh. Për këtë arsye, ai argumentoi se në praktikë nuk kishte pasur asnjë zgjidhje të brendshme efektive për ankimin e tij.

76. Gjykata përsërit parimet e përgjithshme në lidhje me shterimin e zgjidhjeve të brendshme të parashikuara në një sërë vendimesh (shih, midis të tjerash, *Vučković dhe të tjerët kundër Serbosë* (vendim paraprak) [DHM], nr. 17153/11 dhe 29 të tjerë, §69–77, 25 mars 2014). Në vijim, ajo thekson se pikëpyetja vendimtare në vlerësimin e efikasitetit të një zgjidhjeje, në lidhje me vonesat procedurale është nëse ekziston ose jo mundësia për kërkuesin, në mënyrë që këtij të fundit t’i garantohej një zgjidhje e drejtpërdrejtë dhe e shpejtë, në vend të mbrojtjes indirekte të të drejtave të garantuara në mbështetje të nenit 6 (shih, *mutatis mutandis*, *Scordino kundër Italisë (nr. 1)* [DHM], nr. 36813/97, §195, GJEDNJ 2006, dhe *Sürmeli* cituar më sipër, §101). Më konkretisht, një zgjidhje do të jetë efikase, nëse ajo mund të përdoret ose për të parandaluar shkeljen e pretenduar që të ndodhë ose të vijoje të ndodhë, ose për t’i garantuar kërkuesit zgjidhjen e duhur për çdo shkelje që mund të ketë ndodhur tashmë (shih *McFarlane kundër Irlandës* [DHM], nr. 31333/06, §108, 10 shtator 2010).

77. Gjykata thekson se Shqipëria ka miratuar një zgjidhje përsheptuese/parandaluese, në lidhje me kohëzgjatjen e procedimeve, e cila ka hyrë në fuqi më 5 nëntor 2017 (shih paragrafin 37 më sipër). Sipas neneve 399/1 e në vijim të KPC-së, një palë në procedurat penale mund të paraqesë një kërkesë për përsheptim të procedurave.

78. Duke u rikthyer në çështjen konkrete, Gjykata thekson se kërkuesi i dytë e paraqiti ankimin e tij të kasacionit në Gjykatën e Lartë për përsheptim të procedurave të kasacionit.

79. Megjithatë, Gjykata nuk është e bindur se një kërkesë për përsheptim të procedurave do të ishte efikase në rrethanat e kësaj çështjeje. Edhe sikur të hamendësohet se kërkuesi i dytë e ka bërë një kërkesë për përsheptim të procedurave, funksionimi i Gjykatës së Lartë ishte kaq i dëmtuar nga shkarkimi i gjyqtarëve të saj nga detyra (shih paragrafin 25 më sipër), sa që më 31 korrik 2018, Gjykata e Lartë, e mbledhur në një kolegji tjetër nga ai përpara të cilit ishte paraqitur ankimi i kasacionit, nuk do ta kishte pasur të mundur të shqyrtonte atë, për shkak të numrit të pamjaftueshëm të gjyqtarëve (shih paragrafët 25 dhe 33 më sipër). Për më tepër, edhe nëse do të hamendësohej se Gjykata e Lartë mund ta kishte pranuar kërkesën e kërkuetit për përsheptim dhe t'ia kishte dorëzuar një trupe gjyqësore, duke nisur nga data 22 maj 2019, Gjykata e Lartë nuk ka pasur kuorumin e nevojshëm të gjyqtarëve për të shqyrtuar ankimet e kasacionit të cilësdo natyre. Në rrethanat përjashtimore të kërkesës konkrete, rezulton se objeksioni i Qeverisë, në lidhje me mosparaqitjen e një kërkesë përpara Gjykatës së Lartë për përsheptim të procedurave nga ana e kërkuetit të dytë duhet të rrëzohet.

80. Së fundmi, Gjykata është e mendimit se duke pasur në konsideratë faktin se kërkuesi i dytë është përballur me “situatën e vazhduar” të funksionimit të pjesshëm të Gjykatës së Lartë deri më 31 korrik 2018, dhe me mungesën e një kuorumi në Gjykatën e Lartë për të shqyrtuar ankimet e kasacionit deri më 22 maj 2019, të cilat ishin me një kohëzgjatje të përkohshme, si edhe faktin se ai e paraqiti kërkesën e tij në Gjykatë pa vonesë, nuk rezulton të ketë asnjë problem me respektimin e afatit gjashtëmujor (shih, për shembull, *Cone kundër Rumanisë*, nr. 35935/02, §§22, 24 qershor 2008; dhe *a contrario*, *Sokolov dhe të tjerët kundër Serbisë* (vendim), nr. 30859/10 dhe 6 kërkesa të tjera, §33–36, 14 janar 2014).

81. Gjykata vëren se kjo ankesë nuk është as e pabazuar në fakte dhe as e papranueshme për ndonjë nga arsyet e listuara në nenin 35 të Konventës. Për këtë arsye, ajo duhet të deklarohet e pranueshme.

b) Në lidhje me ankimin për procedura të padrejta

82. Qeveria parashtroi se çështja është ende pezull në Gjykatën e Lartë. Në vijim të vendimit të saj të datës 1 mars 2016 dhe kthimit të çështjes për rishqyrtim, Gjykata e Apelit në vijim shqyrtoi dhe ofroi arsye të mjaftueshme për dënimin e kërkuetit të dytë.

83. Kërkuesi i dytë e kundërshtoi këtë aspekt, duke argumentuar se vendimi i gjykatës së apelit nuk ishte arsyetuar mjaftueshëm.

84. Gjykata thekson se më 24 mars 2021, Gjykata e Lartë e kishte deklaruar ankimin e kasacionit të kërkuetit të dytë të pranueshëm dhe, për pasojë, shqyrtimi

është në fazën e themelimit të çështjes. Në këto rrethana dhe duke pasur parasysh faktin se është e drejta e kërkuarit që të ankohet për padrejtësi në procedurat e brendshme përpara Gjykatës Kushtetuese, pas dhënies së vendimit nga Gjykata e Lartë (shih *Delijorgji kundër Shqipërisë*, nr. 6858/11, §59, 28 prill 2015, me referenca të tjera), Gjykata e kundërshton këtë ankesë si të parakohshme, në mbështetje të nenit 35§§1 dhe 4 të Konventës.

2. Meritat

85. Kërkuari i dytë u shpreh se kohëzgjatja e procedurave penale ndaj tij kishte qenë e paarsyeshme.

86. Qeveria parashtroi se më 23 mars 2017, Gjykata e Apelit kishte lënë në fuqi, në shkallën e fundit, dënimin ndaj kërkuarit. Sipas Qeverisë, ai vendim shënoi fundin e procedurave gjyqësore ndaj tij, kohëzgjatja e të cilave kishte qenë e arsyeshme.

87. Në lidhje me vonesat përpara Gjykatës së Lartë, Qeveria argumentoi se ajo situatë ishte *sui generis*, për arsye objektive e lidhur me realizimin e reformave në sistemin e drejtësisë, për shkak të të cilave ishte e vështirë të zbatoheshin kërkesat e parashikuara në praktikën gjyqësore të Gjykatës. Qeveria theksoi se nuk kishte asnjë të dhënë në dosjen e çështjes të ndonjë organizimi të dobët nga ana e gjykatave të brendshme ose stafi administrativ gjyqësor. Sidoqoftë, Qeveria parashtroi se *backlog*-u (çështjet e prapambetura) në Gjykatën e Lartë ishte i përkohshëm dhe se ishin marrë masa të menjëhershme korrigjuese për të menaxhuar situatën.

88. Gjykata i referohet parimit të përgjithshëm të parashikuar në paragrafin 63 më sipër, në lidhje me vlerësimin e arsyeshmërisë së kohëzgjatjes së procedurave.

89. Duke u rikthyer në çështjen konkrete, palët nuk e kanë kundërshtuar faktin – dhe Gjykata bie dakord – se procedurat ndaj kërkuarit të dytë filluan më 24 nëntor 2011, kur ai u akuzua për vrasje me paramendim dhe mbajtje pa leje të armëve (shih paragrafin 17 më sipër). Në lidhje me fazën e fundit të procedurave, Gjykata nuk mund të pranojë pretendimin e Qeverisë se procedurat përfunduan më 23 mars 2017, kur Gjykata e Apelit la në fuqi dënimin ndaj kërkuarit (shih paragrafin 20 më sipër), për aq kohë sa ai vendim është apeluar dhe nuk ka marrë ende formën *res judicata*. Në lidhje me këtë aspekt, Gjykata thekson se më 5 mars 2021, Gjykata e Lartë e deklaroi ankimin e kasacionit të kërkuarit të dytë ndaj vendimit të gjykatës së apelit të pranueshëm. Rezulton se procedurat penale ndaj kërkuarit të dytë janë ende në proces dhe se, deri më sot, ato kanë zgjatur për nëntë vite, nëntë muaj dhe gjashtëmbëdhjetë ditë në tri nivele të juridiksionit.

90. Gjykata argumenton se procedurat penale, të cilat përfshijnë dy akuza penale dhe dy të bashkëpandehur, nuk ishin veçanërisht komplekse dhe kryesisht përfshinin çështje që kishin të bënin me mjaftueshmërinë e provave.

91. Në lidhje me sjelljen e kërkuarit të dytë, nuk ka indicie se ai ka shkaktuar ose ka kontribuar në vonesën e procedurave.

92. Duke iu rikthyer reagimit të autoriteteve vendëse, Gjykata vëren se Gjykata e Rrethit dhe Gjykata e Apelit kanë dhënë një total prej tri vendimesh, në lidhje me dënimin e kërkuarit brenda një afati të arsyeshëm. Megjithatë, ka pasur të paktën dy momente të rëndësishme vonese gjyqësore.

93. Periudha e parë, e cila filloi në maj 2013 dhe zgjati pothuajse dy vite dhe dhjetë muaj, kishte të bënte me procedurat në Gjykatën e Lartë, e cila, më 1 mars 2016, pranoi ankimin e kërkuarit të dytë dhe e riktheu çështjen për rishqyrtim nga një kolegji tjetër në Gjykatën e Apelit. Qeveria nuk paraqiti asnjë shpjegim për atë vonesë.

94. Edhe periudha e dytë ka të bëjë me procedurat në Gjykatën e Lartë, e cila filloi më 27 mars 2017 dhe janë ende pezull, duke zgjatur për mbi katër vjet e dy muaj. Si përgjigje ndaj argumentit të Qeverisë, se kjo vonesë u shkaktua nga reformat në sistemin e drejtësisë dhe procesi i *vetting*-ut, Gjykata përsërit, se pavarësisht reformave të thella në sistemin e drejtësisë dhe vonesën e kuptueshme të shkaktuar prej tyre, Shteti i paditur ka detyrimin e përgjithshëm që të organizojë sistemet e tij ligjore për të garantuar respektim të kushteve parashikuara në nenin 6§1, duke përfshirë edhe kushtin për një seancë të drejtë brenda një afati të arsyeshëm (shih edhe paragrafin 70 më sipër).

95. Gjithashtu, Gjykata vëren se nga viti 2012, *backlog*-u i Gjykatës së Lartë është rritur gradualisht dhe mbetet në nivele shumë të larta (shih paragrafët 28 dhe 29 më sipër). Për këtë arsye, Gjykata e ka të pamundur të pranojë argumentin e Qeverisë se *backlog*-u në Gjykatën e Lartë është vetëm i përkohshëm ose se pavarësisht masave të marra së fundmi për të reduktuar *backlog*-un e saj (shih paragrafin 29 më sipër), është ndërmarrë një masë mjaftueshme e shpejtë dhe gjithëpërfshirëse korrigjuese gjatë një sërë vitesh për të trajtuar situatën.

96. Së fundmi, Gjykata e pranon, se, për shkak se akuza penale ndaj kërkuarit të dytë është e rëndë dhe ka ndikim ndaj të drejtave të tij, procedurat kërkonin një nivel të caktuar përsheptimi.

97. Në përputhje me rrethanat, Gjykata arrin në përfundimin se është shkelur neni 6§1 i Konventës.

III. SHKELJE E PRETENDUAR E NENIT 13 SË BASHKU ME NENIN 6§1 TË KONVENTËS

98. Kërkuari i parë u ankua, në mbështetje të nenit 13 të Konventës, për mungesën e një zgjidhjeje efektive, në lidhje me ankesën e tij për kohëzgjatjen e procedurave.

Neni 13 i Konventës parashikon si më poshtë:

“Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.”.

A. Pranueshmëria

99. Qeveria nuk e kundërshtoi pranueshmërinë e ankimit.

100. Gjykata vëren se ankimi i kërkuarit të parë, në mbështetje të nenit 13 nuk është as i pabazuar dukshëm në fakte dhe as i papranueshëm, sipas ndonjë shkakut tjetër, në mbështetje të nenit 35 të Konventës. Për këtë arsye, ankimi duhet të shpallet i pranueshëm.

B. Meritat

1. Parashtrimet e palëve

101. Kërkuesi i parë u ankua se në rrethanat e çështjes së tij, zgjidhja e garantuar sipas neneve 399/1 e në vijim të KPC-së nuk kishte qenë efektive sipas interpretimit të nenit 13 të Konventës.

102. Qeveria nuk e kundërshtoi këtë aspekt.

2. Vlerësimi i Gjykatës

103. Gjykata thekson se në çështjen *Luli dhe të tjerët* (cituar më sipër), parashikohet se në mbështetje të nenit 46 të Konventës, Shteti duhet të vendosë një zgjidhje të brendshme, në lidhje me kohëzgjatjen e tepruar të procedimeve. Si përgjigje ndaj vendimit të mësipërm, ligjvënësi shqiptar ka bërë një parashikim për një zgjidhje përshpejtuese/parandaluese dhe kompensuese, në përputhje me nenet 399/1 e në vijim të KPC-së. Për këtë arsye, Gjykata do të vlerësojë efikasitetin e përgjithshëm të kësaj zgjidhjeje, sipas interpretimit të nenit 13 të Konventës, përpara se të përcaktojë nëse është efikase për çështjen e kërkuesit të parë.

a) Pajtueshmëria, në parim, e një zgjidhjeje të re me kërkesat e nenit 13

104. Parimet përkatëse në lidhje me zbatimin e nenit 13 të Konventës, në lidhje me ankimet për një shkelje të së drejtës për një seancë dëgjimore brenda një afati të arsyeshëm parashikohen në një sërë vendimesh (shih, midis të tjerash, *Kudla* cituar më sipër, §157; *Scordino (nr. 1)*, cituar më sipër, §§182–89; *Sürmeli*, cituar më sipër, §§97–101; dhe *McFarlane kundër Irlandës* [DHM], cituar më sipër, §108).

105. Gjykata thekson, veçanërisht, se zgjidhjet në dispozicion të një individi në nivel të brendshëm për paraqitjen e një ankimi, në lidhje me kohëzgjatjen e procedurave janë “efektive”, sipas interpretimit të nenit 13 të Konventës, nëse ato mund të përdoren për të përshpejtuar procedurat përpara gjykatave vendëse ose nëse i garantojnë individit korrigjimin e duhur për vonesat të cilat kanë ndodhur. Në rastin kur një sistem i brendshëm ligjor bën një parashikim për miratimin e një mase ndaj Shtetit, një masë e tillë duhet të mbetet efektive, e mjaftueshme dhe e aksesueshme në përputhje me kohëzgjatjen e tepërt të procedurave gjyqësore. Mjaftueshmëria e saj varet nga vonesat e tepërta dhe nga niveli i kompensimit (shih *Rutkowski dhe të tjerët kundër Polonisë*, nr. 72287/10 dhe 2 të tjerë, §§173, 7 korrik 2015).

i. Në lidhje me zgjidhjen përshpejtuese/parandaluese

106. Duke u rikthyer te zgjidhja përshpejtuese/parandaluese e miratuar në legjislacionin shqiptar, Gjykata thekson se neni 399/2 i KPC-së parashikon se kohëzgjatja e procedurave administrative, civile dhe penale konsiderohet e arsyeshme. Një palë mund të paraqesë një kërkesë për konstatimin e një shkeljeje ndaj kërkesës për një “afat të arsyeshëm” dhe përshpejtimit të procedurave, sipas nenit 399/6§1 të KPC-së. Një kërkesë e tillë do të duhet të shqyrtohet me dyer të mbyllura nga gjykata kompetente. Sipas nenit 399/8§1 të KPC-së, nëse gjykata kompetente konstaton një shkelje të kërkesës për “afat të arsyeshëm”, ajo do të urdhërojë që të ndërmerren masa të caktuara procedurale brenda një afati që përcaktohet nga vet gjykata. Vendimi i gjykatës është përfundimtar. Në vijim,

Gjykata thekson se kriteret e parashikuara në nenin 399/9 të KPC-së për konstatimin e një shkeljeje të kërkesës për “afat të arsyeshëm” janë në përputhje me praktikën gjyqësore përkatëse të Gjykatës, më konkretisht, kompleksiteti i çështjes, reagimet e palëve dhe çfarë është në rrezik për pretenduesin.

107. Për këtë arsye, Gjykata është e mendimit, se procedura për zbatimin e zgjidhjes përshpejtuese/parandaluese do të ketë ndikim në kohëzgjatjen e procedurave në tërësi ose duke përshpejtuar procedurat, ose duke parandaluar që ato të marrin një kohë paarsyeshmërisht të gjatë. Një gjë e tillë mbështetet edhe nga vendimet e Gjykatës së Lartë, tek të cilat mbështetet edhe Qeveria (shih paragrafët 39 dhe 43 më sipër), duke treguar se zgjidhja parandaluese në fjalë nuk ka prodhuar vetëm rezultate *de jure*, por edhe *de facto*.

108. Në vijim, Gjykata thekson se është e nevojshme të theksohet, se, në vlerësim të pajtueshmërisë me kërkesën për “afat të arsyeshëm”, gjykatat e brendshme duhet të kenë në konsideratë të gjithë kohëzgjatjen e procedurave dhe të shqyrtojnë kohëzgjatjen e përgjithshme të të gjitha fazave të procedurave, në vend që ta kufizojnë vlerësimin e kohëzgjatjes së procedurave të brendshme në atë pikë që një individ bën një kërkesë në mbështetje të nenit 399/6§1 të KPC-së (shih, *mutatis mutandis*, *Rutkowski dhe të tjerët*, cituar më sipër, §§ 212–213). Gjithashtu, së bashku me urdhrin që masa të caktuara procedurale të ndërmerren nga autoriteti përgjegjës për të përshpejtuar procedurat e vonuara, gjykata kompetente duhet të përcaktojë një afat të arsyeshëm për masat procedurale në mënyrë që zgjidhja të jetë efektive.

109. Për sa më sipër, Gjykata nënvizon se, në këtë fazë, nuk ka arsye të besohet se kërkesa për konstatimi e një shkeljeje të kërkesës së “afatit të arsyeshëm” dhe të përshpejtimit të procedurave, sipas legjislacionit shqiptar hyrë në fuqi më 5 nëntor 2017, sipas neneve 399/1 e në vijim të KPC-së, nuk do të ishte efektive.

ii. Në lidhje me aspektin kompensues të zgjidhjes

110. Gjykata thekson se neni 399/6§3 i KPC-së parashikon mundësinë për shpërblim të dëmit të shkaktuar nga kohëzgjatja e pajustifikuar e procedurave. Gjykata përsërit se, nëse Shteti ka marrë një hap të rëndësishëm duke miratuar një zgjidhje kompensuese, kjo zgjidhje duhet të lejojë një margjinë më të gjerë në vlerësimin e Shtetit për t’i mundësuar që ta organizojë zgjidhjen në mënyrë të tillë, që të jetë në përputhje me sistemin e tij ligjor dhe traditat ligjore, si edhe të jetë në harmoni me standardin e jetës në vendin në fjalë (shih *Scordino (nr. 1)*, cituar më sipër, §189).

111. Gjykata vëren se kërkesëpadia për kompensim duhet të dorëzohet në gjykatën e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm me konstatimin e një shkeljeje të kërkesës për “afat të arsyeshëm”. Kërkesëpadia do të parashkruhet brenda gjashtë muajsh nga konstatimi i shkeljes. Sipas nenit 399/7§1, kërkesëpadia do të shqyrtohet në përputhje me rregullat e zakonshme procedurale brenda tre muajsh nga paraqitja e saj. Nëse kërkesëpadia pranohet, gjykata kompetente merr një vendim në përputhje me Nenin 399/10, në lidhje me kriteret e parashikuara në paragrafin 2 të tij, sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës, më konkretisht, sipas kompleksitetit të procedurave, reagimit të kolegjit, dhe çfarë rrezikon pretenduesi.

112. Gjykata mban në konsideratë vendimet e gjykatave të brendshme, në lidhje me aspektin kompensues të zgjidhjes së re (shih paragrafët 44–46 më sipër) dhe gjykon se është e nevojshme që të adresohen disa pyetje, në lidhje me efikasitetin e këtij aspekti specifik.

113. Fillimisht, rregullat procedurale që drejtojnë shqyrtimin e kërkesëpadisë për kompensim duhet të jenë në përputhje me parimin e drejtësisë së parashikuar në nenin 6 të Konventës (shih *Finger kundër Bullgarisë*, nr. 37346/05, §130, 10 maj 2011).

114. Së dyti, rezulton se kërkesëpadia për kompensim duhet të paraqitet pas konstatimit të shkeljes së kërkesës për “afat të arsyeshëm” në një nivel të juridiksionit. Në lidhje me këtë aspekt dhe konstatimin në paragrafin 108 më sipër, Gjykata nënvizon se në parim, individët duhet të kenë mundësinë të ngrenë kërkesëpadi, në lidhje me kohëzgjatjen në tërësi të procedurave deri në pikën që, në varësi të çështjes, mund të përfshihen një sërë nivelesh të juridiksionit.

115. Së treti, Gjykata thekson nevojën për t’i kryer këto procedura në mënyrë të menjëhershme, në mënyrë që zgjidhja të mbetet efektive. Në lidhje me këtë aspekt, duhet të mbahet në konsideratë shqyrtimi i këtyre kërkesëpadive, sipas rregullave të posaçme, të cilat ndryshojnë nga ata që përdoren për kërkesëpadi të zakonshme për shpërbllim, për të shmangur rrezikun – në rastin kur shqyrtohen sipas rregullave të përgjithshme të procedurës civile – që zgjidhja të mos jetë mjaftueshëm e shpejtë (shih *Scordino (nr. 1)*, cituar më sipër, § 200).

116. Së katërti, Gjykata është e mendimit se shumat dhënë si kompensim deri më sot nuk janë të tilla që t’i mundësojnë Gjykatës që të përcaktojë se ato janë të paarsyeshme. Më herët, ajo ka pranuar, se një shtet, i cili ka miratuar një sërë zgjidhjesh, njëra prej të cilave ka si synim përshpejtimin e procedurave dhe një tjetër kompensimin, mund të japë shuma të cilat edhe pse më të ulëta se sa ato të dhëna nga Gjykata, nuk janë të paarsyeshme, me kushtin që vendimet përkatëse, të cilat duhet të jenë në përputhje me traditën ligjore dhe standardin e jetesës në vendin në fjalë, janë të shpejta, të arsyetuara dhe të ekzekutuara shumë shpejt (shih *Scordino (nr. 1)*, cituar më sipër, § 206).

117. Së fundmi, Gjykata thekson rëndësinë e zbatimit të menjëhershëm të vendimeve për kompensim, në mënyrë që zgjidhja të vijojë të jetë efektive (shih *Gaglione dhe të tjerët kundër Italisë*, nr. 45867/07, §§34–44, 21 dhjetor 2010).

118. Thënë kjo, Gjykata është e mendimit, se në këtë fazë, nuk ka arsye të besohet se aspekti kompensues i zgjidhjes nuk i garanton pretenduesit mundësinë që të përftojë kompensimin e duhur dhe të mjaftueshëm për ankesat e tij ose të saj, ose që të mos garantojë perspektivat e arsyeshme për sukses. Gjykata mban në konsideratë faktin se aspekti kompensues i zgjidhjes është më i organizuar dhe më i aksesueshëm se sa një kërkesë në Gjykatë, është më i shpejtë dhe përgatitet në gjuhën e kërkuarit, duke ofruar kështu avantazhe që duhet të mbahen në konsideratë (shih *Scordino (nr. 1)*, cituar më sipër, §268).

iii. Përfundim

119. Për sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se zgjidhja për përshpejtimin e procedurave dhe ofrimin e kompensimit për individët është efektive, për faktin se

mund të parandalojë vijimësinë e shkeljes së pretenduar të së drejtës së individit, që çështja e tij të dëgjohet pa vonesa të tepërta, si edhe të garantojë korrigjimin e duhur për shkeljet që kanë ndodhur. Për pasojë, zgjidhja, në parim, përmbush detyrimin e Shtetit të paditur për të garantuar mjete efikase, në lidhje me shkeljet e pretenduara të të drejtave të një individi sipas Konventës. Për këtë arsye, zgjidhja e re duhet të përdoret nga individët të cilët padisin shkeljen e së drejtës për një seancë dëgjimore brenda një afati të arsyeshëm (shih edhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese në paragrafin 38 më sipër).

120. Megjithatë, ashtu siç demonstrohet nga vlerësimi në çështjen e kërkuarit të parë (shih paragrafët 121–124 më poshtë), mbetet për t'u parë nëse zgjidhja ka qenë efektive edhe në praktikë. Për më tepër, pozicioni i Gjykatës, ashtu siç u shpjegua më sipër (paragrafi 119) mund t'i nënshtrohet shqyrtimit në të ardhmen, në varësi, veçanërisht, nga kapaciteti i gjykatave të brendshme për të zhvilluar dhe pasur një praktikë gjyqësore konsistente, në përputhje me kërkesat e Konventës. Për më tepër, barra e provës për sa ka të bëjë me efikasitetin e zgjidhjes së re, praktikisht mbetet në dorë të Qeverisë së paditur (shih, për shembull, *Taron kundër Gjermanisë* (vendim), nr. 53126/07, §45, 29 maj 2012).

b) Vlerësimi i çështjes së kërkuarit të parë

121. Tashmë, Gjykata do të shqyrtojë faktin, nëse kërkuari i parë kishte një mjet efektiv, në lidhje me ankimin e tij, për sa i përket kohëzgjatjes së procedurave, sipas nenit 6§1 të Konventës.

122. Gjykata vëren se në vijim të hyrjes në fuqi të zgjidhjes përsheptuese/parandaluese më 5 nëntor 2017, kërkuari i parë paraqiti një kërkesë për përsheptim të procedurave, në mbështetje të neneve 399/6, §1 e në vijim të KPC-së (shih paragrafët 12 dhe 13 më sipër). Megjithatë, pavarësisht kërkesës, ankimi i tij i kasacionit mbeti pezull në Gjykatën e Lartë deri më 21 shkurt 2021, ndërsa vetë kërkesa për përsheptimin e procedurave nuk mori përgjigje për më shumë se tre vjet, që do të thotë, deri më 13 korrik 2021 (shih paragrafin 13 më sipër).

123. Për këtë arsye, Gjykata gjykon se zgjidhja përsheptuese/parandaluese në çështjen e kërkuarit të parë nuk i shërbeu qëllimit për të përsheptuar procedurat përpara Gjykatës së Lartë, ose për t'i parandaluar procedurat që të zgjateshin në mënyrë të paarsyeshme. Gjithashtu, kërkuari i parë nuk mundi as që të kërkonte kompensim për kohëzgjatjen e atyre procedurave, sipas nenit 399/6 §3 të KPC-së, në mungesë të konstatimit të një shkeljeje të kërkesës për “afat të arsyeshëm”.

124. Në këto rrethana, Gjykata konstaton se ka pasur një shkelje të nenit 13 të Konventës për sa i përket kërkuarit të parë.

IV. SHKELJE TJETËR E PRETENDUAR E KONVENTËS

125. Kërkuari i dytë u ankua se gjykatat e brendshme e kishin ngarkuar me barrën e provës në shkelje të prezumimit të pafajësisë, sipas parashikimit në nenin 6§2 të Konventës, i cili parashikon, si më poshtë:

“Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.”

126. Qeveria parashtroi se çështja ishte ende pezull në gjykatat e brendshme dhe

se ankesa ishte e papranueshme.

127. Gjykata thekson përfundimet e saj sipas paragrafit 84 më sipër, në lidhje me mundësinë e Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Kushtetuese për të ofruar një zgjidhje për ankesat e kërkuarit të dytë. Gjykata gjykon se ato gjetje zbatohen edhe në ankesën konkrete, e cila ka të bëjë me shkeljen e pretenduar të prezumimit të pafajësisë, sipas nenit 6§2 të Konventës.

128. Për sa më sipër, Gjykata shprehet se ankesa konkrete është e papranueshme për mosshkrim të zgjidhjeve të brendshme dhe duhet të kundërshtohet në mbështetje të nenit 35§§1 dhe 4 të Konventës.

V. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

129. Neni 41 i Konventës parashikon:

“Kur Gjykata konstaton se ka pasur një shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj dhe, nëse e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese lejon të bëhet vetëm një ndreqje e pjesshme, Gjykata, kur është e nevojshme, i akordon shpërblim të drejtë palës së dëmtuar.”.

1. Dëmi

a) Në lidhje me kërkesën nr. 43391/18, *Bara kundër Shqipërisë*

130. Kërkuari i parë kërkoj 21000 euro (EUR) për dëmin jopasuror.

131. Qeveria parashtroi se pretendimi ishte i paarsyeshëm sipas kuantit.

132. Gjykata nënvizon se kërkuari i parë nuk parashtroi ndonjë pretendim për shpërblim pasuror, për këtë arsye ajo nuk merr asnjë vendim në lidhje me këtë aspekt. Për sa i përket shpërblimit jopasuror, duke marrë në konsideratë shkeljet e mësipërme, Gjykata bie dakord se shuma e pretenduar nga kërkuari i parë është e paarsyeshme sipas kuantit. Sipas një vlerësimi mbi baza të barabarta, ajo i akordon kërkuarit të parë 1200 euro për dëmin jopasuror, plus çdo taksë që mund të tarifohet.

b) Në lidhje me kërkesën nr. 17766/19, *Kola kundër Shqipërisë*

133. Kërkuari i dytë kërkonte 200 000 euro për dëm pasuror dhe 250 000 euro për dëm jopasuror.

134. Qeveria parashtroi se pretendimet ishin të paarsyeshme për sa i përket kuantit.

135. Gjykata nuk konstaton ndonjë lidhje shkakësore midis shkeljes së konstatuar dhe dëmit pasuror të pretenduar; për këtë arsye, ajo e kundërshton këtë pretendim. Për më tepër, ajo dakordësohet me Qeverinë, në lidhje me faktin se dëmi jopasuror nuk është i arsyeshëm për sa i përket kuantit. Duke bërë një vlerësim mbi baza të barabarta, Gjykata i akordon kërkuarit të dytë 2300 euro për dëmin jopasuror, plus çdo taksë të tarifueshme.

2. Kostot dhe shpenzimet

a) Kërkesa nr. 43391/18, *Bara kundër Shqipërisë*

136. Kërkuari i parë kërkoj 500 000 ALL (rreth 4 000 euro) për kostot dhe shpenzimet e bëra në gjykatat vendëse dhe 2 000 euro për ato të bëra në Gjykatë. Ai nuk paraqiti ndonjë faturë në mbështetje të këtyre pretendimeve, megjithatë, ai paraqiti tri marrëveshje të lidhura me përfaqësuesit e tij ligjorë.

137. Qeveria parashtroi se pretendimet nuk mbështeteshin me prova relevante dhe i kërkoi Gjykatës t'i rrëzonte ato.

138. Sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës, një kërkues ka të drejtën të rimbursohet për kostot dhe shpenzimet, vetëm nëse tregohet se ato janë bërë faktikisht, se kanë qenë të nevojshme dhe se janë të arsyeshme sipas kuantit. Në çështjen konkrete, Gjykata vëren se kërkuesi nuk paraqiti asnjë provë që të provonte shpenzimet që ai kishte bërë në lidhje me kërkesën, sipas neneve 399/1 e në vijim të KPC-së në Gjykatën e Lartë, sipas të cilëve Gjykata konstatoi një shkelje. Duke marrë në konsideratë dokumentet që ajo zotëron dhe kriteret e mësipërme, Gjykata e rrëzon kërkesën për kosto dhe shpenzime në procedurat e brendshme dhe e konsideron të arsyeshme që të akordojë shumën 1200 euro për procedurat në Gjykatë, plus çdo taksë që mund t'i tarifohet kërkuesit të parë.

b) Kërkesa nr. 17766/19, Kola kundër Shqipërisë

139. Kërkuesi i dytë kërkoi 25 000 euro për kostot dhe shpenzimet e bëra në gjykatat vendëse dhe në Gjykatë. Në mbështetje të këtij pretendimi, ai paraqiti një faturë ku listoheshin shërbimet e avokatit të tij dhe pagesën e plotë të tarifave që i detyrohej atij.

140. Qeveria parashtroi se kërkuesi i dytë nuk kishte paraqitur një detajim të shumave të pretenduara. Në vijim, Qeveria argumentoi se shuma e pretenduar ishte e paarsyeshme dhe se nuk kishte prova se ato kosto ishin bërë faktikisht.

141. Duke marrë në konsideratë dokumentet që zotëron dhe kriteret e përshkruar më parë në paragrafin 138, Gjykata e gjykon si të arsyeshëm akordimin e shumës prej 1200 eurosh për kërkuesin e dytë, shumë e cila mbulon kostot për çdo aspekt, plus çdo taksë që mund të jetë e tarifueshme.

3. Interesi për pagesë të pashlyer

142. Gjykata e konsideron të përshtatshme që norma e interesit për pagesën e pashlyer duhet të mbështetet në normën marginale të huadhënies së Bankës Qendrore Evropiane, së cilës i duhen shtuar edhe tre për qind pikë.

PËR KËTO ARSYE, UNANIMISHT GJYKATA:

1. *Vendos t'i bashkojë kërkesat;*

2. *I shpall ankesat e kërkuesve, sipas nenit 6§1 të Konventës, në lidhje me kohëzgjatjen e tepërt të procedurave dhe sipas kërkesës së kërkuesit të parë, në mbështetje të nenit 13 të Konventës, në lidhje me mungesën e zgjidhjes efektive për ankesën mbi kohëzgjatjen e procedurave të pranueshme, dhe pjesën tjetër të kërkesës së kërkuesit të dytë, të papranueshme;*

3. *Gjykon se ka pasur një shkelje të nenit 6§1 të Konventës, në lidhje me kohëzgjatjen e tepërt të procedurave për të dy kërkuesit;*

4. *Gjykon se ka pasur një shkelje të nenit 13 të Konventës, në lidhje me mungesën e një zgjidhjeje efektive për ankesën mbi kohëzgjatjen e procedurave, në lidhje me ankuesin e parë;*

5. *Gjykon:*

a) se Shteti i paditur duhet të paguajë, brenda tre muajve nga data në të cilën vendimi bëhet përfundimtar, sipas nenit 44§2 të Konventës, shumat e mëposhtme, të

cilat duhet të konvertohen në monedhën e Shtetit të paditur në normën e zbatueshme në datën e shlyerjes:

i. 1200 euro (një mijë e dyqind euro) për kërkuesin e parë dhe 2300 euro (dy mijë e treqind euro) për kërkuesin e dytë, plus çdo taksë që mund të tarifohet, në lidhje me dëmin jopasuror;

ii. 1200 euro (një mijë e dyqind euro) për secilin kërkues, plus çdo taksë që mund t'i tarifohet kërkuesve, për kostot dhe shpenzimet;

b) se që nga përfundimi i periudhës së sipërpërmendur tremujore deri në shlyerjen e saj, interesi i thjeshtë do të paguhet për shumat e mësipërme në normën e barasvlershme me normën marginale të huadhënies së Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së vonesës së shlyerjes plus tre për qind pikë;

6. *Rrëzon* pjesën tjetër të pretendimit të kërkuesve për shpërblim të drejtë.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim më 12 tetor 2021, sipas rregullës 77§§2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

Milan Blaško

Regjistra

Paul Lemmens

Kryetar

Në përputhje me Nenin 45§2 të Konventës dhe rregullës 74§2 të Rregullores së Gjykatës, opinioni i veçantë i Gjyqtarëve Dedov dhe Ravarani gjendet në shtojcën e këtij vendimi.

P.L

M.B.

OPINIONI I PËRBASHKËT I DAKORDËSUAR I GJYQTARËVE DEDOV DHE RAVARANI

A l'impossible nul n'est tenu.

1. Ne votuam në favor të konstatimit të një shkeljeje të nenit 6 §1 në çështjen konkrete, pasi ne i njohim dobësitë e papranueshme për trajtimin në kohë të çështjeve të paraqitura në Gjykatën e Lartë të Shqipërisë në harkun kohor të viteve 2016 deri në vitin 2021.

2. Megjithatë, ne ndiejmë detyrimin të nënvizojmë një pikë për të cilën kemi rezerva serioze në lidhje me konstatimet e vendimit. Ajo që na shqetëson është fakti se periudha nga viti 2018 deri në vitin 2019, kur Gjykata e Lartë duhej të operonte me një numër jashtëzakonisht të reduktuar gjyqtarësh, konkretisht tre dhe në fund katër, teksa numri i gjyqtarëve i parashikuar sipas ligjit ishte nëntëmbëdhjetë; dhe

nga muaji maj 2019 deri në mars 2020, kur Gjykata e Lartë e kishte të pamundur të mbledhë, sepse i mungonte kuorumi i nevojshëm, janë përlogaritur në periudhën e përgjithshme të marrë në konsideratë për vlerësimin e kohëzgjatjes së procedurave për të cilat ankohen kërkuesit.

3. Rrjedhjet me të cilat Gjykatës së Lartë iu desh të përballej nga viti 2016 dhe në vijim ishin kryesisht, nëse jo ekskluzivisht, për shkak të procesit të *vetting*-ut në gjyqësor, proces i cili ishte ndërmarrë atë vit nga Shqipëria, e inkurajuar dhe e mbështetur nga organet e Këshillit të Evropës, dhe e konsideruar në përputhje me kërkesat e Konventës nga Gjykata (shih *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*, nr. 15227/19, 9 shkurt 2021).

4. Kur gjykatave shqiptare iu kërkua që të shqyrtonin ankesën e kërkuesit të parë, në lidhje me kohëzgjatjen e procedurave në të cilat ai ishte përfshirë në kontekstin e zgjidhjes së sapomiratur për kohëzgjatjen e tepërt të procedurave gjyqësore, gjykatat shqiptare argumentuan se periudha kritike, gjatë së cilës Gjykata e Lartë nuk e kishte pasur të mundur që të operonte, përbënte një “element objektiv”, që duhej të merrej në konsideratë, në përputhje me ligjin e brendshëm për përlogaritjen e kohëzgjatjes së procedurave. Është e vërtetë se referimi i tyre në këtë argument ishte shumë i përgjithshëm dhe i përgatitur për të zhveshur Gjykatën e Lartë nga çdo fajësim për kohëzgjatje të tepruar të procedurave, por Gjykata mund ta kishte ndarë me lehtësi “shapin nga sheqeri”.

5. Në fakt, vendimi e pastron këtë argument me një përzierje disi të çuditshme elementesh abstrakte dhe konkrete në arsyetim.

6. Nga aspekti abstrakt, Gjykata “vëren se Shtetet kanë detyrimin e përgjithshëm t’i organizojnë sistemet e tyre ligjore, në mënyrë që të garantojnë respektimin e kushteve të nenit 6§1, duke përfshirë edhe atë për një seancë dëgjimore të drejtë brenda një afati të arsyeshëm” (shih paragrafin 70 të vendimit; ky përcaktim përsëritet edhe në paragrafin 94). Sigurish që ne nuk jemi në kundërshtim me një përcaktim të tillë në nivel parimor dhe abstrakt. Megjithatë, ashtu si në shumë fusha, një përmasë nuk përshtatet me çdo gjë. Në vendet me të vogla, shpesh mund të jetë e pamundur të gjenden mjaftueshëm persona të kualifikuar për të marrë funksione të larta gjyqësore brenda një periudhe të shkurtër kohore. Mbushja e vendeve të lira me kandidatë që janë mesatarisht të kualifikuar nuk duket të jetë një zgjidhje, sepse emërimet të tilla bëhen për një periudhë të gjatë dhe të gjithë duhet ta dinë se një zgjidhje afatshkurtër mund të shkaktojë efekte katastrofike në planin afatgjatë.

7. Në nivel konkret, vendimi konstaton se, në lidhje me kërkuesin e parë, “çështja ishte me rëndësi për kërkuesin dhe do të duhej ta kishte nxitur Gjykatën e Lartë ta shqyrtonte atë me kujdes” (shih paragrafin 72 *in fine* të vendimit), dhe në lidhje me kërkuesin e dytë “duke iu referuar faktit se sa e rëndë ishte akuza penale ndaj kërkuesit të dytë dhe ndikimit të saj në të drejtat e tij, procedurat kërkonin një nivel të caktuar përshpejtimi” (shih paragrafin 96).

8. Këtu vendimi përfshihet në një lloj mikromenaxhimi dhe vlerëson rëndësinë *relative* të të dyja çështjeve të brendshme me të cilat kanë lidhje ankesat e kërkuesve respektivë. Për të qenë në gjendje që ta kryejë këtë ushtrim në mënyrën e duhur, Gjykata do të duhej të kishte një pasqyrë të plotë të çështjeve të tjera të mbetura

pezull dhe të mund të vendosë se cilat çështje ishin të një rëndësie më të vogël, në mënyrë që prioriteti të cilin ajo ia kërkoj gjykatave të brendshme për dy çështjet konkrete të justifikohet me të vërtetë në terma praktikë. Megjithatë, Gjykata nuk e zotëronte këtë informacion të rëndësishëm.

9. Për pasojë, do të kishte qenë më e preferueshme për Dhomën që të angazhohej në një vlerësim më të balancuar, duke marrë në konsideratë vështirësitë konkrete me të cilat përballëj gjyqësori dhe të cilat as vetë gjyqësori dhe as autoritetet shtetërore në përgjithësi nuk mund t'i zgjidhnin në një afat të shkurtër.

10. Në rrethana të tjera, më herët, Gjykata kishte treguar një qasje shumë më të kujdesshme ndaj problemeve konkrete, me të cilat do të duhej të përballëj një shtet i vogël, pas ndërmarrjes së reformave të thella gjyqësore (shih, për shembull, *P.H. kundër Irlandës* (vendim), [Komisioni], nr. 45046/46, 10 tetor 2017, ku Gjykata i shprehu konsiderata autoriteteve irlandeze, të cilat të përballura me një numër serioz të çështjeve të prapambetura dhe një periudhë mesatarisht rreth tridhjetë e katër muaj për trajtimin e një ankimi nga Gjykata e Lartë në Gjykatën Supreme, e kishin ndryshuar ndjeshëm sistemin ligjor kombëtar, duke krijuar një Gjykatë Apeli, dhe ajo që ishte më e rëndësishmja, i mori në konsideratë ato vështirësi teksa vlerësoi kohëzgjatjen e përgjithshme të procedurave për të cilat ankohej kërkuuesi).

11. Si pasojë, pa neglizhuar dobësitë *përpara* se procesi i *vetting*-ut të prodhonte efektet e tij dramatike në gjyqësor, vendimi mund të shkonte përtej marrjes në konsideratë modestisht të vështirësive të shkaktuara nga procesi i *vetting*-ut dhe ta hiqte periudhën përkatëse – në vend që ta vlerësonte, në mënyrë të konsoliduar (shih paragrafin 65 të vendimit) – nga vonesa e përgjithshme me të cilën u deshën që të përballeshin dy kërkuessit.

SHTOJCË

Lista e kërkuessve:

Nr.	Emri i kërkuessit	Viti i lindjes	Kërkesa nr.	Kombësia	Vendbanimi
1	Petrit Bara	1953	43391/18	Shqiptar	Tiranë
2	Eduard Kola	1986	17766/19	Shqiptar	Shkodër



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV

Nr. 77105-00094-00-2023 i Regjistrit Themeltar

Nr. 00-2023-3812 i Vendimit

VENDIM

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarët:

Asim VOKSHI	- Kryesues
Arbena AHMETI	- Anëtare
Enkelejda METALIAJ(SOFTA)	- Anëtare

sot, më datë 12.10.2023, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi çështjen administrative nr. 77105-00094-00-2023, që u përket palëve:

KËRKUES: Ylli Dylgjeri

OBJEKTI: Konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave në gjykimin e çështjes administrative pranë Gjykatës Administrative të Shkallës Administrative të Apelit Tiranë për gjykimin e vendimit nr. 1615 datë 08.05.2019 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

BAZA LIGJORE: Neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 6/1&13 të Konventës Evropiane të së Drejtave të Njeriut 339/1, e vijues të Kodit të Procedurës Civile.

E lidhur me çështjen administrative në pritje të gjykimit në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë me palë:

- PADITËS:** Ylli Dylgjeri
- TË PADITUR** Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.
Departamenti i Administratës Publike.
- OBJEKTI:** Shfuqizimin e Aktit Administrativ nr. 40/10 datë 13.03.2019 të Komisionit Disiplinor, i cili ka vendosur marrjen e masës disiplinore, i cili ka vendosur marrjen e masës disiplinore “Largim nga Shërbimi Civil” të Nëpunësit Civil Ylli Dylgjeri me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Planifikimit dhe Nxitjes në Agjencinë e Trajtimit të koncesioneve.
- Shfuqizimin e aktit administrativ vendim nr. 40/11 prot., datë 18.03.2019, të Kryetarit të Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve për Largimin nga Shërbimi Civil për Nëpunësin Civil Ylli Dylgjeri.
- Rikthim në punë, në pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë së Planifikimit dhe Nxitjes në Agjencinë e trajtimit të Koncesioneve, ose në një pozicion të të njëjtit nivel, në përputhje me Kategorinë e Nëpunësit Civil IV B.
- Detyrimin për kryerjen e pagesës së pagës për pozicionin Drejtor në Drejtorinë e Planifikimit dhe nxitjes në Agjencinë e trajtimit të Koncesioneve kategoria e Nëpunësit Civil IV B deri – në momentin e rikthimit në punë.

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

pasi dëgjoi relatimin e gjyqtarit Asim Vokshi dhe si bisedoi çështjen në tërësi në dhomë këshillimi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Pala paditëse ka qenë i punësuar në shërbimin civil pranë palës së paditur, Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve, pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me detyrën Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Nxitjes që prej datës 31.01.2014.

2. Me shkresën nr. 40/6, datë 06.03.2019, të Kryetarit të Agjencisë

së Trajtimit të Koncesioneve, në cilësinë e eprorit direkt, është njoftuar fillimi i ecurisë disiplinore ndaj paditësit Ylli Dylgjeri, për shkelje shumë të rënda. Me vendimin nr. 40/10, datë 13.03.2019, Komisioni Disiplinor vendosi marrjen e masës disiplinore “Largim nga shërbimi civil” i z. Ylli Dylgjeri. Me aktin nr. 40/11, datë 18.03.2019, të Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve, është bërë ndërprerja e marrëdhënieve financiare të paditësit Ylli Dylgjeri, bazuar në vendimin e Komisionit Disiplinor për largimin nga shërbimi civil. Shkaku për të cilën ka filluar procedura disiplinore dhe shkaku për të cilën është larguar paditësi nga shërbimi civil është: Se në datë 04.03.2019, nga ana e eprorit direkt (titullarit të institucionit) të nëpunësit Ylli Dylgjeri është konstatuar se ky nëpunës gjatë dhe jashtë orarit zyrtar ka postuar në rrjetet sociale mendime/vlerësime me përmbajtje politike duke cenuar paanësinë dhe duke shkelur parimet e administrimit të shërbimit civil. Komisioni Disiplinor ka përcaktuar se nëpunësi ka shprehur publikisht bindjet dhe preferencën politike nëpërmjet publikimeve të vazhdueshme, përmes medias sociale, siç është rrjeti i platformës së komunikimit Facebook apo media publike si gazeta “Telegraf”, respektivisht në datat 12.02.2019, 19.02.2019, 01.03.2019, 02.03.2019, 03.03.2019.

3. Pala paditëse duke mos qenë dakord me vendimmarrjen e palës së paditur i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë me padi.

4. **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë** me vendimin nr. 1615 datë 08.05.2019 ka vendosur: *“Pranimin e kërkesë padisë. Shfuqizimin e aktit administrativ vendim nr. 40/10 date 13/03/2019 i Komisionit Disiplinës. Shfuqizimin e Aktit Administrativ Urdhër nr. 40/11 date 18/03/2019 i Kryetarit të Agjencisë të Trajtimit të koncesioneve, Detyrimin e palëve të paditura të kthejnë paditësin në punë në pozicionin Drejtor Drejtorie të planifikimit dhe nxitjes në Agjencinë e trajtimit të Koncesioneve ose në një pozicion të të njëjtit nivel. Detyrimin e palëve të paditura ti paguajnë paditësit pagën deri në momentin e rikthimit të tij në punë dhe ekzekutimin e këtij vendimi [...]”*

5. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim pala paditëse. Çështja është regjistruar në Gjykatën e Apelit Tiranë me datë 28.06.2019 me numër 31154-02568-86-2019.

6. Më datë 21.06.2023 kërkuesi Ylli Dylgjeri i është drejtuar Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatim të shkeljes së afatit të arsyeshëm të çështjes administrative me numër 31154-02568-86-2019 me datë regjistrimi 28.06.2019 që ndodhet në shqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

7. Në përputhje me nenin 399/4, pika 1, e Kodit të Procedurës Civile, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë kërkoi informacion nga gjyqtari relator në lidhje me fazën dhe procedurat e gjykimit të kësaj çështje.

8. Në informacionin e parashtruar nga gjyqtari relator me shkresën nr. 1256/1 datë 22.06.2023 ka deklaruar se çështja është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit në datë 28.06.2019 dhe shortuar fillimisht pranë gjyqtare R.S. Me rishortimin e datës 09.03.2023 bazuar në vendimin e Këshillit

të Gjykatës nr. 49, datë 24.02.2023 jam caktuar si gjyqtar relator për gjykimin e kësaj. Për shkak të volumit të çështjeve në gjykim pranë kësaj gjykate kjo çështje nuk është gjykuar ende. Ndërkohë, referuar kalendarit të çështjeve që janë në gjykim, e në të cilat jam caktuar gjyqtar relator, aktualisht janë përfshirë në këtë kalendar çështje që janë regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit në periudhën Prill 2017. Çështja nuk është shqyrtuar brenda afateve ligjore jo për shkak të mungesës së vullnetit për ta shqyrtuar atë, por për shkak të ngarkesës të jashtëzakonshme me çështje, ngarkesë e cila është shtuar edhe më shumë pas rishortimit të dosjeve të gjyqtarëve të larguar nga detyra. Gjyqtari relator ka deklaruar se aktualisht, në proces gjykimi ka 3359 çështje dhe mesatarisht gjatë një javë zhvillon në cilësinë e gjyqtarit relator 12 seanca gjyqësore dhe 15 seanca në dhomë këshillimi. Gjithashtu rezulton se drejtuar gjyqtarit relator në lidhje me këtë çështje nuk është paraqitur ndonjë kërkesë nga palët ndërgjyqës për përshpejtimin e gjykimit referuar nenit 460, pika 3 e Kodit të Procedurës Civile dhe vendimit nr. 78 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, nuk është iniciuar procedura për gjykimin e përshpejtuar të kësaj çështje.

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ

9. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (në vijim Kolegji) konstaton se kërkesa është paraqitur nga një subjekt i legjitimuar, pasi kërkuesi Ylli Dylgjeri rezulton të jenë në cilësinë e paditëse në procesin gjyqësor për të cilin është regjistruar ankimi me nr. regj. themeltar 31154-02568-86-2019 datë 28.06.2019.

10. Kolegji vlerëson se kërkesa është në kompetencën e tij, sipas nenit 399/6, pika 1, shkronja “b”, të Kodit të Procedurës Civile, pasi përmes saj kërkohet konstatimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm në gjykimin e çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë. Kolegji vlerëson se përgjithësisht kërkesa i plotëson elementët e parashikuar në nenin 399/5, pika 1, të Kodit të Procedurës Civile. Gjithashtu, kërkesa është e shoqëruar me aktet e tjera të nevojshme, të përcaktuar në nenin 399/5, pika 2 të Kodit të Procedurës Civile.

11. Sa i përket bazueshmërisë së kërkesës, Kolegji thekson se është i vetëdijshëm se parimi i gjykimit brenda afatit të arsyeshëm ka një rëndësi themelore për gjykimin civil/administrativ, pasi përbën dhe një nga elementët e procesit të rregullt ligjor të parashikuar në nenin 6(1) të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNj). Kur neni 6(1) i KEDNj kërkon që çështjet të gjykohen “brenda afateve të arsyeshme” [...], ai nënvizon rëndësinë e dhënies së drejtësisë pa vonesa, të cilat mund të rrezikojnë efektivitetin dhe besueshmërinë e saj (*shih paragrafin 58 të vendimin H. kundër Francës, datë (1989) të GjEDNj*). Si rregull, periudha e afatit të arsyeshëm për përfundimin e një procesi gjyqësor civil shtrihet, që nga momenti i ngritjes së padisë tek momenti i ekzekutimit të vendimit gjyqësor. (*shih vendimin Qufaj kundër Shqipërisë (2004); Vendimin Scopelliti kundër Italisë, datë (1993) të GjEDNj*). Gjykata ka një pozitë kryesore dhe të veçantë, pasi është i vetmi organ që është përgjegjës për dhënien e drejtësisë dhe si e tillë merr pjesë në mënyrë të detyrueshme në të gjitha marrëdhëniet që krijohen gjatë gjykimit të çështjes.

12. Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (në vijim GJEDNJ) në jurisprudencën e saj të konsoliduar, ka identifikuar disa elemente përbërëse të këtij standardi. Në referim të kësaj jurisprudence rezulton se në përllogaritjen e afatit të arsyeshëm merren në konsideratë faktorë të ndryshëm, të tilla si: kompleksiteti i çështjes; sjellja e palëve ndërgjyqëse; sjellja e autoriteteve gjyqësore dhe administrative (*shih vendimin Buchholz kundër Republikës Federale Gjermane datë 06.05.1981 dhe Bjeliç kundër Sllovenisë ap. nr. 50719/06, datë 18.10.2012. të GJEDNJ*). Edhe Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë në vendimin e saj nr. 26/2017 ka theksuar se “[...] arsyeshmëria e zgjatjes së procesit duhet të vlerësohet mbi bazën e kriterëve të përcaktuara në jurisprudencën e GJEDNJ-së, sipas së cilës arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procesit gjyqësor duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të veçanta të çështjes, duke pasur parasysh sidomos kompleksitetin e çështjes, sjelljen e kërkuarit, sjelljen e autoriteteve, si dhe rrezikun që passjell për kërkuarin kjo tejzgjatje e afateve të gjykimit.”

13. Mekanizmi procedural i “Gjykimit të kërkesave për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, përshpejtimin e procedurave dhe shpërblimin e dëmit”, është një risi e ligjit nr.38/2017, me qëllim bërjen efektive të parashikimeve të nenit 6(1) të Konventës Europiane “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, si dhe nenit 42 të Kushtetutës, në lidhje me gjykimin e çështjeve brenda një afati të arsyeshëm. Kjo ndërhyrje e ligjvënësit synoi të krijonte një mjet efektiv për adresimin e problematikës së gjykimeve në tejkalim të afateve të arsyeshme, e cila është projektuar të zbatohej në kushtet e një veprimtarie normale të gjyqësorit. Nisma ka ardhur si pasojë e disa vendimmarrjeve të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut kundër Shqipërisë (*Çështja Luli dhe të Tjerët kundër Shqipërisë (2014), etj*), në të cilat shtrohej domosdoshmëria për Shqipërinë, që të krijonte një mekanizëm efektiv për adresimin e problematikës së zhvillimit të procedurave gjyqësore tej afateve të arsyeshme. Edhe Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë pranon në vendimin e saj nr.39, datë: 09.12.2021 se mekanizmi i mishëruar në nenet 399/1-399/12 të Kodit të Procedurës Civile “[...] mund të jetë efektiv në rrethana të zakonshme të organizimit dhe funksionimit të sistemit gjyqësor. Në rastin konkret, ngrihen dyshime për mundësitë që mjeti përshpejtues ka për t’iu përgjigjur në shkallën e duhur nevojës së të drejtës së individëve për gjykim brenda afatit të arsyeshëm në raport me mundësitë reale të sistemit gjyqësor, për shkak të vëllimit të lartë të çështjeve, si dhe burimeve njerëzore dhe infrastrukturore të tij në tërësi [...]”.

14. Në çështjen objekt gjykimi konstatohet se nga momenti i regjistrimit të çështjes së themelit të kërkuar në Gjykatën Administrative të Apelit rezulton se çështja e ka kaluar afatin e shqyrtimit në atë gjykatë, siç përcaktohet në nenin 399/2, pika 1, shkronja “a”, të Kodit të Procedurës Civile (*I vit*), pasi nga regjistrimi i çështjes në gjykatë dhe deri në paraqitjen e kësaj kërkesë ka kaluar një kohë rreth 4 vite. Kërkuar nuk ka mbajtur sjellje që të kenë sjellë vonesa të paarsyeshme në gjykim dhe për nga natyra e çështjes ajo duhej gjykuar me përparësi ndonëse nga rrethanat konkret nuk rezulton se kërkuar i vjen ndonjë rrezik i veçantë nga

mosgjykimi në afat i kësaj çështje. Nga ana tjetër, referuar kritereve të mësipërme, çështja paraqitet me kompleksitet mesatar.

15. Kolegji vlerëson se vonesa e gjatë në shqyrtimin e mosmarrëveshjes konkrete Gjykatën Administrative të Apelit, është rrjedhojë e një problematike të përgjithshme që tejkalon rastin konkret. Përbën një fakt të njohur botërisht se reforma në drejtësi ka shkarkuar/pezulluar një numër të konsiderueshëm gjyqtarësh në Republikën e Shqipërisë, e veçanërisht Gjykata Administrative e Apelit është prekur ndjeshëm nga shkarkimet/pezullimet dhe dorëheqjet për shkak të procesit të vetingut. Ky proces natyrshëm ka krijuar kosto për qytetarët në tejzgjatjen e afateve për gjykimin e çështjeve gjyqësore. Kolegji çmon se këto vështirësi janë përgjithësisht proporcionale në raport me të mirën e pranuar përgjithësisht që padyshim krijon procesi i reformës.

16. Komisioni i Venecias ka theksuar se reforma në drejtësi, procesi i verifikimit të gjyqtarëve/prokurorëve në Shqipëri, ishte e domosdoshme edhe nëse do të sillte pasoja të paparashikuara. Përveç aspekteve të padyshimta pozitive mbi cilësinë e gjyqësorit në planin afatgjatë, në një periudhë afatshkurtër procesi i verifikimit ndikon në numrin e gjyqtarëve aktiv në sistem duke shkaktuar problem të përkohshme praktike derisa të bëhet zëvendësimi i tyre (*Shih European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission) Albania opinion on the appointment of judges to the Constitutional Court*).

17. Kolegji vlerëson se konsideratat e mësipërme janë pasur në vëmendje edhe nga legjislatori në kohën e parashikimit të rregullimeve ligjore specifike të Kodit të Procedurës Civile duke parashikuara Kreun X, të Titullit III të Pjesës së Dytë të emërtuar “Gjykimi i kërkesave për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, përshpejtimin e procedurave dhe shpërblimin e dëmit”. Neni 399/2 pika 3 e Kodit të Procedurës Civile parashikon: “Në kohëzgjatjen e gjykimit ose të procedimit, nuk llogaritet koha kur çështja është pezulluar për shkaqe ligjore, kur është shtyrë për shkak të kërkesave të palës kërkuese, sipas këtij kreu, **ose kur shfaqen rrethanat të pamundësisë objektive për procedim.**” Kësisoj, Kolegji vlerëson se ligjvënësi, me ndryshimet e Kodit të Procedurës Civile përmes ligjit nr. 38/2017, ka parashikuar rrethanat e “pamundësisë objektive për procedim”, si kusht për mos llogaritjen e afateve që kalojnë përsa kohë vepron kjo gjendje. Pra, në kohëzgjatjen e gjykimit, nuk llogaritet koha e “pamundësisë objektive për procedim”, duke përfshirë zbatimin e nenit 399/2 pika 2 të Kodit të Procedurës Civile, nëse gjykata vlerëson se ndodhet në këto kushte. Rasti klasik është pezullimi dy mujor (mars-maj) në vitin 2020 i veprimtarisë gjyqësore për shkak të pandemisë Covid 19 (*si rrjedhojë e aktit normativ nr.9, datë 25.03.2020, i ndryshuar me aktin normativ nr.21, datë 27.05.2020*). Por, në këndvështrimin e Kolegjit pamundësi objektive për procedim përbën edhe mospasja e përkohshme e kapaciteteve njerëzore të domosdoshme për përballimin brenda limiteve të arsyeshme të stokut të çështjeve, të mbetura pa gjykuar për një kohë të gjatë.

18. Në parim, askujt nuk mund t’i kërkohet të bëjë të pamundurën dhe për më tepër nuk mund të mbahet përgjegjës për pamundësinë objektive absolute për

evadimin e çështjeve, në kushtet e një numri tejet të kufizuar burimesh njerëzore dhe një numri tepër të lartë të stokut të çështjeve, të cilat duhen gjykuar me radhë. Konstatimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe urdhërimi i marrjes së masave konkrete për përshpejtimin e gjykimit, është një institut që është projektuar dhe synon të korrektojë rastet e pakujdesive apo veprimeve të parregullta të gjykatave, në planifikimin dhe gjykimin në kohë të çështjeve. Ky institut synon të rregullojë anomali individuale dhe zbatohet në ato raste kur gjykimi jashtë afateve të arsyeshme është përjashtim dhe jo rregull praktik (*për shkak të ngarkesës së madhe dhe mungesës së theksuar të burimeve njerëzore*). Por, në kushtet kur situata objektive është e tillë që nuk mund të rregullohen anomalitë, pasi objektivisht nuk mund të procedohet me gjykimin e çështjeve, me përjashtim të ndonjë rasti tejet të veçantë, nuk ka vend që të urdhërohet shqyrtimi me përshpejtim i kësaj çështje, duke lënë pa gjykuar çështje të tjera të ngjashme apo më urgjente e më të vjetra, të cilat edhe ato duhet të gjykohen sipas radhës së paraqitjes në gjykatë.

19. Nga ana tjetër, siç theksohet edhe në mendimin me shkrim të gjyqtarit relator, ai po bën përpjekjet maksimale për gjykimin e çështjeve në kohën më të parë të mundshme, porse në planin kohor është duke gjykuar ankimet e vitit 2017. Për më tepër kërkuesi nuk ka paraqitur kërkesë për përshpejtim të gjykimit të çështjes, bazuar në specifikat individuale të kësaj çështje (*marrëdhënie pune*). Ky fakt merret parasysh nga Gjykata e Lartë në peshimin e rëndësisë që ka për paditësin marrja e masave për përshpejtimin e gjykimit të çështjes (*ai nuk ka paraqitur kërkesë për përshpejtim pranë gjykatës në vonesë*). Kolegji vlerëson se vonesat aktuale në gjykimin e çështjeve nga Gjykata Administrative e Apelit lidhen me pamundësinë objektive për procedim, e cila në rastet kur ekziston, e bën të pamundur shpërblimin e drejtë të kërkuesit, në kuptim të konstatimit të shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe marrjes së masave për përshpejtimin e çështjes, sipas parashikimeve të neneve 399/1-399/12 të Kodit të Procedurës Civile.

20. Kolegji vlerëson se mekanizmi zhblllokues i projektuar nga nenet 399/1-399/12 të Kodit të Procedurës Civile, përjashtohet nga zbatimi në rastet e pamundësisë objektive për procedim. Kjo nuk ndalon ligjvënësin apo autoritetet e tjera vendimmarrëse, që në zbatim edhe të udhëzimeve të Gjykatës Kushtetuese të dhëna ndër të tjera edhe në vendimin nr.39, datë: 09.12.2021 (*Gjykata Kushtetuese shprehet se "[...] akumulimi i përkohshëm i çështjeve nuk e ngarkon shtetin me përgjegjësi, në rast se ka ndërmarrë veprime të menjëhershme që synojnë përmirësimin e situatës për të zgjidhur një situatë të tillë. Pavarësisht se ka disa metoda që mund të zbatohen nga gjykatat për të nxitur përkohësisht përshpejtimin e gjykimit të çështjeve, nëse edhe një zgjidhje e tillë rezulton në tejzgjatje dhe kthehet në një problem të organizimit strukturor, atëherë shteti duhet të sigurojë miratimin e masave më efektive dhe të organizojë sistemin gjyqësor, në mënyrë që të garantohet e drejta për të marrë një vendim përfundimtar brenda një periudhe të arsyeshme (shih vendimet nr. 35, datë 01.11.2021; nr. 34, datë 01.11.2021; nr. 33, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese)*"), të parashikojë zgjidhje të tjera ligjore efektive për përballimin e situatës. Por, nuk mund t'i ngarkohet kësaj procedure

ligjore (mekanizmi sipas neneve 399/1-399/12 të Kodit të Procedurës Civile), një barrë që nuk janë projektuar për ta mbajtur.

21. Kolegji vlerëson se mekanizmi aktual zhbllokues sipas neneve 399/1-399/12 të Kodit të Procedurës Civile, ashtu siç është shkruar nga ligjvënësi parashikon si mjet të fundit shpërblimin monetar të dëmit të ardhur nga vonesa në gjykimin e një çështje, e cila është pjesa finale e konceptit “shpërblim i drejtë” të mishëruar në nenin 399/3(1) të Kodit të Procedurës Civile. Për këtë arsye në nenin 399/4(2) të Kodit të Procedurës Civile është parashikuar shprehimisht se: “[k]ërkesëpadia, sipas nenit 399/6, pika 3, i drejtohet gjykatës civile të shkallës së parë kompetente, sipas rregullave të përgjithshme, vetëm pasi procedura e konstatimit të shkeljes dhe përshpejtimit të procedurës është ezauruar sipas pikës 1, të këtij neni, dhe nuk është ekzekutuar nga organi që ka kryer shkeljen vendimi i gjykatës, sipas pikës 1 të këtij neni. [...]” Kolegji vlerëson se në kuptim të ligjit në fuqi, “shpërblimi i drejtë” për cenimin e afateve të arsyeshme të gjykimit, kalon në dy faza (nëse e para gjen zbatim dhe është e suksesshme nuk ka vend për të kaluar tek e dyta):

- I. Faza e konstatimit të shkeljes së afateve të arsyeshme dhe urdhërimi i marrjes së masave për përshpejtimin e procedurave (që bëhet nga gjykata kompetente sipas nenit 399/6(1) të KPrC).
- II. Nëse vendimi i gjykatës kompetente që konstaton cenimin e afatit të gjykimit dhe urdhëron marrjen e masave konkrete për përshpejtimin e procedurës, nuk zbatohet, atëherë vlerësohet se ka dështuar mekanizmi parësor dhe mund të kalohet në fazën e dytë që është padia për dëmshpërblimin monetar të palës së dëmtuar nga tejzgjatja e gjykimit, sipas kriterëve të përcaktuara në nenin 399/10 të Kodit të Procedurës Civile, e cila gjykohet nga gjykata e përcaktuar në nenin 399/6(3) të Kodit të Procedurës Civile (gjykata civile e shkallës së parë ku ka qendrën organi ndaj të cilit është konstatuar shkelja).

22. Konceptimi si më sipër ka ardhur si rrjedhojë e çështjes Luli dhe të tjerët kundër Shqipërisë (2004), në të cilën GjEDNj citon çështjen Scordino k. Italisë (nr.1) (2006), tek e cila është shprehur se:

“183. Zgjidhja më e mirë në kushte absolute është pa diskutim, ashtu si edhe në shumë sfera, parandalimi. Gjykata vëren se ajo ka deklaruar në shumë raste se Neni 6 § 1 i vë Shtetet Kontraktuese përpara detyrës për të organizuar sistemet e tyre gjyqësore në mënyrë të tillë që gjykatat e tyre të përmbushin çdo kërkesë të saj, duke përfshirë edhe detyrimin për të dëgjuar çështjet brenda një kohe të arsyeshme (referencat janë hequr). Në rastin kur sistemi gjyqësor është deficiente, një zgjidhje e tillë që mund të përshpejtojë procedurat, për të parandaluar kohëzgjatjen e tyre të tepruar, është zgjidhja më efektive. Një zgjidhje e tillë ofron një avantazh të pamohueshëm kundrejt një zgjidhje e cila ofron vetëm kompensimin, duke qenë se ajo parandalon shkeljet e njëpasnjëshme për të njëjtat procedura dhe e riparon shkeljen a posteriori, ashtu siç e riparon zgjidhja kompensuese e parashikuar nga ligji italian, për shembull.

184. Në shumë raste, Gjykata e ka pranuar se kjo lloj zgjidhje është “efikase”, duke qenë se ajo përshpejton vendimin e gjykatës përkatëse (referencat janë hequr).”

23. Pra, nenet 399/1-399/12 të Kodit të Procedurës Civile kanë krijuar një mekanizëm efektiv për kohë të zakonshme (normale) të veprimtarisë gjyqësore, ku synimi parësor nuk është “dëmshpërblimi monetar” i palëve në proceset e tejzgjatura, por parandalimi i kësaj nëpërmjet mekanizmave për përshpejtimin e procedurave, me qëllim dhënien e drejtësisë në kohë nga gjykatat. Pjesë integrale e përshpejtimin të procedurave është vendimi i gjykatës kompetente që (1) konstaton kalimin e afateve të arsyeshme të gjykimit dhe (2) urdhëron marrjen e masave konkrete për përshpejtimin e gjykimit të çështjes. Në këtë kontekst, vetëm konstatimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit, pa pasur mundësi gjykata të urdhërojë edhe marrjen e masave konkrete për përshpejtimin e procedurës (*për shkak se ekziston pamundësia objektive për procedim*), nuk është opsion vendimmarrje për gjykatën që shqyrton kërkesën për “shpërblim të drejtë” sipas neneve 399/6(1) e 399/7(2) të Kodit të Procedurës Civile.

24. Në vijim Kolegji e vlerëson të rëndësishme të japë disa konsiderata të përgjithshme orientuese edhe për procedurën që ligji parashikon shprehimisht në lidhje me paraqitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit. Kjo edhe në dritën e konstatimit të Gjykatës Kushtetuese në vendimin e saj nr.39, datë: 09.12.2021 se: “[...] gjykatat e zakonshme, gjatë zbatimit të dispozitave procedurale dhe shqyrtimit të kërkesave për përshpejtim, duhet të shmangin formalizmat e tepruar dhe t’i shqyrtojnë këto kërkesa me përparësi, përndryshe ky mjet juridik do të humbiste qëllimin për të cilin është miratuar nga ligjvënësi. [...]”

25. Në këtë këndvështrim, Kolegji vlerëson se në funksion të shmangies së vonesave administrative të panevojshme dhe në funksion të respektimit të procedurave ligjore, është me rëndësi të sqarojë një aspekt ligjor dhe praktik që lidhet me depozitimin e gabuar të kërkesë/ankesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, drejtpërdrejtë tek gjykata që është kompetente për shqyrtimin në themel të saj, në vend të gjykatës që pretendohet se është në vonesë. Në lidhje me këtë, kërkuksi/ankuesi që pretendon cenim të të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm duhet që proceduralisht ta depozitojë kërkesën e tij në gjykatën ku pretendohet se po ndodh “shkelja” e afatit të arsyeshëm të gjykimit (“gjykata në vonesë”) dhe jo drejtpërdrejtë në gjykatën që është kompetente për shqyrtimin e saj, sipas nenit 399/6(1) të Kodit të Procedurës Civile (*vetëm në Gjykatën e Lartë këto cilësi faktike bashkohen*). Kjo pasi, sipas nenit 399/5(1) të Kodit të Procedurës Civile, “[k]ërkesa depozitohet në sekretarinë e gjykatës që është në vonesë, [...]”. Në vijim, neni 399/7(2) i KPrC e lidh paraqitjen e kërkesës në gjykatën që pretendohet se është në vonesë, me lindjen e detyrimit për kryerjen e disa veprimeve procedurale nga kjo gjykatë (*dërgimin tek gjykata kompetente sipas nenit 399/6(1) të KPrC, brenda 15 ditëve, të dosjes dhe mendimit me shkrim nga gjyqtari relator, për ecurinë e çështjes, shkaqet e vonesës dhe propozimin e tij për zgjidhjen e situatës*).

26. Pra, nëse shkelja e afateve të gjykimit pretendohet ndaj gjykatës së shkallës së parë, por kërkesa për konstatim shkelje afati dhe marrje masash për përshpejtim nuk depozitohet aty, por dorëzohet drejtpërdrejtë në gjykatën e apelit, atëherë kjo e fundit nuk duhet ta regjistrojë atë si çështje për gjykim, por t’ia përcjellë gjykatës së shkallës së parë dhe më pas kjo e fundit, konform nenit 399/7(2) të Kodit të Procedurës Civile, brenda 15 ditëve nga marrja e kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e gjykimit, t’i dërgojë gjykatës së apelit për shqyrtim kërkesën ankimore, sëbashku me dosjen dhe mendimin me shkrim të gjyqtarit të shkallës së parë.

27. Po ashtu, nëse vonesa e paarsyeshme pretendohet se po ndodh në gjykatat e apelit, kërkesa nuk depozitohet drejtpërdrejtë në Gjykatën e Lartë, por pranë gjykatës së apelit në fjalë (gjykata në vonesë) dhe ajo nga momenti i depozitimit të kërkesës ankimore për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e gjykimit, brenda 15 ditëve ia dërgon atë për shqyrtim Gjykatës së Lartë, sëbashku me dosjen dhe mendimin me shkrim të gjyqtarit relator.

28. Kjo mënyrë të proceduari që është parashikuar shprehimisht nga ligji, vlen me qëllim që të mos krijohen vonesa të tjera të paarsyeshme në trajtimin e këtyre lloj kërkesave të posaçme, sipas procedurës së përcaktuar shprehimisht në nenet 399/5, 399/6 e 399/7 të Kodit të Procedurës Civile. Nëpërmjet respektimit të procedurës së mësipërme krijohet mundësia e zbatimit (kur është rasti) nga gjykata në vonesë edhe të parashikimit të nenit 399/7(3), sipas të cilit “3. Në rast se gjatë shqyrtimit të kërkesës organi që po kryen veprimet, ndërmerr hapat që po kërkohen nga pala, brenda 30 ditëve nga paraqitja e kërkesës, pushon shqyrtimi i kërkesës.” Në këtë rast “organi që po kryen veprimet” është i njëjtë me shprehjen “organi që pretendohet se ka kryer shkeljen” (gjykata në vonesë). Duke ardhur në dijeni gjyqtari për paraqitjen e një kërkesë ankimore për konstatim shkelje afati të gjykimit dhe marrjen e masave për përshpejtimin e gjykimit, ka mundësi efektivisht që të zbatojë nenin 399/7(3) të Kodit të Procedurës Civile dhe eventualisht (nëse është e mundur) të kryejë veprimin që është në vonesë (përfshirë p.sh: caktimin e një date për shqyrtimin e ankimit), duke e lënë kërkesën ankimore pa objekt. Kjo pasi, gjyqtari në mendimin e tij me shkrim për gjykatën që do të shqyrtojë kërkesën për konstatim shkelje afati, do të ketë mundësi të sqarojë se e kreu veprimin “shërues” për gjykimin në vonesë.

29. Në përfundim, referuar kërkesës objekt gjykimi, në kushtet kur Gjykata Administrative e Apelit ndodhet në pamundësi objektive (*mungesë e theksuar gjyqtarësh dhe stafi të kualifikuar ndihmës*) për marrjen e masave për shqyrtimin e kësaj çështje me përshpejtim (edhe për shkak se kërkuesja nuk ka paraqitur një kërkesë të tillë sipas nenit 460 të Kodit të Procedurës Civile), pasi janë shumë çështje të tjera më të vjetra se ajo dhe me të njëjtën apo me shkallë më të lartë përparësie që presin për gjykim, atëherë nuk mund të gjejë zbatim mekanizmi zhblllokues, pikërisht për shkak të parashikimit të 399/2 pika 3 e Kodit të Procedurës Civile.

30. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se duhet të vendoset rrëzimi i kërkesës pasi nuk vërehet ndonjë pakujdesi në veprimtarinë e gjykatës Administrative të Apelit dhe

aktualisht gjykata është në pamundësi objektive për procedimin e menjëhershëm për shqyrtimin e kësaj çështje.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë mbështetur në nenin 1(2) të ligjit nr. 49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative” (*i ndryshuar*) dhe nenin 399/8(1)(b) të Kodit të Procedurës Civile,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës së kërkuarit Ylli Dylgjeri.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe i formës së prerë.

Tiranë, më 12.10.2023

